



INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI
KOSOVO LAW INSTITUTE
KOSOVSKI INSTITUT PRAVDE

LUFTË, PERSEKUTIM APO AMNISTI NË EMËR TË LUFTËS KUNDËR KORRUPSIONIT?

Raport vlerësues gjithëpërfshirës i monitorimit të trajtimit të rasteve të korrupsionit në sistemin e drejtësisë për gjashtë mujorin e parë 2017

Autorë: Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

Hulumtimi, analiza dhe përgatitja e raportit është përkrahur nga: Hyrije Mehmeti

Juristë dhe monitorues: Fjorda Vllasolli, Diana Berisha, Lutfi Morina, Verona Kadriu, Delvina Rexhepi, Drita Shala, Nora Kelmendi, Arbër Guta, Gzim Shala, Kaltrina Ajvazi, Sabina Përgega, Lavdim Bajraktari, Leotrim Gashi, Medina Kadriu, Erestina Buja, Gëzim Hasani, Adem Krasniqi, Valdet Hajdini, Arbelina Dedushaj, Skender Govori, Syzana Rexhepi, Fjolla Gaxha, Belkize Loshaj.

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Dhjetor 2017
Prishtinë, Republika e Kosovës

përkrahur nga:



Përmbajtja

I.	Përmbledhje ekzekutive	4
II.	Metodologjia	7
III.	Lufta kundër korrupsionit në nivelin e politikave	9
	a) Politikat e MD-së dhe zbatimi i tyre	9
	b) Politikat e KPK-së dhe zbatimi i tyre.....	10
	c) Politikat e KGJK-së dhe zbatimi i tyre	12
	a) Transparenca dhe llogaridhënia publike e sistemit gjyqësor dhe prokurorial.....	13
IV.	Lufta kundër korrupsionit në sistemin prokurorial	14
	a) Hetimet në rastet e korrupsionit në sistemin prokurorial	14
	b) Hetimet preliminare në rastet e korrupsionit në sistemin prokurorial.....	19
	c) Ngritja e aktakuzave për korrupsion dhe profili i të akuzuarve	24
D)	Analizë krahasuese e ngritjes së aktakuzave për korrupsion dhe profili i ndjekjes	26
I.	Llogaridhënia e prokurorëve	30
II.	Lufta kundër korrupsionit në sistemin gjyqësor.....	32
	a) Analiza e rasteve të monitoruara për periudhën gjashtë mujore (01.01.2017 – 30.06.2017).....	33
	b) Vonesat e prokurorive në procedimin e aktakuzave në gjykata.....	38
	c) Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore	39
	d) Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore në rastet e korrupsionit deri në shpalljen e aktgjykimit	45
	e) Monitorimi i rasteve të korrupsionit të kthyer në rigjykim	47
	f) Profili i personave të akuzuar dhe gjykuar në rastet e korrupsionit (01.01.2017-30.06.2017)	50
III.	Analizë ligjore e trajtimit të rasteve specifike të profilit të lartë të korrupsionit	53
	a) Analiza ligjore e zvarritjes së tri rasteve karakteristike të profilit të lartë	53
	b) Analiza ligjore e trajtimit të shtatë rasteve të profilit të lartë.....	57
IV.	Politika e dënimeve në rastet e korrupsionit	68
	a) Politika e dënimeve në rastet e korrupsionit (01.01.2017-30.06.2017)	68
	a) Politika e dënimeve në rastet e korrupsionit sipas Mekanizmit Përcjellës	71
	a) Analizë krahasuese e dënimeve për gjashtëmujorin e parë 2016 dhe 2017	72
V.	Konfiskimi i pasurive të fituara përmes veprave penale të korrupsionit.....	74
VI.	PËRZGJEDHJA E SHËNJESTRAVE TË TOP RASTEVE	78
VII.	ANEX: Dështimet konkrete të prokurorëve në trajtimin e rasteve të korrupsionit.....	80
VIII.	Rekomandimet	166

I. Përmbledhje ekzekutive

Korrupsioni në Kosovë është endemik. Kosova vuan nga mungesa e vullnetit për të luftuar korrupsionin. Lufta kundër korrupsionit vazhdon të mbetet në nivel të miratimit të politikave nga institucionet e drejtësisë. Kjo luftë, tashmë është shndërruar në një luftë të persekutimit dhe amnistisë së korrupsionit, duke i mbajtur qytetarët me vite e dekada në procedura penale, duke ua shkelur të drejtat dhe liritë themelore dhe duke ua cenuar sigurinë juridike.

Politikat dhe ligjet nuk kanë munguar në luftimin efikas dhe efektiv të korrupsionit në Kosovë. Ministria e Drejtësisë ka përgatitur një kornizë ligjore, zbatimi i së cilës do të sillte rezultate konkrete në luftimin e korrupsionit. Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial kanë miratuar strategji e plane veprimi për trajtimin e rasteve të korrupsionit me prioritet absolut. Bartësit e funksioneve gjyqësore dhe prokuroriale nuk i kanë marrë seriozisht këto politika, të cilat çalojnë për tu zbatuar në praktikë. Kjo ka sjellë një luftë joefikase dhe joefektive kundër korrupsionit, duke shkelur të gjitha afatet ligjore për trajtimin e rasteve të korrupsionit si në fazën e hetimeve ashtu edhe në procedimin e gjykimeve. Mbikëqyrja e zbatimit të planeve të veprimit vazhdon të mbetet formale dhe jo përmbajtësore, duke mos prodhuar rezultatet e pritura si në sistemin gjyqësor ashtu edhe prokurorial.

Lufta kundër korrupsionit në Kosovë vazhdon të zhvillohet kryesisht ndaj profilit të ulët dhe të mesëm. Profili i lartë ndiqet rrallë, por edhe kur ndiqet, aktakuzat ndaj profilit të lartë dështojnë në fazat fillestare në gjykata. Gjetjet e monitorimit sistematik të IKD-në sistemin prokurorial dhe sistemin gjyqësor, tregojnë se luftimi i korrupsionit është i koncentruar kryesisht në profilin e ulët dhe të mesëm. IKD ka analizuar rastet e gjykuara gjatë vitit 2016, në të cilat janë të përfshirë persona të profilit të lartë. Gjetjet e monitorimit tregojnë se nga rastet e përfunduara në shkallë të parë deri në dhjetor 2017, 67% e tyre kanë dështuar në gjykata. Nga 33 personat e profilit të lartë të akuzuar dhe gjykuar gjatë vitit 2016, ndaj shtatë (7) prej tyre është shpallur aktgjykim dënues nga shkalla e parë, ndaj nëntë (9) prej tyre është shpallur aktgjykim lirues, ndaj një (1) personi është shpallur aktgjykim refuzues, ndaj katër (4) prej tyre është hudhur aktakuza, ndërsa ndaj dymbëdhjetë (12) prej tyre është duke vazhduar procesi gjyqësor. Në të vetmin rast ku është shpallur aktgjykim dënues ndaj shtatë personave, shkalla e dytë - Gjykata e Apelit - e ka vërtetuar dënimin vetëm për 1 person, duke e dënuar me 10 muaj burgim me kusht, tre të tjerë i ka liruar, ndërsa për 3 persona ende nuk ka vendosur.

Për dallim nga viti paraprak në gjashtë mujorin e parë të vitit 2017 janë ngritur aktakuza ndaj tre personave të profilit të lartë. Për dy prej këtyre personave (*Dalibor Jevtiq dhe Pal Lekaj*) kanë dështuar aktakuzat e prokurorëve qysh në fazën fillestare në gjykatë, ndërsa për personin e tretë (*Shukri Buja*) ende po vazhdon procedura gjyqësore.

IKD gjatë gjashtë mujorit të parë 2017, ka monitoruar 702 seanca gjyqësore, ku përfshihen 255 raste të korrupsionit me 761 persona, në të gjitha Gjykatat Themelore në Kosovë. 463 prej tyre janë mbajtur, ndërkaq si pasojë e mosplotësimit të kushteve ligjore për mbajtjen e seancave 239

prej tyre janë shtyrë për shkak të mungesës së të pandehurve, prokurorëve dhe gjykatësve. Prej 702 seancave gjyqësore të monitoruara në shtatë Gjykatat Themelore, ku për analizë përfshihen 255 raste të korrupsionit, IKD ka identifikuar shkelje të afateve ligjore në të gjitha fazat e procedurës penale. Edhe pse në Kodin e Procedurës Penale përcaktohet afati prej 30 ditëve për trajtimin e kallëzimit penal, në rastet e analizuara, në praktikë rezulton se mesatarja e trajtimit është 217 ditë. Mesatarja e trajtimit prej ngritjes së aktakuzës deri në mbajtjen e shqyrtimit fillestar është 249 ditë ani pse Kodi parasheh vetëm 30 ditë. Ndërsa, mesatarja e trajtimit prej caktimit të shqyrtimit kryesor deri në shpalljen e aktgjykimit është 266 ditë. Koha më e shkurtë e trajtimit të rastit të korrupsionit nga koha e paraqitjes së kallëzimit penal deri në shpallje të aktgjykimit është 1 ditë, përderisa rasti që ka marr më së shumti kohë deri në shpallje të aktgjykimit është 3689 ditë apo mbi 10 vjet. Pra, në të gjitha fazat e procedurës ka shkelje të afateve ligjore.

Profili i 761 personave të akuzuar në këto 255 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD gjatë kësaj periudhe raportuese (*janar-qershor 2017*) është i kryesisht i ulët dhe i mesëm dhe një numër i kufizuar i personave të akuzuar i takon profilit të lartë.

Në 88 aktgjykime të shpallura në shkallë të parë ndaj 184 personave në rastet e korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se prokurorët kanë dështuar që shumicën e aktakuzave të profilit të lartë t'i provojnë në gjykatë, ndërsa gjykatësit kryesisht kanë zbatuar politikë të butë ndëshkimore, ndaj kryesve të veprave penale të korrupsionit.

Në këto raste të korrupsionit në të cilat ka pasur shpallje të aktgjykimit, 90 persona i takojnë profilit të ulët, 87 persona profilit të mesëm dhe 7 persona i takojnë të profilit të lartë. Prej 7 personave të profilit të lartë, 6 janë liruar, ndërsa vetëm njëri është dënuar dhe atë ish-Kryetari i Novobërdës me gjobë prej 4500 eurove. IKD vlerëson se ky trend i dështimit të aktakuzave të profilit të lartë prej vitit 2016, i cili ka vazhduar në vitin 2017 dëshmon se aktakuzat ndaj profilit të lartë janë ngritur pa prova dhe dëshmi me qëllim të persekutimit të tyre apo amnistisë së përhershme.

Kërkesat për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë së fituar me vepra penale të korrupsionit pothuajse nuk ka fare në praktikë, edhe atëherë kur konstatohet se përmes veprimeve korruptive janë shkaktuar dëme me dhjetëra miliona euro. Kjo qasje vërehet njëjtë si te prokurorët vendor dhe ata të EULEX-it.

Gjatë procesit të monitorimit të IKD-së gjykatësit janë dëshmuar më bashkëpunëtor për të zbatuar obligimet ligjore për të ofruar qasje në dokumentet në përputhje me ligjin, përderisa shumica e prokurorive vazhdojnë të shkelin ligjin, duke mos i ofruar aktet e qasshme, të cilat i kanë ofruar për vite të tëra. Kjo dëshmon mungesën e vullnetit për ta rritur transparencën dhe llogaridhënien e prokurorëve. Si rezultat i gjetjeve të IKD-së, Zyra e Prokurorit Disiplinor ka

trajtuar mbi 500 raste të hetimeve preliminare për shkelje të ligjit nga bartësit e funksioneve prokuroriale dhe gjyqësore.

IKD vlerëson se në emër të luftës kundër korrupsionit sistemi i drejtësisë pak po bën luftë, më shumë po persekuton dhe po amnistion veprimtaritë korruptive. Ndikimi politik në emërimin praktik e jo formal të bartësve të pozitive kyçe në sistemin e drejtësisë po pamundëson luftimin e korrupsionit. Fakti i mbajtjes së rasteve të hapura pa prova dhe dëshmi me vite të tëra po ndikon në persekutimin e qytetarëve dhe cenimin e sigurisë së tyre juridike. Në anën tjetër, ngritja dhe dëshmi i aktakuzave përveç persekutimit në raste të caktuara po përdoret për të amnistuar përgjithmonë kryesit potencial të veprave penale të korrupsionit.

Në këtë situatë, IKD vlerëson se është koha për hapjen e debatit publik lidhur me fillimin e procesit të vetingut në Polici, Prokurori dhe Gjykata. Procesi i vetingut duhet të përfshijë verifikimin e detajuar të së kaluarës së policëve, prokurorëve dhe gjykatësve aktual në Kosovë. Verifikimi duhet të përfshijë debat gjithëpërfshirës të të gjitha partive politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, me kërkesë që zbatimi i procesit të verifikimit në praktikë të udhëhiqet nga SHBA, Mbretëria e Bashkuar dhe Gjermania.

Gjithashtu, rekomandohet hapja e debatit publik lidhur me themelimin e Prokurorisë dhe Gjykatës Speciale me kompetenca në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Procesi i rekrutimit të policëve, prokurorëve dhe gjykatësve që do të jenë vendorë, duhet të realizohet nga SHBA, Mbretëria e Bashkuar dhe Gjermania.

II. Metodologjia

IKD me qëllim që të përpiloj një raport sa më gjithëpërfshirëse dhe analitik, në lidhje me trajtimin e rasteve të korrupsionit nga sistemi prokurorial dhe gjyqësor, ka përdorur metodologji të përzier të hulumtimit. Kjo për shkak se sistemi prokurorial dhe sistemi gjyqësor ende përballen me probleme në unifikimin e të dhënave. Prandaj, hulumtimi trajtimit të rasteve të korrupsionit nga sistemi prokurorial dhe gjyqësor bazohet në monitorimin e drejtpërdrejtë të performancës së prokurorive dhe gjykatave në zbatimin e ligjit, politikave dhe planeve të veprimit për trajtimin e rasteve të korrupsionit me prioritet.

IKD bazuar në obligimet ligjore dhe planet e veprimit ka krijuar indikator të qartë për matjen e progresit në zbatimin e tyre nga sistemi prokurorial dhe sistemi gjyqësor. Hulumtimi përfshinë monitorimin e rasteve të korrupsionit në shtatë Prokuroritë Themelore, Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, shtatë Gjykatat Themelore dhe Degët e tyre. Në fokus të monitorimit kanë qenë edhe aktivitetet e Komisioneve Mbikëqyrëse të Këshillave për lëndët e korrupsionit, Prokurori të Shtetit, Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës në zbatimin e politikave dhe planeve të veprimit. IKD gjithashtu ka siguruar të dhënat statistikore nga Njësi të për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive dhe Departamenti i Statistikës në Këshillin Gjyqësor si dhe ka mbledhë të dhënat individualisht përgjatë procesit të monitorimit nëpër të gjitha prokuroritë dhe gjykatat.

Raportet e siguruar nga IKD janë përmbledhë në një bazë të të dhënave, e cila ka përfshirë të gjitha rastet e korrupsionit dhe personat e përfshirë në këto raste në të gjitha fazat e procedurës penale në sistemin prokurorial dhe sistemin gjyqësor.

Baza e të dhënave është shfrytëzuar për të evidentuar çështjet më shqetësuese që ndërlidhen me zbatimin e obligimeve ligjore dhe obligimet e planeve të veprimit, përkatësisht lidhur me zgjidhjen, mënyrën e zgjidhjes dhe moszgjidhjen e rasteve të korrupsionit nga prokurorët dhe gjykatësit. Përmes statistikave, IKD ka analizuar disa aspekte të cilat janë paraqitur dhe komentuar përmes tabelave dhe grafikave, duke përfshirë të gjitha specifikat e rasteve të korrupsionit për secilën prokurori dhe gjykatë, për secilin parashtrues të rastit të korrupsionit, për vjetërsinë e rasteve të denoncuar për korrupsion dhe për mënyrën e zgjidhjes së rasteve.

IKD ka vazhduar të monitoroj aktet prokuroriale rreth vendimeve për hudhje të kallëzimeve penale dhe vendimeve për pushim të hetimeve. Të njëjtat janë analizuar karshi obligimeve ligjore dhe është bërë identifikimi i shkeljeve ligjore në trajtimin e rasteve të korrupsionit në procedurën penale, përfshi identifikimin e rasteve të parashkruara. Vlen të theksohet se për gjashtë mujorin e parë të vitit 2017 (1 janar – 30 qershor 2017) aktet prokuroriale nuk i kanë ofruar shumica e Prokurorive Themelore. IKD ka ndërtuar një praktikë të bashkëpunimit prej vitit 2013 me të gjitha Prokuroritë, që i kanë ofruar aktet prokuroriale (*vendimet për hudhjet e kallëzimeve penale dhe vendimet për pushimin e hetimeve*), të cilat vazhdimisht janë kërkuar në përputhje me dispozitat e Ligjit për Qasje në Dokumentet Publike dhe Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave

Personale. Refuzimi për të ofruar këto akte prokuroriale, prej të cilave një numër i rasteve të shkeljes së prokurorëve janë dërguar në Komision Disiplinor, dëshmon përpjekjet maksimale të këtyre prokurorëve, që t'i shmanget monitorimit, transparencës dhe llogaridhënies publike rreth trajtimit të rasteve të korrupsionit. IKD të drejtat e garantuara përmes legjislacionit të aplikueshëm për sigurimin e akteve juridike prokuroriale do t'i realizojë përmes rrugëve ligjore.

Hulumtuesit e IKD-së, prej 1 janarit deri më 30 qershor 2017 kanë monitoruar 702 seanca gjyqësore, ku përfshihen 255 raste të korrupsionit me 761 persona. IKD ka krijuar indikatorë të qartë për të bërë matje të sakta të kohëzgjatjes së rasteve të korrupsionit nëpër të gjitha fazat e procedurës penale, duke përfshi prej ngritjes së kallëzimit penal deri në shpallje të aktgjykimit në shkallë të parë nga gjykatat. Analiza përfshin të gjitha trendet e trajtimit të këtyre rasteve dhe kohëzgjatjen e procedurave në këto raste të korrupsionit.

Aspekt i rëndësishëm i monitorimit ka qenë performanca e mekanizmave të llogaridhënies për prokurorët dhe gjykatësit, të cilët për shkak të performancës së tyre në rastet e korrupsionit janë bërë subjekt i procedurave disiplinore.

IKD ka monitoruar vazhdimisht aktivitetet e Komisioneve Mbikëqyrëse për lëndët e korrupsionit të KPK-së dhe KGJK-së, Prokurorive Themelore, Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Gjykatave Themelore, Këshillit Prokurorial dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Me të gjithë bartësit e funksioneve prokuroriale dhe gjyqësore, gjatë gjithë vitit IKD ka zhvilluar intervista të thella, të bazuara në indikatorët e përcaktuar në përputhje me obligimet ligjore dhe obligimet e planeve të veprimit. Intervistat e zhvilluara janë kodifikuar ashtu që çështjet dhe informatat e dala nga to janë përfshirë në raport.

Poashtu, për të qenë sa më të saktë në identifikimin e problemeve si dhe propozimin e rekomandimeve për zgjidhje të problemeve në luftimin e korrupsionit, përkatësisht në zbatimin sa më efikas dhe efektiv të obligimeve ligjore dhe obligimeve të planeve të veprimit, IKD ka analizuar bazën ligjore, si dhe analizuar në detaje dokumente relevante vendore dhe ndërkombëtare, të cilat ndërlidhen me luftën kundër korrupsionit në Kosovë.

III. Lufta kundër korrupsionit në nivelin e politikave

Më 19 janar 2012, Komisioni Evropian kishte filluar dialogun për liberalizimin e vizave me Kosovën. Në kuadër të dialogut për viza, Kosovës i kërkohej nga Komisioni Evropian që fillimisht të miratojë ose ndryshojë legjislacionin e përcaktuar në udhërrëfyesin për liberalizim të vizave në pajtueshmëri me *acquis* e BE-së. Kosova pastaj duhet të zbatojë plotësisht këtë legjislacion dhe të gjitha masat tjera të specifikuar në udhërrëfyes.¹

Në bllokun tre të Udhërrëfyesit për liberalizim të vizave, lidhur me sigurinë dhe rendin publik Komisioni Evropian kishte përcaktuar kriter për Kosovën, të miratojë dhe zbatojë legjislacionin për parandalimin, hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e krimit të organizuar dhe korrupsionin, duke përfshirë shpëlarjen e parave, dhe krimit financiar, konfiskimin dhe kthimin e aseteve, si dhe financimin e terrorizmit, në pajtim me *acquis* të BE-së duke siguruar se ndryshimet në këtë legjislacion po ashtu janë reflektuar në kodin penal.

a) Politikat e MD-së dhe zbatimi i tyre

Ministria e Drejtësisë në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi të saj, me qëllim të plotësimit të kriterëve për liberalizim të vizave por edhe lidhur me procesin e stabilizim asociimit kishte inicuar, hartuar dhe dërguar për miratim në Kuvend, përmes Qeverisë së Kosovës, një numër të madh të ligjeve, me qëllim të plotësimit të kriterëve për liberalizim të vizave. Që nga viti 2012, ishin miratuar Kodi i ri Penal dhe Kodi i ri i Procedurës Penale që kishin hyrë në fuqi më 1 janar 2013. Gjatë vitit 2013, ishin miratuar Ligji mbi kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale, Ligji mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në çështjet penale. Përderisa, në vitin 2015, ishin miratuar edhe Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit, plotësim ndryshimi i ligjeve të gjyqësorit, si ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, ligji për Gjykatat dhe ligji për Prokurorin e Shtetit. Gjatë vitit 2016, ishte miratuar ligj i ri lidhur me administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar. Gjatë kësaj periudhe kohore, Ministria e Drejtësisë një numër të ligjeve i kishte plotësuar dhe ndryshuar disa herë.

Ministria e Drejtësisë gjatë fundit të vitit 2016 dhe vitit 2017 ka filluar me rishikimin e sektorit të sundimit të ligjit në Kosovë, ku përfshihet edhe rishikimi i drejtësisë penale, proces ky që është në proces e sipër.

Përkundër miratimit të legjislacionit penal, Kosova përmes themelimit të një numri të madh të mekanizmave në luftimin e korrupsionit në Kosovë, ka ndikuar në shpërndarje të përgjegjësisë

¹ Udhërrëfyesi për Liberalizimin e vizave për Kosovën. (Shih vegzIn http://mei-ks.net/repository/docs/Udherrefyesi_per_Liberalizim_te_Vizave.pdf)

në luftimin e korrupsionit. “Kuatridhe institucional Anti-korrupsionit në Kosovë është i fragmentuar ndërsa organet kryesore kundër korrupsionit nuk janë të integruara mirë, kompetencat e tyre janë të shkelura dhe ndarja e detyrave është e paqartë. Kosova ka nevojë të forcojë koordinimin ndërinstytucional të mekanizmave dhe organeve.”²

Po ashtu Raporti Amerikan i Shtetit për Kosovën lidhur me praktikën e të drejtave të njeriut për vitin 2016, adreson çështjen e luftimit të korrupsionit në Kosovë. Sipas këtij raporti, dënimet lidhur me rastet e korrupsionit vazhdojnë të përfaqësojnë një pjesë të vogël të personave që hetohen dhe akuzohen për korrupsion.

Edhe në vitin 2017, politikat në letër lidhur me luftimin e korrupsionit nuk po gjejnë zbatim në praktikë në mënyrë të pavarur, paanshme dhe të drejtë.

b) Politikën e KPK-së dhe zbatimin e tyre

KPK më 1 dhjetor 2015, ka miratuar Planin Strategjik (2016-2018) dhe Planin e Veprimit për Ngritjen e Efikasitetit të Sistemit Prokurorial në Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, përfshirë Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Paligjshme (*në vazhdim: Plani i Veprimit*).³

Ky plan i veprimit vazhdon të mos jetë i qasshëm për publikun. Edhe në fund të vitit 2017, KPK nuk e ka publikuar Planin e Veprimit, edhe pse qëllimi i këtij plani ishte edhe ngritja e transparencës dhe llogaridhënies. Neni 4 i Planit të veprimit kishte paraparë themelimin e Komisionit Mbikëqyrës lidhur me trajtimin e lëndëve të korrupsionit nga prokuroritë, monitorimin e zbatimit të strategjisë dhe raportimit në KPK në baza tre mujore.

Zgjidhja e rasteve të korrupsionit sipas afateve të planit të veprimit - Neni 3 i Planit të veprimit ka paraparë që lëndët e pazgjidhur të korrupsionit, krimeve ekonomike, përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme të pranuar nga viti 2001 deri 2010, të përfundohen deri më 30 qershor 2016. KPK ka dështuar që këtë obligim ta zbatoj në praktikë. Ky dështim nga Komisioni Mbikëqyrës për zbatimin e Planit Strategjik dhe të Veprimit në Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike është raportuar si sukses në KPK. Sipas Komisionit, janë zgjidhur të gjitha lëndët e korrupsionit deri në vitin 2010 me përjashtim të tri lëndëve.⁴ Në sistemin prokurorial ka lëndë të pazgjidhura të korrupsionit të cilat datojnë qysh nga viti 2008,

² Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2016.

³ E. Miftaraj dhe B. Musliu, Deti i korrupsionit në Kosovë, “Peshqit” e vegjël kapen, të mëdhenjtë mbesin jashtë, faqe 10, Instituti i Kosovës për Drejtësi, mars 2017. (Shih vegzën <http://kli-ks.org/ep-content/uploads/2017/04/1.1.-Raporti-i-Korrupsionit-IKD-28.03.2017-Compressed.pdf>)

⁴ Komisioni Mbikëqyrës gjatë raportimit para KPK-së për raportin e vitit 2016 ka prezantuar vetëm tri raste të pakryera që i takojnë lëndëve të para vitit 2010. Prokurorja Laura Pula, gjatë prezantimit të raportit, ka thënë se prej këtyre tri lëndëve, dy prej tyre nuk janë zgjidhur me arsytimin se janë pezulluar për shkak të fletëarresteve ndërkombëtare në mungesë të të pandehurve, ndërsa një lëndë është në punë ende në fazën e grumbullimit të informatave. Raporti i Komisionit Mbikëqyrës të KPK-së. 1 shkurt 2017.

respektivisht lëndë të vjetra dhe të pazgjidhura për pothuajse 10 vite. IKD ka gjetur se deri më tani, PSh ka ende në punë 12 raste të pazgjidhura të korrupsionit me 27 persona të përfshirë që i takojnë periudhës nga vitet 2008 deri 2010. PSRK-së i kanë mbetur 3 raste të pazgjidhura me 7 persona, PTh në Mitrovicë i ka mbetur 1 rast i pazgjidhur me 2 persona, PTh në Ferizaj i ka mbetur 1 rast i pazgjidhur me 1 person dhe PTh në Prishtinë i kanë mbetur 7 raste të pazgjidhura me 17 persona të para vitit 2010.

Raportimi çdo tre muaj në KPK - Neni 4 i Planit të veprimit kishte paraparë themelimin e Komisionit Mbikëqyrës lidhur me trajtimin e lëndëve të korrupsionit nga prokuroritë, monitorimin e zbatimit të strategjisë dhe raportimit në KPK në baza tre mujore. Gjatë vitit 2017, i njëjti Komision ka raportuar dy herë para KPK-së. Komisioni Mbikëqyrës për herë të parë kishte raportuar para KPK-së gjatë muajit shtator 2016⁵. I njëjti Komision ka qenë i obliguar të raportoj para Këshillit çdo tre muaj lidhur me monitorimin e rasteve të korrupsionit të trajtuara nga Prokuroritë⁶. Për herë të dytë ky Komision ka raportuar tek në shkurt 2017⁷ ndërsa më 16 maj ka raportuar për herë të tretë.⁸ Komisioni Mbikëqyrës gjatë vitit 2016 ka gjetur mos përputhje sasiore të të dhënave në raport me numrin e lëndëve të mbetura në fund të periudhës paraprake.⁹ Komisioni Mbikëqyrës nuk ka ofruar rekomandime konkrete lidhur me trajtimin e lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike për periudhën janar-mars 2017.¹⁰ Një qasje e tillë e Komisionit dhe Këshillit dëshmojnë në praktikë mungesën e vullnetit për të përmbushur obligimet e tyre të miratuara nga KPK.

Raportimi për pasuri të sekuestruar dhe konfiskuar për veprat penale kundër korrupsionit - Plani i Veprimit ka përcaktuar se Koordinatorin Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike (KKLKE) do të monitoroj rastet që ndërlidhen me krimet ekonomike, përfshirë sekuestrimin dhe

⁵ Komisioni Mbikëqyrës për herë të parë ka raportuar para KPK-së më 16 shtator 2016.

⁶ *Shënim:* IKD i'u është drejtuar me kërkesa për qasje në dokumente publike KPK-së dhe Komisionit Mbikëqyrës lidhur me trajtimin e lëndëve të korrupsionit, lidhur me aktivitetet e ndërmarra lidhur me rastet e korrupsionit. KPK dhe Komisioni Mbikëqyrës nuk i janë përgjigjur pozitivisht asnjë kërkesë të IKD-së.

⁷ *Shënim:* Komisioni Mbikëqyrës lidhur me trajtimin e lëndëve të korrupsionit i KPK-së, për herë të dytë ka raportuar para anëtarëve të KPK-së më 1 shkurt 2017. Raportimi është bërë nga Kryetarja e këtij Komisioni, znj. Laura Pula. Raporti është bërë publik edhe në uebfaqe. (shih linkun <http://betimiperdrejtesi.com/kpk-miraton-transferimin-e-prokurorit-syle-hoxha-ne-prokurorine-speciale-te-republikes-se-kosoves/>). (Raportimi i kësaj mbledhje gjithashtu mund të gjendet në portalin betimiperdrejtesi.com në linkun <https://www.youtube.com/ëatch?v=btvTa4RK20M&feature=youtu.be>)

⁸ *Shënim:* Komisioni Mbikëqyrës lidhur me trajtimin e lëndëve të korrupsionit i KPK-së, për herë të tretë ka raportuar para anëtarëve të KPK-së më 16 maj 2017. Raportimi është bërë nga anëtari i këtij Komisioni, z. Haxhi Dërguti. Raporti është bërë publik edhe në uebfaqe. (shih linkun <http://betimiperdrejtesi.com/kpk-aprovon-raportin-mbikeqyres-per-luftimin-e-korrupsionit-dhe-krimeve-ekonomike/>)

⁹ Kryetarja e Komisionit Mbikëqyrës lidhur me trajtimin e lëndëve të korrupsionit, në takimin e mbajtur 1 shkurt 2017, ka raportuar se pas grumbullimit të të dhënave nga të gjithë prokurorët individualisht, komisioni ka gjetur mospërputhje sasiore të këtyre të dhënave në raport me numrin e lëndëve të mbetura në fund të periudhës paraprake.

¹⁰ Anëtari i Komisionit Mbikëqyrës, z. Haxhi Dërguti në takimin e mbajtur më 16 maj 2017, për periudhën janar-mars 2017 ka raportuar se ky Komision nuk ka ofruar rekomandime konkrete, mirëpo të njëjtat do të propozohen në raportin gjashtëmujor.

konfiskimin e pasurisë së paligjshme. KKLKE ka përmbushur obligimet e tij për raportuar para KPK-së lidhur me aktivitetet e tij lidhur me sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme. KKLKE ka raportuar dy herë gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2017, më 10 shkurt ka raportuar para KPK-së për periudhën korrik-dhjetor 2016 ndërsa më 29 maj ka raportuar për periudhën janar-mars 2017. Gjatë periudhës raportuese të këtij tre muajve ka informacion vetëm për një rast të veprave penale kundër korrupsionit. Bëhet fjalë për një konfiskim në vlerë të 100.000.00 eurove të cilat janë derdhur në buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë. Përkundër kësaj vazhdon të mbetet shqetësues fakti se ka asete për të cilat është raportuar se janë sekuestruar që nga viti 2000 e tutje, dhe të njëjtat nuk janë propozuar në aktakuza për konfiskim. Gjatë kësaj periudhe raportuese njëjtë sikur në vitin 2016 nuk ka pasur asnjë aktgjykim sa i përket konfiskimeve më të mëdha.¹¹ Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës edhe në këtë vit kanë vazhduar me jo efikasitetin në trajtimin e lëndëve për kërkesa për konfiskime përfundimtare. Në anën tjetër, Ligji për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale ka shumë të meta dhe është jo funksional. Sidoqoftë, KKLKE ka dështuar të ofroj informacion para KPK-së lidhur me kërkesat për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë së fituar përmes veprave penale kundër korrupsionit.

c) Politikat e KGJK-së dhe zbatimi i tyre

KGJK më 25 shtator 2015 ka miratuar Planin e Veprimit për zgjidhjen e lëndëve të korrupsionit. Përmes këtij plani KGJK kishte paraqitur situatën e përgjithshme, dobësitë lidhur me trajtimin e lëndëve të korrupsionit, identifikimin dhe ndarjen e lëndëve, përfshirë ndërmarrjen e aktiviteteve konkrete brenda afateve kohore praktike për rritjen e efikasitetit në trajtimin e lëndëve të korrupsionit. Plani kishte paraparë themelimin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Planit, me kompetenca të kufizuara vetëm sa i përket mbikëqyrjes së zbatimit të Planit të Veprimit.¹²

Plani i veprimit i KGJK-së për trajtimin me prioritet të rasteve të korrupsionit - KGJK në bashkëpunim me IKD-në, kanë hartuar Planin e Veprimit për KGJK për të trajtuar me prioritet rastet e korrupsionit. Ky plan ishte miratuar më 25 shtator 2015 nga KGJK¹³. Zbatimi i këtij plani vazhdon të sfidohet në praktikë, si rezultat i ngarkesës së gjykatësve me lëndë, por edhe si

¹¹ Koordinator kombëtar për luftimin e krimit ekonomik në takimin e mbajtur më 29 maj 2017 ka raportuar se kanë marrë përkrahje nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për konfiskim në 23 raste të cilat do të trajtohen me prioritet mirëpo në praktikë një gjë e tillë nuk ka ndodhur. (Raportimi i kësaj mbledhje gjithashtu mund të gjendet në portalin betimiperdrejtesi.com dhe në linkun <https://www.youtube.com/watch?v=1KoIKlietu4>)

¹² E. Miftaraj dhe B. Musliu, Korrupsioni në Kosovë, Luftimi apo Promovimi, faqe 16, Instituti i Kosovës për Drejtësi, prill 2016 (shih vegzën <http://kli-ks.org/wp-content/uploads/2016/04/01.-Korrupsioni-ne-Kosove-Luftimi-apo-promovimi-i-korrupsionit-27.04.20161.pdf>).

¹³ IKD ka mbështetur KGJK në hartimin e Planit të Veprimit për Rritjen e Efikasitetit të Sistemit Gjyqësor në trajtimin e lëndëve të korrupsionit. IKD kishte hartuar draftin e Planit të Veprimit për KGJK-në, i cili plan me disa plotësime ishte miratuar nga KGJK më 25 shtator 2015.

rezultat i mungesës së vullnetit për t'i trajtuar me prioritet absolut, siç përcaktohet në Planin e Veprimit.

Raportimi sipas afateve të përcaktuara në Planin e Veprimit - Përmes Planit të Veprimit, KGJK ka përcaktuar aktivitete konkrete dhe afate kohore praktike për rritjen e aktivitetit të trajtimit të lëndëve të korrupsionit. Afatet e parapara gjatë vitit 2016 dhe 2017 nuk janë respektuar nga Komisioni dhe KGJK. Raportet e Komisionit Mbikëqyrës edhe pse janë dërguar kohë pas kohe në KGJK¹⁴, për të njëjtat gjatë vitit 2017, Komisioni nuk ka raportuar asnjëherë para anëtarëve të KGJK-së. Komisioni ka raportuar vetëm njëherë para KGJK-së më 6 prill 2016.¹⁵

a) **Transparenca dhe llogaridhënia publike e sistemit gjyqësor dhe prokurorial**

KGJK dhe KPK në vazhdimësi proklamojnë ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies në raport me publikun dhe mediat. Të dy Këshillat kanë miratuar rregullore dhe strategji për të ngritur transparencën dhe llogaridhënien dhe për të lehtësuar bashkëpunimin me publikun dhe median.

IKD gjatë monitorimit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2017, ka adresuar 80 kërkesa për qasje në dokumente publike, lidhur me përmbushjen e obligimeve ligjore, ofrimit të informacioneve, statistikave dhe të dhënave tjera të disponueshme dhe lejueshme sipas Ligjit mbi Qasje në Dokumente Publike.

Nga 80 kërkesat për qasje në dokumente publike, sistemit gjyqësor i janë drejtuar 40 kërkesa, prej të cilave IKD ka pranuar 16 përgjigje pozitive apo në përqindje del të jetë 40%, ndërsa në 24 kërkesa nuk ka pranuar përgjigje, apo në 60%.

Nga 80 kërkesa për qasje në dokumente publike, sistemit prokurorial i janë adresuar 40 kërkesa, prej të cilave sistemi prokurorial iu është përgjigjur pozitivisht 1 kërkesës apo në përqindje del të jetë 2.5%, në 37 kërkesa nuk kanë kthyer përgjigje, apo në 92.5%, kurse në 2 kërkesa kanë refuzuar të japin të dhënat e kërkuara, apo në 5%. Mos zbatimi i obligimeve ligjore dhe politikave të miratuar nga të dy Këshillat, forcon gjetjet e IKD-së dhe vlerësimet e dala nga raporte ndërkombëtare dhe vendore lidhur me mungesën e vullnetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial për të qenë transparent dhe llogaridhënës para publikut. Mos përmbushja e obligimeve dëshmon se ligji në Kosovë nuk zbatohet njëjtë ndaj të gjithëve. Në rastet kur zyrtarët e lartë nuk përmbushin obligimet dhe përgjegjësitë e tyre, kultura pandëshkueshmërisë vazhdon të kultivohet.

¹⁴ Komisioni për Mbikëqyrjen e Lëndëve të Korrupsionit në Gjykata ka dërguar në KGJK raportet me shkrim për periudhat: Janar-Qershor 2017, Gusht 2017, Shtator 2017 dhe Nentor 2017.; Intervistë me z. Astrit Hoti – Drejtor i Departamentit Ligjor të KGJK-së

¹⁵ Shënim: Intervistë me Kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, z. Nehat Idrizi.

IV. Lufta kundër korrupsionit në sistemin prokurorial

Përkundër obligimeve ligjore, politikave të miratuara nga KPK dhe deklaratave të vazhdueshme në publik për luftimin e korrupsionit pa kompromis, në praktikë sistemi prokurorial vazhdon të sfidohet me mungesë të rezultateve konkrete.

Gjetjet e monitorimit sistematik të IKD-në sistemin prokurorial dhe sistemin gjyqësor, tregojnë se luftimi i korrupsionit është i koncentruar kryesisht në profilin e ulët dhe të mesëm. Gjetjet e monitorimit tregojnë se nga rastet e profilit të lartë të gjykuara gjatë vitit 2016, e të përfunduara në shkallë të parë deri në dhjetor 2017, 67% e tyre kanë dështuar në gjykata. Për dallim nga viti paraprak në gjashtë mujorin e parë të vitit 2017 janë ngritur aktakuza ndaj tre personave të profilit të lartë. Për dy prej këtyre personave (*Dalibor Jevtiq dhe Pal Lekaj*) kanë dështuar aktakuzat e prokurorëve qysh në fazën fillestare në gjykatë, ndërsa për personin e tretë (*Shukri Buja*) ende po vazhdon procedura gjyqësore.

Mbikëqyrja e zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit për trajtimin e rasteve të korrupsionit, nuk janë trajtuar asnjëherë seriozisht nga Komisioni i krijuar dhe vetë KPK. Qindra qytetarë të Republikës së Kosovës me vite e dekada vazhdojnë të mbahen peng dhe të shantazhohen me iniciimin e procedurave hetimore preliminare dhe hetimeve penale. Mos trajtimi i këtyre rasteve për vite të tëra, duke shkelur të gjitha afatet ligjore, përbën shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe cenim të sigurisë juridike të qytetarëve. Hetimet në raste të caktuara ka pasur raportime se janë keqpërdorur për të shantazhuar individ dhe biznese të caktuara.¹⁶

a) Hetimet në rastet e korrupsionit në sistemin prokurorial

Prokurori i Shtetit (PSh), vazhdon të sfidohet nga numri i madh i lëndëve të pazgjidhura të korrupsionit. Problemet më të mëdha vazhdojnë të mbesin tek numri i madh i lëndëve të pazgjidhura të trashëguara nga vitet paraprake. Përkundër miratimit të strategjive, planeve të veprimit dhe shtimit të numrit të prokurorëve në vitet e fundit, sistemi prokurorial ende nuk po arrin të përballojë me sukses trajtimin e lëndëve të korrupsionit në përputhje me obligimet kushtetuese dhe ligjore. Shqetësues mbetet fakti se sikurse në fillim ashtu dhe në fund të kësaj periudhe raportuese, numri i lëndëve të pazgjidhura të korrupsionit mbetet pothuajse i njëjtë. Rrjedhimisht, kjo nënkupton shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke përfshirë një numër të madh të qytetarëve në procedura hetimore, si rezultat i ushtrimit të kallëzimeve penale, të cilat nuk zgjidhen me vite. Kjo përbën shkelje ligjore në trajtimin e rasteve në kohë të arsyeshme, të përcaktuar me legjislacionin pozitiv si dhe cenon rëndë sigurinë juridike të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Kjo gjendje e lëndëve të korrupsionit në këtë periudhë raportuese të gjashtë mujorit të parë 2017 është paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë.

¹⁶ “Polici dyshohet se ka shantazhuar institucionet për interes të biznesit familjar”. “Koha Ditore” dhe Koha.net. 1 tetor 2016. (Shih vegzën <http://archive.koha.net/?id=&l=135333> - Shikuar për herë të fundit më 30.11.2017)

RASTET E KORRUPSIONIT NË SISTEMIN PROKURORIAL NË PERIUDHËN RAPORTUESE (01.01.2017 - 30.06.2017)												
Prokurori i Shtetit												
Prokurori i Shtetit	Të pazgjidhura në fillim (01.01.2017)		Të pranuar (01.01.2017 deri më 30.06.2017)		Të zgjidhura (01.01.2017 deri më 30.06.2017)		Mënyra e zgjidhjes				Të pazgjidhura në fund (30.06.2017)	
	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Hudhje	Pushim	Aktakuzë	Mënyrë tjetër	Raste	Persona
							Persona	Persona	Persona	Persona		
PSRK	40	162	3	10	10	27	1	7	17	2	26	119
Prishtinë	230	673	116	183	130	250	103	43	61	43	216	576
Prizren	24	51	19	43	26	79	6	26	34	13	23	48
Pejë	26	48	22	32	26	38	21	1	16		14	30
Gjilan	25	53	27	44	30	61	17	11	24	9	16	38
Mitrovicë	80	156	12	22	12	55	7	6	42		85	167
Ferizaj	17	47	10	28	6	16		4	12		23	71
Gjakovë	20	37	7	11	15	23	15	2	6		13	20
Total:	462	1,227	216	373	255	549	170	100	212	67	416	1069

Tabela 1 – Rastet e korrupsionit në sistemin prokurorial

Zvarritja në zgjidhjen e lëndëve është shqetësimi më i madh jo vetëm për luftimin e korrupsionit, por edhe për sigurinë juridike të qytetarëve. Vetëm në këtë periudhë raportuese të gjashtë mujorit të parë, në rastet e zgjidhura, rezulton se mbi gjysma e kallëzimeve penale janë hudhur poshtë apo janë pushuar hetimet. Prej 255 rasteve të zgjidhura të korrupsionit ku përfshihen 549 persona, ndaj 270 personave rezulton se nuk ka pasur prova dhe dëshmi që ata të mbahen padrejtësisht si subjekt të procedurave penale, duke ju prodhuar pasoja në jetën e tyre dhe duke ua rrezikuar sigurinë juridike.

Shqetësim tjetër në lidhje me këto lëndë të pazgjidhura të korrupsionit janë afatet ligjore të parashkrimit të ndjekjes penale, të cilat në disa raste kanë arritur dhe prokurorët janë detyruar të mbyllin rastet. Në këto raste krijohen dëme të pariparueshme si për palët e përfshira në këto raste si për amnistinë që arrihet për kryesit potencial të veprave penale të korrupsionit.

Parashtruesi më i madh i kallëzimeve penale vazhdon të mbetet, Policia e Kosovës, duke ngarkuar prokuroritë në nivel vendi me më së shumti raste të korrupsionit. Pas policisë si agjencion i pavarur në zbatimin e ligjit, pasojnë palët e dëmtuara dhe qytetarët, të cilët kanë denoncuar më së shumti raste korruptive. Në tabelën më poshtë është paraqitur në mënyrë të përmbledhur gjendje e lëndëve të korrupsionit në këtë periudhë raportuese të gjashtë mujorit të parë 2017 sipas parashtruesve të rasteve.


RASTET E KORRUPSIONIT NË SISTEMIN PROKURORIAL NË PERIUdhËN RAPORTUESE (01.01.2017 - 30.06.2017)						
PARASHTRUESIT E KALLËZIMEVE PENALE	Të pazgjidhura në fillim (01.01.2017)	Të pranuar (01.01.2017 deri më 30.06.2017)	Të zgjidhura (01.01.2017 deri më 30.06.2017)	Mënyra e zgjidhjes		Të pazgjidhura fund (30.06.2017)
	Persona	Persona	Persona	Hudhje Persona	Mënyrë tjetër Persona	Persona
Agjencia Kundër Korrupsionit	185	44	74	26	48	134
Agjencioni Kosovar i Pronës						
Administrata Tatimore	15		3	1	2	9
Doganat e Kosovës	21					22
EULEX	10					10
Inspektorati Policor i Kosovës	52	6	79	3	76	41
Policia e Kosovës	450	131	152	15	137	368
Qytetari	139	38	82	44	38	104
I dëmtuari	163	84	91	63	28	169
Administrata Komunale	2	2				6
Auditori i Përgjithshëm						
Titullari i Pronës	18	4	14		14	15
Autoriteti Pyjor i Kosovës						
Prokurori me Vetiniciativë	55	1	5	3	2	51
I pidentifikuar	1					1
Pranuar në kompetencë	116	63	49	15	34	139
Pa parashtrues						
Total:	1,227	373	549	170	379	1,069

Tabela 2 - Rastet e korrupsionit në fazën e grumbullimit të informatave sipas parashtruesve

IKD¹⁷ si rezultat i monitorimit të punës së PSh në trajtimin e rasteve të korrupsionit ka gjetur se edhe përkundër miratimit të politikave nga KPK lidhur me trajtimin e lëndëve të korrupsionit nëpër prokurori, PSRK dhe PTh në Prishtinë vazhdojnë të përballen me numër të madh të lëndëve të korrupsionit dhe vonesave në trajtimin e këtyre lëndëve.

Shqetësuese vazhdon të mbetet mënyra e zgjidhjes së rasteve të korrupsionit. Mbi 60 % e rasteve të korrupsionit janë mbyllur nga prokurorët. Shih grafikunin më poshtë.

¹⁷ *Shënim:* Instituti i Kosovës për Drejtësi përmes 14 monitoruesve në teren në mënyrë sistematike monitoron të gjitha rastet e korrupsionit në të gjitha gjykatat dhe prokuroritë e Kosovës. Për çdo rast të monitoruar të korrupsionit raportohet në kohe reale në ëëë.betimiperdrejtesi.com



Grafika 1 - Krahasimi i rasteve të mbyllura, ngritjes së aktakuzave dhe mënyrave tjera

Sipas grafikonit të lartë-përmendur, ndaj 549 personave që janë zgjidhur lëndët, rezultojnë se ndaj 270 personave ose 49.2% janë mbyllur rastet e korrupsionit, përkatësisht janë hudhur kallëzimet penale apo janë pushuar hetimet penale, ndaj 212 personave apo 38.6% janë ngritur aktakuza, ndërsa ndaj 67 personave apo 12.2% janë zgjidhur në mënyra tjera.

Grumbullimi i lëndëve të pazgjidhura të korrupsionit nëpër prokurori

Sistemi prokurorial ka shndërruar në praktikë moszbatimin dhe shkeljen e politikave dhe vendimeve të miratuara nga KPK. IKD gjen se vullneti i sistemit prokurorial në trajtimin e lëndëve të korrupsionit vazhdon të mbetet në hartim të politikave, të cilat nuk po zbatohen në praktikë. KPK ka hartuar Plan Veprimi, Plan Strategjik, ka themeluar Komisionin për Mbikëqyrje të zbatimit të Planit të Veprimit, ka themeluar Njësitet brenda Departamenteve të PTh në Prishtinë për luftimin e korrupsionit. Zbatimi i obligimeve në praktikë, vazhdon të mbetet i mangët.

Kjo dëshmohe me faktin se ende në sistemin prokurorial ka lëndë të pazgjidhura të korrupsionit që datojnë qysh nga viti 2008, respektivisht lëndë të vjetra dhe të pazgjidhura për pothuajse 10 vite. PSh ka ende në punë 12 raste të pazgjidhura të korrupsionit me 27 persona të përfshirë që i takojnë periudhës nga vitet 2008 deri 2010. PSRK-së i kanë mbetur 3 raste të pazgjidhura me 7 persona, PTh në Mitrovicë i ka mbetur 1 raste të pazgjidhura me 2 persona, PTh në Ferizaj i ka mbetur 1 rast i pazgjidhur me 1 person dhe PTh në Prishtinë i kanë mbetur 7 raste të pazgjidhura me 17 persona të para vitit 2010.

Raste të pazgjidhura me persona sipas prokurorive - PP (30.06.2017)	2008		2009		2010		2011		2012		2013		2014		2015		2016		2017		Total	
	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
PSRK					3	7	2	10	1	20	2	10	3	11	4	14	8	37	3	10	26	119
Prishtinë	4	9	1	1	2	7	6	59	4	13	5	30	33	85	27	104	45	105	89	163	216	576
Prizren															4	13	6	9	13	26	23	48
Pejë													2	3	3	12	3	7	6	8	14	30
Gjilan													1	1			3	15	12	22	16	38
Mitrovicë					1	2	1	1	4	6	1	4	12	24	26	54	28	52	12	24	85	167
Ferizaj					1	1							1	1	4	18	8	20	9	31	23	71
Gjakovë											3	9			3	4	4	4	3	3	13	20
TOTALI	4	9	1	1	7	17	9	70	9	39	11	53	52	125	71	219	105	249	147	287	416	1,069

Tabela 3 – Rastet e pazgjidhura të korrupsionit më 30.06.2017

Grumbullimi i lëndëve të pazgjidhura të korrupsionit sipas parashtruesve të rasteve

PSh më 30 qershor 2017, ka përfunduar me 416 raste të korrupsionit të pazgjidhura me 1069 persona subjekt të procedurave penale të korrupsionit. Numri më i madh i lëndëve të pazgjidhura vazhdon të mbetet tek lëndët e parashtruara nga Policia e Kosovës.

PP – Parashtruesit në fund të periudhës raportuese (30.06.2017)	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	Total
AKK	4				24	23	25	15	21	22	134
ATK						1	4		4		9
Doganat						9		11		2	22
EULEX			2	6	1			1			10
IPK					2		2	18	11	8	41
PK	4	1	12	6	7	11	67	76	99	85	368
Qytetari			3	15		5	6	11	39	25	104
I dëmtuari				2		4	8	42	28	85	169
Titullari i pronës	1				5		2	1	2	4	15
Prok. vetiniciat.				40			2		8	1	51
Pranuar kompet.							8	43	35	53	139
Admin. Kom.							1	1	2	2	6
Paidentifikuar				1							1
Totali	9	1	17	70	39	53	125	219	249	287	1,069

Tabela 4 – Rastet e pazgjidhura të korrupsionit sipas parashtruesve

b) Hetimet preliminare në rastet e korrupsionit në sistemin prokurorial

Inicimi i hetimeve preliminare tashmë është shndërruar në një prej mjeteve më të shpeshta të persekutimit të qytetarëve, duke i mbajtur peng dhe të shantazhuar për shkak të mos trajtimit të këtyre rasteve për vite e dekada të tëra. Në këtë fazë, policia obligohet të grumbullojë informacione për t’ia ofruar prokurorisë, e cila duhet të vendos brenda 30 ditëve të hudh rastin apo të nxjerrë aktvendim për fillimin e hetimeve. Gjetjet e monitorimit të IKD-së dëshmojnë se ka raste të korrupsionit të denoncuar në vitin 2004, të cilat ende nuk janë trajtuar dhe evidentohen si raste të hapura. Kjo do të thotë se qytetarët e përfshirë në këto raste prej vitit 2004, vazhdojnë të mbahen peng dhe të shantazhuar me mundësinë që ndaj tyre të iniciohen procedura hetimore penale. Fakti se një lëndë e hetimeve preliminare e vitit 2004 ende mbahet në sirtarë, përkundër arritjes së afatit të parashkrimit të ndjekjes penale, dëshmon se këto raste përdoren nga sistemi i drejtësisë për t’i mbajtur peng dhe për t’i shantazhuar qytetarët, të cilët përfshihen në këto denoncime.

Për zgjidhjen e këtyre rasteve përgjegjësi mbajnë prokurorët dhe policët, të cilët duhet të tregojnë përkushtim dhe profesionalizëm më të madh në zhvillimin e hetimeve preliminare, për t’i definuar rastet, dhe aty ku ka elemente të veprave penale të avancohen hetimet penale, ndërsa në ato rastet ku nuk ka elemente të tilla të hudhen pretendimet në mënyrë që personat, ndaj të cilëve

ngriten pretendime pa bazë, të lirohen nga çfarëdo ngarkese në evidencat penale të sistemit të drejtësisë, në këtë rast prokurorisë dhe policisë.

Përfshirja e prokurorëve në fazën parapenale dhe bashkëpunimi me agjencitë tjera që e zbatojnë ligjin në Kosovë është në një shkallë të ulët. Në rrethana të tilla, Prokurori i Shtetit pranon informata të paverifikuara nga këto agjenci, të cilat trajtohen pas shumë vitesh dhe mbi 80 % e tyre hudhen. Kjo ka ndikim të drejtpërdrejt edhe në punën e prokurorëve, të cilët investojnë kohë të madhe në hudhjen e këtyre raporteve informuese. Më 30 qershor 2017, janë 1248 persona, të cilët figurojnë në evidenca se ndaj tyre zhvillohen hetime preliminare për vepra penale të korrupsionit. Në tabelën në vazhdim vëreni rastet dhe personat e vjetra sipas viteve në secilën prokurori.

RASTET PPN TË KORRUPSIONIT NË SISTEMIN PROKURORIAL (01.01.2017 - 30.06.2017)										
PROKURORI SHTETIT PPN	Prokurori i Shtetit									
	Të pazgjidhura në fillim (01.01.2017)		Të pranuar (01.01.2017 deri më 30.06.2017)		Rastet e zgjidhura me persona (01.01.2017 deri më 30.06.2017)		Mënyra e zgjidhjes		Të pazgjidhura në fund (30.06.2017)	
	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Hudhje Persona	Mënyrë tjetër Persona	Raste	Persona
PSRK	57	140	3	8	5	12	10	2	52	120
Prishtinë	397	698	97	116	140	228	195	33	388	699
Prizren	43	64	13	34	17	32	24	8	45	75
Pejë	70	111	33	66	33	44	41	3	63	119
Gjilan	4	4	5	7	3	5	5	0	3	5
Mitrovicë	54	77	11	12	2	2	2	0	65	91
Ferizaj	57	98	16	30	8	11	11	0	56	88
Gjakovë	22	29	17	29	15	21	21	0	32	51
Total:	704	1,221	195	302	223	355	309	46	704	1248

Tabela 5¹⁸ - Rastet e korrupsionit në fazën e grumbullimit të informatave

¹⁸ Shënim: Informatat nga kjo tabelë janë gjeneruar nga Mekanizmi Përcjellës për Harmonizimin e Raporteve Statistike. Këshilli Prokurorial i Kosovës.

KPK gjatë vitit 2015, ka themeluar Njësitin Antikorrupsion, Krimeve Ekonomike, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Paligjshme në PTh në Prishtinë, në Departamentin për Krime të Rënda dhe Departamentin e Përgjithshëm. IKD ka vlerësuar se “duke pasur parasysh volumin e madh të lëndëve në PTh në Prishtinë si dhe faktin se afërsisht 60% të lëndëve të korrupsionit apo krimeve ekonomike në tërë Kosovën, janë në punë në këtë prokurori, themelimi i këtij Njësi mund të vlerësohet si objektiv strategjik që do të rezultoj me ngritjen e efikasitetit të sistemit prokurorial në trajtimin dhe luftimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimeve ekonomike, nëse ka vullnet dhe përkushtim”.¹⁹

Edhe përkundër themelimit të këtij Njësi dhe caktimit të prokurorëve nga KPK më detyrë të veçantë në trajtimin e lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike, rezultatet e pritura mungojnë. Edhe përkundër që ky Njësi ishte themeluar në vitin 2015, me qëllim të zvogëlimit të rasteve të korrupsionit, në fakt ende nuk ka arritur të zgjidhë as lëndët e vjetra PNN deri në vitin 2004.

Nga rastet e zgjidhura ndaj 355 personave, PSh ndaj 309 personave ka hudhur informatat e pranuar lidhur me dyshimet për korrupsion në këto raste, respektivisht del se PSh në 80% të këtyre rasteve i ka mbyllur.

Tabela e më poshtme paraqet rastet e korrupsionit me persona sipas parashtruesve të kallëzimeve penale, të cilat kanë mbetur të pazgjidhura më 30 qershor 2017. Nga rastet e pazgjidhura ndaj 1248 personave, numri më i madh i tyre i takojnë rasteve të parashtruara nga PK me 383 persona, pasuar nga i dëmtuari me 238 persona dhe qytetarët me 202 persona.

¹⁹ Miftaraj E. dhe Musliu B. “Korrupsioni në Kosovë: Luftimi apo Promovimi i Korrupsionit”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. Prill 2016. Fq. 12. (Shih linkun <http://kli-ks.org/ep-content/uploads/2016/04/01.-Korrupsioni-ne-Kosove-Luftimi-apo-promovimi-i-korrupsionit-27.04.20161.pdf>)

RASTET E KORRUPSIONIT NË SISTEMIN PROKURORIAL NË PERIUdhËN RAPORTUESE (01.01.2017 - 30.06.2017)							
PARASHTRUESIT E KALLËZIMEVE PENALE PPN	Të pazgjidhura në fillim (01.01.2017)	Të pranuar (01.01.2017 - 30.06.2017)	Të zgjidhura (01.01.2017 - 30.06.2017)	Mënyra e zgjidhjes			Të pazgjidhura në fund (30.06.2017)
	Persona	Persona	Persona	Hudhje Persona	Aktakuzë Persona	Mënyrë tjetër Persona	
Agjencia Kundër Korrupsionit	21						23
Agjencioni Kosovar i Pronës	1						1
Administrata Tatimore		7					7
Doganat e Kosovës	3						2
EULEX	5		2	2			5
Inspektorati Policor i Kosovës	48	2	2	2			51
Policia e Kosovës	385	123	123	102	5	16	383
Qytetari	180	44	42	33		9	202
I dëmtuari	258	47	83	80		3	238
Administrata Komunale	6	6					10
Titullari i Pronës	13		10	10			9
Autoriteti Pyjor i Kosovës							
Prokurori me Vetiniciativë	13	2	5	5			8
Pranuar në kompetencë	288	71	88	75		13	309
Total:	1,221	302	355	309	5	41	1248

Tabela 6²⁰ - Rastet e korrupsionit në fazën e grumbullimit të informatave sipas parashtruesve

Lëndët e vjetra PPN të pazgjidhura sipas parashtruesve të informatave

IKD ka gjetur se edhe tek lëndët e regjistruara PPN, ka raste të vjetra të cilat nuk janë trajtuar nga PSh që datojnë nga viti 2004 dhe 2006 kur janë raportuar. Sipas tabelës së më poshtme, në këto dy lëndë, informatat lidhur me dyshimin e kryerjes së veprës penale janë parashtruar prej të dëmtuarve nga veprat penale të korrupsionit. Mungesa e një sistemi efikas të trajtimit të rasteve të korrupsionit në një kohë të arsyeshme dhe brenda afateve ligjore ndikon drejtpërdrejtë në besimin e qytetarëve në sistemin prokurorial të Kosovës. IKD nga monitorimi i rasteve të korrupsionit, ka gjetur se mos trajtimi apo zgjidhja e rasteve të korrupsionit për vite të tëra apo në raste të caktuara edhe mbi 10 vite dëshmon mungesën e vullnetit dhe përgjegjësisë për të trajtuar rastet e korrupsionit me prioritet, dhe vë në pah neglizhencën dhe jo seriozitetin e

²⁰ Shënim: Informatat nga kjo tabelë janë gjeneruar nga Mekanizmi Përcjellës për Harmonizimin e Raporteve Statistikore. Këshilli Prokurorial i Kosovës.

sistemit prokurorial. Në tabelën më poshtë janë paraqitur rastet e pazgjidhura të parashtruesve të informatave për veprat penale të korrupsionit.

PPN Parashtrues të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese (30.06.2017)	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	Total
AKK					5			11	1	3	2	1			23
EULEX										4		1			5
Dogana										2					2
IPK										1	8	25	14	3	51
PK					1			18	11	30	56	69	101	97	383
Qytetari								3	6	7	27	34	86	39	202
I dëmtuari	1		1						3	26	9	52	108	38	238
Adm. Komunal											1	2	1	6	10
Tit. i Pronës									3		2	3	1		9
Prok. Vetëinici										2	1	2	2	1	8
AKP										1					1
ATK														7	7
Pranuar komp				1					3	3	3	58	190	51	309
Totali	1		1	1	6			32	27	79	109	247	503	242	1248

Tabela 7 – Rastet e pazgjidhura të korrupsionit sipas parashtruesve më 30.06.2017

Në tabelën më poshtë janë paraqitur rastet e pazgjidhura të informatave për veprat penale të korrupsionit për secilën prokurori.

Raste të pazgjdhura me persona sipas prokurorive - PPN (30.06.2017)	2004		2005		2006		2007		2008		2009		2010		2011		2012		2013		2014		2015		2016		2017		Total		
	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	
PSRK															1	2	1	2	3	5	12	34	19	46	14	28	2	3	52	120	
Prishtinë	1	1			1	1	1	1	2	6					7	30	10	15	22	48	25	40	73	10	16	34	84	10	38	699	
Prizren																					5	10	10	19	22	29	8	17	45	75	
Pejë																				2	6	4	4	9	27	25	31	23	51	63	119
Gjilan																												3	5	3	5
Mitrovicë																6	10	7	12	11	11	18	28	14	20	9	10	65	91		
Ferizaj																			7	8	5	6	9	14	23	36	12	24	56	88	
Gjakovë																					4	4	6	8	10	14	12	25	32	51	
TOTAL	1	1			1	1	1	1	2	6					8	32	17	27	41	79	66	10	14	24	27	50	15	24	70	124	

Tabela 8 – Rastet e pazgjdhura të korrupsionit sipas prokurorive më 30.06.2017

c) Ngritja e aktakuzave për korrupsion dhe profili i të akuzuarve

IKD ka vazhduar me monitorimin dhe analizimin e profilit të kryesve të veprave penale të korrupsionit në bazë të informatave të publikuara nga PSh në faqen zyrtare të Prokurorit të Shtetit, lidhur me aktakuzat kundër kryesve të veprave penale të korrupsionit gjatë gjashtëmujorit të parë 2017.

Profili i pozitive të personave ndaj të cilëve janë ngritur aktakuzat, përfshinë: Ministër, ish Kryetarë Komune, zyrtarë policor dhe zyrtarë tjerë kryesisht të nivelit të ultë. Sipas aktakuzave të ngritura nga Prokuroritë, nuk ka informacion sa i përket vlerës së dëmit të shkaktuar me këto vepra penale, përderisa në këto aktakuza nuk ka as informacion nëse prokuroritë kanë paraqitur kërkesa për sekuestrim apo konfiskim të pasurisë së fituar me veprë penale.

Prokuroritë me efikase gjatë kësaj periudhe kohore janë, PSRK me 5 raste me 19 persona të përfshirë në akte akuzuese, dhe PTh në Prizren me 3 aktakuza kundër 25 personave të përfshirë.


Data	Pozita e personit të akuzuar	Vlera e dëmit të shkaktuar	Kërkesa për sekuestrim/konfiskim	Numri i personave	Prokuroria
12.01.2017	1 Zyrtar I MTI	s'ka info	s'ka info	2	PSRK
	1 Biznesmen	s'ka info	s'ka info		
23.01.2017	1 Zyrtar	s'ka info	s'ka info	1	PSRK
13.02.2017	1 ish Kryetar Komune	s'ka info	s'ka info	10	PSRK
	8 Zyrtar	s'ka info	s'ka info		
	1 ndërtues	s'ka info	s'ka info		
14.02.2017	1 ish Kryetar Komune	s'ka info	s'ka info	3	PSRK
	1 ish-drejtor për buxhet dhe financa	s'ka info	s'ka info		
	1 ish menaxher prokurimit	s'ka info	s'ka info		
24.02.2017	4 Zyrtar policorë	s'ka info	s'ka info	4	PTh Prizren
01.03.2017	1 Zyrtar policorë	s'ka infor	s'ka info	1	PTh Prizren
02.02.2017	20 Zyrtar policorë	s'ka info	s'ka info	20	PTh Prizren
15.03.2017	1 Ministër	s'ka info	s'ka info	3	PSRK
	1 Sekretar i Përgjithshëm	s'ka info	s'ka info		
	1 Drejtor	s'ka info	s'ka info		

Tabela 9 – Profili i të akuzuarve për korrupsion dhe vlera e sekuestrimeve dhe konfiskimeve

D) Analizë krahasuese e ngritjes së aktakuzave për korrupsion dhe profili i ndjekjes

IKD në vazhdimësi ka monitoruar dhe analizuar profilin e kryesve të veprave penale të korrupsionit në bazë të informatave të publikuara nga PSh lidhur me aktakuzat kundër kryesve të veprave penale të korrupsionit.

Bazuar në të dhënat e publikuara, IKD ka bërë krahasimin e numrit të aktakuzave të ngritura në periudha gjashtëmujore (*gjashtëmujori i parë 2016, gjashtëmujori i dytë 2016 dhe gjashtëmujori i parë 2017*) dhe numrin e personave të akuzuar në këto raste. Analiza krahasuese dëshmon se numri i aktakuzave të ngritura gjatë gjashtëmujorit të parë 2017 është dukshëm më i ulët sesa ai i gjashtëmujorit të parë 2016 dhe gjashtëmujorit të dytë 2016.




Grafika 2: Analizë krahasuese e aktakuzave të ngritura për veprat penale të korrupsionit (Gjashtëmujori i parë 2016, gjashtëmujori i dytë 2016 dhe gjashtëmujori i parë 2017)

Përderisa në gjashtëmujorin e parë 2016 janë ngritur 19 aktakuza për raste të korrupsionit në të cilat përfshihen 149 persona, në gjashtëmujorin e dytë 2016 numri i aktakuzave të ngritura ka rënë në 18 aktakuza me 134 persona të akuzuar. Mirëpo, në krahasim me këta dy gjashtëmujor, në gjashtëmujorin e parë 2017 numri i aktakuzave të ngritura për raste të korrupsionit ka rënë në 8 aktakuza me 44 persona të akuzuar.

Në vazhdim, IKD ka bërë edhe krahasimin e numrit të personave të akuzuar për vepra penale të korrupsionit në periudha gjashtëmujore (*gjashtëmujori i parë 2016, gjashtëmujori i dytë 2016 dhe gjashtëmujori i parë 2017*), e që i takojnë profilit të lartë.

Analiza krahasuese dëshmon se numri i personave të akuzuar gjatë gjashtëmujorit të parë 2017 për vepra penale të korrupsionit, e që i takojnë profilit të lartë, është më i ulët sesa ai i gjashtëmujorit të parë dhe të dytë të vitit 2016.



Grafika 3: Analiza krahasuese e personave të akuzuar për vepra penale të korrupsionit që i pakojnë profilit të lartë (Gjashtëmujori i parë 2016, gjashtëmujori i dytë 2016 dhe gjashtëmujori i parë 2017)

Përderisa në gjashtëmujorin e parë 2016 janë ngritur aktakuza ndaj 6 personave që i takojnë profilit të lartë (2 ish Kryetar Gjykatë, 1 Kryetar Komune, 1 ish Deputet dhe 2 ish Ministra), në gjashtëmujorin e dytë 2016 ky numër ka rënë në 4 persona (1 Kryetar Komune, 1 ish Kryetar Komune, 1 Deputet dhe 1 ish Deputet). Ndërkaq në gjashtëmujorin e parë 2017 janë 3 persona të akuzuar që i takojnë profilit të lartë (2 ish Kryetarë Komune dhe 1 Ministër).

Kjo dëshmon se Prokurori i Shtetit ka ndërtuar një retorikë për luftimin e korrupsionit, ndërsa në praktikë mungojnë rezultatet, të cilat priten nga qytetarët e Republikës së Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare në Kosovë.²¹

²¹ Shënim: Qytetarët vazhdojnë të shprehen se besimi i tyre në sistemin e drejtësisë është shumë i ulët dhe se mirëqenia e tyre dhe perspektiva evropiane varen drejtpërdrejtë nga luftimi i korrupsionit. Të njëjtat kërkesa janë vendosur si kritere nga Bashkimi Evropian, i cili si një ndër dy kushtet kryesore për të përfituar liberalizim të vizave për qytetarët e Kosovës, ka vendosur luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar.

IKD ka analizuar rastet e gjykuara gjatë vitit 2016, në të cilat janë të përfshirë persona të profilit të lartë. Gjetjet e monitorimit tregojnë se nga rastet e përfunduara në shkallë të parë deri më tani, 67% e tyre kanë dështuar në gjykata. Nga 33 personat e profilit të lartë të akuzuar dhe gjykuar gjatë vitit 2016, ndaj shtatë (7²²) prej tyre është shpallur aktgjykim dënues nga shkalla e parë, ndaj nëntë (9²³) prej tyre është shpallur aktgjykim lirues, ndaj një (1²⁴) personi është shpallur aktgjykim refuzues, ndaj katër (4²⁵) prej tyre është hudhur aktakuza, ndërsa ndaj dymbëdhjetë (12²⁶) prej tyre është duke vazhduar procesi gjyqësor. Ndërkaq, për shtatë persona ndaj të cilëve është shpallur aktgjykim dënues, shkalla e dytë - Gjykata e Apelit - e ka vërtetuar dënimin për 1 person²⁷, ndërsa e ka ndryshuar aktgjykimin për 3 persona²⁸ nga ai dënues në atë lirues. Ndërkaq, për 3 persona Gjykata e Apelit ende nuk ka marrë vendim.

²² Personat që i takojnë profilit të lartë, ndaj të cilëve është shpallur aktgjykim dënues nga shkalla e parë janë: Kryetari i Komunës së Dragashit Salim Jenuzi, Kryetari i Komunës së Klllokotit Sreqko Spasiq, Kryetari i Komunës së Parteshit Dragan Nikoliq, ish-Rektori i Universitetit Publik të Prishtinës Enver Hasani, ish-Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Astrit Haraçija, ish-Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Valton Beqiri dhe ish-Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit Hysni Hoxha.

²³ Personat që i takojnë profilit të lartë, ndaj të cilëve është shpallur aktgjykim lirues janë: ish-Ministri i Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit Fatmir Limaj, ish-Rektori i Universitetit Publik të Prizrenit Mazllum Baraliu, ish-Kryeprokurorja e Prokurorisë Themelore të Gjakovës Shpresa Bakija, ish-Kryeshefi Ekzekutiv i PTK Shyqyri Haxha, ish-Kryetari i Komunës së Malishevës Ragip Begaj, Kryetari i Komunës së Parteshit Dragan Nikoliq, ish-Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit Hysni Hoxha, , ish-Kryetari i Komunës së Drenasit Nexhat Demaku dhe ish-Kryetari i Komunës së Obiliqit Mehmet Krasniqi.

²⁴ Personi që i takon profilit të lartë, ndaj të cilit është shpallur aktgjykim refuzues është: ish-Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit Hysni Hoxha.

²⁵ Personat që i takojnë profilit të lartë, ndaj të cilëve është hudhur aktakuza janë: ish-Kryetari i Komunës së Vushtrrisë Muharrem Shabani, ish-Kryetari i Gjykatës Kushtetuese Enver Hasani, Kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri dhe Kryetari i Komunës së Mitrovicës Agim Bahtiri.

²⁶ Personat që i takojnë profilit të lartë, ndaj të cilëve është duke vazhduar shqyrtimi gjyqësor janë: ish-Deputeti Ukë Rugova, ish-Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Astrit Haraçija, ish-Deputeti Naser Osmani, ish-Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë Ferid Agani, ish-Kryetari i Gjykatës së Apelit Salih Mekaj, , Kryetari i Komunës së Klllokotit Sreqko Spasiq, ish-Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit Hysni Hoxha, ish-Kryetari i Komunës së Skenderajit Sami Lushtaku, ish-Deputeti Azem Syla, ish-Kryetari i Komunës së Gjilanit Qemajl Mustafa, ish-Deputeti Etem Arifi dhe ish-Kryetari i Komunës së Klinës Sokol Bashota.

²⁷ Gjykata e Apelit e ka vërtetuar aktgjykimin dënues të shpallur ndaj Kryetarit të Komunës së Klllokotit Sreqko Spasiq.

²⁸ Gjykata e Apelit e ka ndryshuar aktgjykimin nga ai dënues në atë lirues në rastin ndaj ish-Ministrit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Astrit Haraçija, ish-Ministrit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Valton Beqiri dhe ish-Kryetarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit Hysni Hoxha



Grafika 4 – Krahasimi i aktakuzave që janë vërtetuar dhe rrëzuar nga gjykatat themelore

I. Llogaridhënia e prokurorëve

Si rezultat i gjetjeve të IKD-së të publikuara në shtatë raporte, ZPD deri më tash ka përfshirë 571 raste në hetime preliminare ndaj prokurorëve. Prej tyre janë përfshirë në hetime disiplinore 25 lëndë të prokurorëve, ku përfshihen 17 raste. Prej tyre 9 raste me shkelje të vërtetuara disiplinore nga ZPD janë dërguar në Komisionin Disiplinor të KPK-së. Nga rastet e iniciuara nga gjetjet e IKD-së, 4 hetime disiplinore janë mbyllur me gjetje, 4 hetime disiplinore janë në procedurë të hetimit, 39 lëndë janë refuzuar, 246 lëndë janë refuzuar pas hetimit preliminar.²⁹ Vetëm për raportin e publikuar nga IKD në mars 2017, ZPD ka iniciuar hetime preliminare në 178 lëndë të korrupsionit të trajtuara nga prokurorët dhe gjykatësit.³⁰

Sa i përket gjetjeve nga raporti i IKD-së “Luftimi i korrupsionit, prioritet në letër” i publikuar më 10.12.2015, ZPD ka kryer hetime preliminare për të gjitha rastet e evidentuara (56 lëndë) dhe ka marr një numër të madh të deklaratave nga prokurorët të cilët kanë qenë të ngarkuar me lëndët e përshkruara si në raport. Është kërkuar nga prokurorët të deklarohen me gjetjet e IKD-së, përkatësisht ZPD-së. Pas grumbullimit të informacioneve, shqyrtimit dhe analizimit të tyre, ZPD ka konsideruar se, të gjeturat duhet dërguar për vlerësim në Komisionin për Shqyrtimin e Performacës së Prokurorëve në KPK. Veprimi i tillë është bërë nga ZPD sepse gjetjet pretendohet se, kanë të bëjnë me performancën e prokurorëve në punë. Pasi që raporti me gjetje është dërguar në Komisionin për Shqyrtimin e Performacës së Prokurorëve në KPK, ZPD është informuar nga Kryesuesi i KPK-së se raportin e ka dërguar për vlerësim në Komisionin e lartë cekur.

Sa i përket gjetjeve nga raporti i IKD-së “Korrupsioni në Kosovë: Luftimi apo promovimi i korrupsionit” i publikuar më 27.04.2016, ZPD ka kryer hetime preliminare (grumbullimi i informacioneve të 111 lëndëve) për të gjitha rastet e evidentuara dhe ka marr një numër të madh të deklaratave nga prokurorët (22 deklarata) të cilët kanë qenë të ngarkuar me lëndët e përshkruara si në raport. Është kërkuar nga prokurorët të deklarohen lidhur me gjetjet e IKD-së përkatësisht ZPD-së. Njëjtë edhe këto raste janë dërguar për vlerësim në Komisionin për Shqyrtimin e Performacës së Prokurorëve në KPK.

²⁹ *Burimi*: Të dhënat zyrtare të ZPD-së të ofruara përmes postës elektronike për IKD. Dhjetor 2017.

³⁰ *Burimi*: Drejtori i ZPD-së, z. Zef Prendrecaj në një përgjigje me shkrim përmes postës elektronike ka njoftuar se vetëm për dy raportet e fundit të IKD-së, janë iniciuar 257 hetime preliminare në lëndët e korrupsionit të trajtuara nga prokurorët. “Raporti i VI – Korrupsioni në Kosovë: Luftimi apo promovimi i korrupsionit (27.04.2016) Në lidhje me të gjeturat nga ky raport, ZPD ka kryer hetime preliminare (grumbullimi i informacioneve të 111 lëndëve) për të gjitha rastet e evidentuara dhe ka marr një numër të madh të deklaratave nga prokurorët (22 deklarata) të cilët kanë qenë të ngarkuar me lëndët e përshkruara si në raport. Është kërkuar nga prokurorët të deklarohen me të gjeturat e IKD-së, përkatësisht ZPD-së. Raporti i VII – Korrupsioni në Kosovë: Retorika në luftimin e Korrupsionit (27.10.2016) Në lidhje me të gjeturat nga ky raport, ZPD është duke ndërmarr hetime preliminare (grumbullimi i informacioneve të 146 lëndëve). Pas grumbullimit të informacioneve, shqyrtimit dhe analizimit të tyre, ZPD, do t’ju mbajë të informuar me epilogun e rasteve dhe të gjeturat.” IKD intervistë me z. Zef Prendrecaj, Drejtor i ZPD-së. Mars 2017.

Sa i përket gjetjeve nga raporti i IKD-së, “Korrupsioni në Kosovë: Retorika në luftimin e Korrupsionit” i publikuar më 27.10.2016, ZPD është duke ndërmarr hetime preliminare (grumbullimi i informacioneve të 146 lëndëve). ZPD ka bërë grumbullimin e gjitha informacioneve relevante, ka bërë shqyrtimin dhe analizimit të tyre dhe njëjtë i ka dërguar për vlerësim në Komisionin për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorëve në KPK.

Sa i përket gjetjeve nga raporti i IKD-së, “Korrupsioni në Kosovë: Deti i Korrupsionit në Kosovë” i publikuar më 28 mars 2017, ZPD është duke ndërmarr hetime preliminare (grumbullimi i informacioneve të 178 lëndëve). ZPD ka bërë grumbullimin e gjitha informacioneve relevante, ka bërë shqyrtimin dhe analizimit të tyre. ZPD është në fazën përfundimtare të vendosjes së këtyre rasteve.

RASTET E HETIMEVE NGA ZYRA E PROKURORIT DISIPLINOR TË INICUARA PREJ RAPORTEVE TË IKD-SË									
Raportet e publikuara të IKD-së	Lëndë të përfshira në hetime preliminare	Lëndë të përfshira në hetime disiplinore	Raste të përfshira në hetime disiplinore	Hetimet disiplinore të dërguara në Komisionin Disiplinor	Hetime disiplinore të mbyllura me gjetje	Hetime disiplinore në procedurë të hetimit	Lëndë të përfshira në refuzim	Refuzim pas hetimit preliminar	Rastet në fazën e vendosjes
Korrupsioni në Kosovë - I –	26	21	14	6	4	4	5	1	
Korrupsioni në Kosovë - II –	16	1	1	1			15	1	
Korrupsioni në Kosovë - III -	29							29	
Korrupsioni në Kosovë-IV -	22	3	2	2			19	2	
V Luftimi i korrupsionit në Kosovë-Prioritet në letër (10.12.2015)	56							56	
VI Korrupsioni në Kosovë: Luftimi apo promovimi i korrupsionit (27.04.2016)	111							111	
VII Retorika në luftimin e korrupsionit (27.10.2016)	146							146	
VIII. “Deti” i Korrupsioni në Kosovë (28.03.2017)	178								178
Total:	571	25	17	9	4	4	39	246	178

Tabela 9 – Rastet e hetimeve të iniciuara nga ZPD prej gjetjeve të raporteve të IKD-së.

ZPD vazhdimisht sfidohet në punën e saj për zhvillimin e hetimeve në rastet e gjetjeve nga raportet e IKD-së. Drejtuesit e ZPD-së vazhdimisht kanë vlerësuar se pas grumbullimit të shkresave, informacioneve dhe veprimeve tjera që ka ndërmarrë bazuar në gjetjet e raporteve të IKD-së kanë vërejtur se ka filluar të përmirësohet puna për rastet e ngjashme (gjetjet në raporte) përkatësisht të ngritët llogaridhënia.

II. Lufta kundër korrupsionit në sistemin gjyqësor

Retorika e përditshme e krerëve institucional, duke filluar prej kreut të shtetit deri tek të gjithë bartësit e funksioneve prokuroriale e gjyqësore nuk dallon në fushën e luftimit të korrupsionit. Pa dallime ata vazhdimisht kanë dhënë premtime të fuqishme se *“askush nuk është mbi ligjin dhe se korrupsioni do të luftohet pa kompromis”*. Në praktikë, lufta kundër korrupsionit ka përfshirë kryesisht profilin e ulët dhe të mesëm të korrupsionit, ndërsa profili i lartë i korrupsionit mbetet i pandëshkuar. Në disa raste të ndjekjes së profilit të lartë, prokurorët kanë dështuar të argumentojnë aktakuzat e tyre në gjykata, duke kthyer luftën kundër korrupsionit në bumerang për sistemin e drejtësisë, duke humbur besimin e qytetarëve.


IKD është organizata e vetme, e cila prej qershorit 2015 monitoron sistematikisht të gjitha rastet e veprave penale të korrupsionit në të gjitha Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës. Ekipi i monitoruesve të IKD-së, prej qershorit 2015, vazhdimisht në baza të përditësuar kanë vizituar të gjitha Gjykatat dhe Kryetarët e Gjykatave Themelore për të monitoruar për së afërmi secilin proces gjyqësor që ndërlihet me veprat penale kundër korrupsionit. Monitorimi ka përfshirë procesin e identifikimit të rasteve të korrupsionit në punë, caktimin dhe ndarjen në punë të lëndëve, informacionet se në cilën fazë të procedurës gjenden këto raste në gjykata dhe raportimin e tyre për publikun në baza ditore përmes uebfaqes.³¹ Sfidat në identifikimin e rasteve të korrupsionit, sigurimin e orarit të seancave gjyqësore si dhe sigurimin e të dhënave për rastet (ku përfshihet historiku i lëndës prej paraqitjes së kallëzimit penal deri të mbajtja e seancave gjyqësore) kanë qenë dhe mbasin të vazhdueshme për monitoruesit e IKD-së.³² Sidoqoftë, IKD

³¹ IKD në bashkëpunim me Radio Televizionin Publik bashkëprodhojnë emisionin e specializuar për fushën e sundimit të ligjit “Betimi për Drejtësi”. Krahas kësaj, është zhvilluar edhe portali “Betimi për Drejtësi”, në të cilin përveç hulumtimeve, analizave dhe debateve që zhvillohen në emision, publikohen në baza të përditësuar edhe raportet e monitoruesve të IKD-së për të gjitha rastet e korrupsionit. Raportimi bëhet në rubrikën e veçantë të portalit, të cilat gjenden në këtë link <http://betimiperdrejtesi.com/lajme/>

³²GjTh-të ende nuk kanë një sistem efikas dhe efektiv të azhurnimit të bazës së të dhënave për orarin e mbajtjes së seancave gjyqësore në përgjithësi dhe në veçanti për rastet e korrupsionit. Fillimisht, IKD ka vendosur komunikim përmes Kryetarëve të GjTh-ve dhe më pas përmes zëdhënësve të këtyre gjykatave, të cilët kanë informuar monitoruesit e IKD-së për orarin e caktimit të seancave gjyqësore për rastet e korrupsionit. Megjithatë, kjo praktikë nuk ka funksionuar në mënyrën më të mirë, sepse zëdhënësit kanë dërguar tek monitoruesit e IKD-së informacione jo të plota dhe jo të sakta për orarin e seancave, gjë që ka shkaktuar probleme për monitorimin e tyre. Ky komunikim përditë ka avancuar, megjithatë ende ka probleme praktike që ndërlihen me orarin e seancave gjyqësore në rastet e korrupsionit. Duke parë këto sfida, IKD duke shfrytëzuar legjisllacionin pozitiv për të pasur qasje në të gjitha informatat e nevojshme rreth këtyre rasteve, ka nënshkruar Memorandum të Bashkëpunimit KGJK,

pret që këto sfida të tejkalohen me kohë në praktikë meqë KGJK dhe IKD kanë Memorandum të Bashkëpunimit³³, i cili ka për qëllim lehtësimin qasjen e monitoruesve të IKD-së në gjykata, komunikimin, bashkëpunimin dhe koordinimin.

Monitoruesit e IKD-së, nga 1 janari e deri më 30 qershor 2017 kanë monitoruar 702 seanca gjyqësore, ku përfshihen 255 raste të korrupsionit me 761 persona. Shih tabelën më poshtë.



Grafika 5 – Rastet e korrupsionit të monitoruara nga IKD (1 janar – 30 qershor 2017)

a) Analiza e rasteve të monitoruara për periudhën gjashtë mujore (01.01.2017 – 30.06.2017)


Në këtë raport, subjekt i hulumtimit dhe analizës janë rastet e korrupsionit të monitoruara gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2017 (*janar, shkurt, mars, prill, maj, qershor 2017*), ndërsa rastet tjera do të trajtohen në raportin e radhës. Sa i përket gjashtëmujorit të parë të vitit 2017, IKD ka monitoruar 702 seanca gjyqësore, ku përfshihen 255 raste të korrupsionit me 761 persona³⁴. Në grafikonin më poshtë janë paraqitur numri i seancave dhe rasteve të korrupsionit të monitoruara

përmes të cilit mundësohet një qasje, komunikim, bashkëpunim dhe koordinim më i mirë në mes të monitoruesve të IKD-së dhe KGJK-së, përkatësisht të gjitha niveleve të Gjykatave dhe Kryetarëve.

³³ Memorandumi i Bashkëpunimit në mes të KGJK-së dhe IKD-së është aprovuar unanimisht nga të gjithë anëtarët e KGJK-së në mbledhjen e mbajtur më 6 prill 2016, ndërsa është nënshkruar mes drejtuesve të KGJK-së dhe IKD-së më 7 prill 2016. Prishtinë, 7 prill 2016.

³⁴ Sqarim: IKD përgjatë muajit janar ka monitoruar 93 seanca gjyqësore, ku përfshihen 70 raste të korrupsionit me 231 persona. Gjatë muajit shkurt janë monitoruar 111 seanca gjyqësore, ku përfshihen 84 raste të korrupsionit me 274 persona. Gjatë muajit mars janë monitoruar 140 seanca gjyqësore, ku përfshihen 103 raste të korrupsionit me 325 persona. Gjatë muajit prill janë monitoruar 136 seanca gjyqësore, ku përfshihen 92 raste të korrupsionit me 282 persona. Gjatë muajit maj janë monitoruar 108 seanca gjyqësore, ku përfshihen 80 raste të korrupsionit me 329 persona. Ndërkaq, gjatë muajit qershor janë monitoruar 114 seanca gjyqësore, ku përfshihen 84 raste të korrupsionit me 255 persona. Megjithatë, marr parasysh faktin se një rast i monitoruar në janar, ka vazhduar edhe gjatë pesë muajve të tjerë, nga kjo del se analiza e raportit për këtë muaj do të përfshijë 255 raste të korrupsionit me 761 persona.

nga IKD. Gjithashtu janë paraqitur edhe numri i seancave të mbajtura dhe të shtyra për arsye të ndryshme.



Grafika 6 – Rastet e monitoruara gjyqësore në periudhën 1 janar 2017 deri më 30 qershor 2017.

Numri më i madh i seancave gjyqësore të monitoruara përfshinë GjTh në Prishtinë, me 370 seanca të monitoruara, prej tyre 229 seanca janë mbajtur, ndërsa 141 seanca janë shtyrë. GjTh në Prizren pason me 96 seanca gjyqësore të monitoruara, prej tyre 66 seanca janë mbajtur, 30 seanca janë shtyrë. Në Gjth në Gjilan janë monitoruar 74 seanca gjyqësore, prej tyre 54 seanca janë mbajtur, 20 seanca janë shtyrë. Në Gjth në Pejë janë monitoruar 60 seanca gjyqësore, prej tyre 38 seanca janë mbajtur, 22 seanca janë shtyrë. Numri më i vogël i rasteve të caktuara të korrupsionit i referohen GjTh në Mitrovicë me 42 seanca gjyqësore të monitoruara prej të cilave 29 seanca janë mbajtur ndërsa 13 seanca janë shtyrë, GjTh në Gjakovë me 31 seanca gjyqësore të monitoruara prej të cilave 26 seanca janë mbajtur ndërsa 5 seanca janë shtyrë, dhe GjTh në Ferizaj me 29 seanca gjyqësore të monitoruara ku 21 seanca janë mbajtur ndërsa 8 seanca janë shtyrë.


- Përgjatë seancave gjyqësore të monitoruara nga IKD gjatë kësaj periudhe raportuese (janar, shkurt, mars, prill, maj, qershor 2017), janë identifikuar parregullsi të ndryshme. Nga 702 seanca të monitoruara, 463 prej tyre janë mbajtur, ndërkaq si pasojë e mosplotësimit të kushteve ligjore për mbajtjen e seancave 239³⁵ prej tyre janë shtyrë. IKD, sjell sipas tabelës së më poshtme arsyet e shtyrjes së 239 seancave gjyqësore.

Arsyet e shtyrjes së seancave gjyqësore të monitoruara gjatë periudhës raportuese (Janar-Qershor 2017)	Mungesa e të akuzuarve	Mungesa e mbrojtësve	Mungesa e gjykatësve	Mungesa e dëshmitarëve	Mungesa e prokurorit	Mungesa e palës së dëmtuar	Mungesa e ekspertit	Mungesa e më shumë se një pale në procedurë	Me kërkesë të mbrojtësve	Me kërkesë të gjykatësit	Me kërkesë të prokurorit	Tjera	Total
GjTh në Prishtinë	41	7	22	8	29	1	1	8	9	2	2	11	141
GjTh në Prizren	12	1	5	2	1	0	2	0	3	1	1	2	30
GjTh në Pejë	1	5	2	1	7	0	1	0	0	2	1	2	22
GjTh në Gjiilan	9	3	3	1	1	0	0	1	1	0	0	1	20
GjTh në Mitrovicë	4	3	0	1	3	1	0	1	0	0	0	0	13
GjTh në Ferizaj	2	1	2	1	0	0	0	1	0	0	0	1	8
GjTh në Gjakovë	1	0	0	0	0	0	1	1	2	0	0	0	5
Total	70	20	34	14	41	2	5	12	15	5	4	17	239

Tabela 10 - Arsyet e shtyrjes së seancave gjyqësore të rasteve të korrupsionit të monitoruara gjatë gjashtëmuajorit të parë 2017

Shprehur në përqindje, del se numri më i madh i seancave janë shtyrë për shkak të mungesës së të akuzuarve, për shkak të mungesës së prokurorit dhe për shkak të mungesës së gjykatësve. IKD, sjell sipas grafikës së më poshtme përqindjen e arsyeve të shtyrjes së 239 seancave gjyqësore.

³⁵ Sqarim: 35 seanca janë shtyrë gjatë muajit janar, 38 seanca janë shtyrë gjatë muajit shkurt, 38 seanca janë shtyrë gjatë muajit mars, 37 seanca janë shtyrë gjatë muajit prill, 48 seanca janë shtyrë gjatë muajit maj dhe 43 seanca janë shtyrë gjatë muajit qershor.



Grafika 7 - Arsyet e shtyrjes së seancave gjyqësore të rasteve të korrupsionit të monitoruara gjatë gjashtëmuajorit të parë 2017

IKD ka identifikuar parregullsi edhe në seancat e proceduara. Prej 463 seancave të mbajtura, 145 prej tyre kanë filluar me mbi 15 minuta vonesë dhe atë:

- 99 raste në GJTh Prishtinë
- 13 raste në GJTh Ferizaj
- 9 raste në GJTh Gjilan
- 8 raste në GJTh Pejë
- 8 raste në GJTh Prizren
- 7 raste në GJTh Gjakovë
- 1 rast në GJTh Mitrovicë

Si arsye më të shpeshta të vonesës janë identifikuar vonesa e: Gjykatësit/Trupit Gjyqësor, Prokurorit, në disa raste Avokatit/Mbrojtësit dhe Dëshmitarëve.

Gjatë monitorimit janë vërejtur edhe parregullsi tjera që kanë penguar zhvillimin e seancave gjyqësore. Prej 463 seancave të mbajtura, në 84 prej tyre monitoruesit e IKD-së kanë gjetur shkeljet si në vijim:

- Mbajtja e seancave në zyrë (21 raste)
- Mosrespektimi i veshjes së uniformës nga gjyqtarët, prokurorët dhe mbrojtësit (19 raste)
- Hapja e telefonit gjatë seancës nga gjyqtarët (10 raste)

- Hapja e telefonit gjatë seancës nga prokurorët (4 raste)
- Mossigurimi i shkresave të lëndës për mbrojtësit, nga ana e prokurorit (4 raste)
- Shkelja e nenit 3, pika 3.1, të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë, ku parashihet që gjyqtari gjatë ushtrimit të funksionit të tij, nuk duhet, qoftë me fjalë, gjeste apo sjellje, të shfaq anshmëri apo paragjykim, ndaj cilitdo individ apo grup. (4 raste)
- Lejimi i prokurorit apo avokatit për rimarrje në pyetje të dëshmitarit, pas trupit gjykues (3 raste)
- Fillimi i mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor pa plotësimin e trupit gjykues (2 raste)
- Mos fillimi rishtazi i shqyrtimit gjyqësor pas ndërrimit të trupit gjykues (2 raste)
- Mbajtja e shqyrtimit gjyqësor pa u ftuar pala e dëmtuar (2 raste)
- Qëndrimi i njërit të akuzuar në sallë gjatë marrjes në pyetje të akuzuarit tjetër (2 raste)
- Qëndrimi i njërit dëshmitar në sallë gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit tjetër (2 raste)
- Qëndrimi i njërit dëshmitarë në sallë gjatë marrjes në pyetje të akuzuarit (1 rast)
- Mos leximi i të drejtave të akuzuarve para marrjes në pyetje (1 rast)
- Mos leximi i aktakuzës në shqyrtim fillestar (1 rast)
- Mungesa e përkthimit nga gjuha serbe në gjuhën shqipe për palët prezente në sallë (1 rast)
- Ri-hapja e shqyrtimit gjyqësor pas paraqitjes së provave të reja, pa praninë e mbrojtësit të akuzuarit (1 rast)
- Shkelja e renditjes së paraqitjes së provave sipas nenit 327, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (1 rast)
- KTGJ ka caktuar shqyrtimin gjyqësor ende pa vendosur rreth kërkesës për kundërshtimin e provave dhe hudhjen e aktakuzës. Andaj ka vepruar në kundërshtim me nenin 254, paragrafi 6 të KPP-së, i cili parasheh: “Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues ende nuk ka vendosur për kundërshtimet nga neni 249 apo kërkesat nga neni 250 të këtij Kodi, ai merr aktvendim me shkrim të arsyetuar për të gjitha propozimet e pazgjidhura pas shqyrtimit të dytë. Ai cakton shqyrtimin gjyqësor me urdhër me shkrim, të cilin e nxjerr në të njëjtën kohë me aktvendimin apo aktvendimet me shkrim për propozimet e lartpërmendura”. (1 rast)
- KTGJ megjithëse ka vendosur rreth kërkesës së të akuzuarit për kundërshtimin e provave dhe hudhjen e aktakuzës, nuk e ka caktuar shqyrtimin gjyqësor. Me këtë rast ka vepruar në kundërshtim me nenin 254, paragrafi 5, të KPP-së, i cili parasheh: “Gjatë shqyrtimit të dytë, gjyqtari i procedurës paraprake ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtimin gjyqësor, përveç nëse ende nuk ka marr aktvendim mbi kundërshtimet e paraqitura nga neni 249 apo kërkesat nga neni 250 të këtij Kodi”. (1 rast)
- Vazhdimi i shqyrtimit gjyqësor për disa minuta pas largimit të anëtarit të trupit gjykues nga salla (1 rast)

b) Vonesat e prokurorive në procedimin e aktakuzave në gjykata

IKD gjatë monitorimit të rasteve të korrupsionit në prokurori dhe gjykata ka vërejtur në praktikë fenomenin e zvarritjes së dërgimit të aktakuzave nga prokurorët në gjykata. IKD ka identifikuar gjashtë (6) raste të tilla në të gjitha gjykatat e Kosovës. IKD, sjell sipas tabelës së më poshtme rastet në të cilat prokurorët me vonesë i kanë dërguar aktakuzat në gjykatë.

Në rastin e PTh në Gjiilan, me numër të aktakuzës PP.I.nr. 50/15, është konstatuar vonesë prej 31 ditëve që nga data kur aktakuza është përpiluar nga prokurori deri në datën kur e njëjta aktakuzë është dërguar në gjykatë.

Në rastin e PTh në Prishtinë, me numër të aktakuzës PP/I.nr.1168/2014, është konstatuar vonesë prej 28 ditëve që nga data kur aktakuza është përpiluar nga prokurori deri në datën kur e njëjta aktakuzë është dërguar në gjykatë.

Në rastin e PTh në Prishtinë, me numër të aktakuzës PP.nr. 218-7/08, është konstatuar vonesë prej 26 ditëve që nga data kur aktakuza është përpiluar nga prokurori deri në datën kur e njëjta aktakuzë është dërguar në gjykatë.

Në rastin e PTh në Prishtinë, me numër të aktakuzës PP.nr.5345-4/11, është konstatuar vonesë prej 13 ditëve që nga data kur aktakuza është përpiluar nga prokurori deri në datën kur e njëjta aktakuzë është dërguar në gjykatë.

Në rastin e PTh në Prishtinë, me numër të aktakuzës PP.I.nr. 112/2016, është konstatuar vonesë prej 12 ditëve që nga data kur aktakuza është përpiluar nga prokurori deri në datën kur e njëjta aktakuzë është dërguar në gjykatë.

Në rastin e PTh në Pejë, me numër të aktakuzës PP/I.nr.23/2015, është konstatuar vonesë prej 11 ditëve që nga data kur aktakuza është përpiluar nga prokurori deri në datën kur e njëjta aktakuzë është dërguar në gjykatë.

Zvarritjet e prokurorëve në procedimin e aktakuzave në gjykata					
Gjykatat Themelore dhe Degët e Gjykatave Themelore		Nr. i Aktakuzës	Data e përpilimit të Aktakuzës nga Prokuroria	Data e ngritjes së aktakuzës në Gjykatë	Vonesa
1	Gjilan	PP.I.nr.50/15	05.10.2015	05.11.2015	31 ditë
2	Prishtinë	PP/I.nr.1168/2014	30.09.2015	28.10.2015	28 ditë
3	Prishtinë	PP.nr.218-7/08	17.09.2008	13.10.2008	26 ditë
4	Prishtinë	PP.nr.5345-4/11	26.10.2011	08.11.2011	13 ditë
5	Prishtinë	PP.I.nr. 112/2016	16.09.2016	28.09.2016	12 ditë
6	Pejë	PP/I.nr.23/2015	28.01.2016	08.02.2016	11 ditë

Tabela 11 -Zvarritjet prokurorëve në procedimin e aktakuzave në gjykata

c) Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore

Dështimet në respektimin e afateve ligjore në trajtimin e rasteve të korrupsionit paraqiten në të gjitha hallkat e sistemit të drejtësisë, përfshi zvarritjet në polici, prokurori dhe gjykata.³⁶ Zvarritjet në zgjidhjen e rasteve ndikojnë drejtpërdrejt në shkeljen e të drejtave të qytetarëve të Republikës së Kosovës,³⁷ të cilat garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.³⁸

IKD edhe në këtë periudhë raportuese të monitorimit, ka identifikuar shkeljet e institucioneve të drejtësisë në trajtimin e rasteve të korrupsionit. IKD përmes monitorimit të trajtimit të rasteve të korrupsionit në prokurori dhe gjykata, përfshi të gjitha fazat e procedurës penale, paraqet gjendjen reale se sa kohë iu merr institucioneve përgjegjëse për trajtimin e një lënde të korrupsionit, prej kohës së inicimit të kallëzimit penal deri në shpalljen e aktgjyqimit.

Prej 702 seancave gjyqësore të monitoruara në shtatë GjTh, ku për analizë përfshihen 255 raste të korrupsionit, IKD ka identifikuar shkelje në të gjitha fazat e procedurës penale. IKD ka vendosur disa indikatorë për të matur në secilën fazë të procedurës penale kohën e kaluar për trajtimin e rastit përfshi: 1) kohën e trajtimit të kallëzimit penal deri në fillimin e hetimeve; 2) kohën e trajtimit prej fillimit të hetimeve deri në përfundimin e hetimeve; 3) kohën e trajtimit prej fillimit të hetimeve deri në ngritjen e aktakuzës; 4) kohën e trajtimit prej përfundimit të hetimeve deri në ngritjen e aktakuzës; 5) kohën e trajtimit prej ngritjes së kallëzimit penal deri në ngritjen


³⁶ Miftaraj E. dhe Musliu B. “Luftimi i korrupsionit në Kosovë, prioritet në letër”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. Prishtinë, 10 dhjetor 2015.

³⁷ Raporti i vjetor i punës 2014,Nr.14. Fq. 137. Avokati i Popullit. Prishtinë 2015. (Shih linkun http://ëëë.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/RAPORTI_2014_-_SHQIP_932837.pdf). (Qasur për herë të fundit më 20 shkurt 2017).

³⁸Neni 31 “E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm”. Kushtetuta e Republikës së Kosovës. 15 qershor 2008.

e aktakuzës; 6) koha prej ngritjes së aktakuzës deri në caktimin e shqyrtimit fillestar; 7) koha prej shqyrtimit fillestar deri në caktimin e shqyrtimit të dytë; 8) koha prej shqyrtimit të dytë deri në caktimin e shqyrtimit kryesor; 9) numri i seancave të mbajtura dhe 10) koha e trajtimit prej caktimit të shqyrtimit kryesor deri në shpalljen e aktgjykimit në shkallë të parë.

Bazuar në këta indikatorë, IKD ka bërë matjen e 226³⁹ rasteve të korrupsionit të monitoruara në këtë periudhë raportuese (janar – qershor 2017). Edhe gjatë kësaj periudhe raportuese, gjetjet e IKD-së tregojnë se prokurorët dhe gjykatësit vazhdimisht shkelin afatet e përcaktuara ligjore në Kodin e Procedurës Penale. Në tabelën më poshtë, IKD ka paraqitur të gjithë indikatorët e fazave të caktuara të procedurës penale dhe mesataren e kohës së kaluar për secilën fazë⁴⁰.



Grafika 8 – Mesatarja e kohëzgjatjes së procedurave penale në 226 raste të monitoruara të korrupsionit

³⁹ Sqarim: Në këtë analizë nuk janë përfshirë 29 raste e korrupsionit të kthyera në rigjykim, pasi për këto raste është bërë analizë e veçantë.

⁴⁰ Shënim: Matjet e realizuara për secilin indikatorë në secilën fazë dallojnë për sa i përket numrit të rasteve. IKD ka bërë matjet dhe analizat vetëm për aq raste sa ka arritur të kompletoj të dhënat për secilën fazë të procedurës penale të vendosur në indikatorë.

Siç vërehet në tabelë, nga mesatarja e kohëzgjatjes së procedurave penale në 226⁴¹ rastet e korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se prokuroritë dhe gjykatat në faza të ndryshme të procedurës penale nuk respektojnë⁴² afatet ligjore të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

- Në 195 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se mesatarja e trajtimit të kallëzimit penal nga prokurorët është 217 ditë.
- Në 201 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se mesatarja e trajtimit prej fillimit të hetimeve deri në përfundimin e hetimeve është 200 ditë.
- Në 203 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se mesatarja e trajtimit prej fillimit të hetimeve deri në ngritjen e aktakuzës është 204 ditë.
- Në 218 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se mesatarja e trajtimit prej përfundimit të hetimeve deri në ngritjen e aktakuzës është 1 ditë.
- Në 16 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se mesatarja e trajtimit të kallëzimit penal deri në ngritjen e aktakuzës së drejtpërdrejtë është 316 ditë.
- Në 204 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se mesatarja e trajtimit prej ngritjes së aktakuzës deri në mbajtjen e shqyrtimit fillestar është 249 ditë.
- Në 107 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se mesatarja e trajtimit prej seancës fillestare deri në mbajtjen e shqyrtimit të dytë është 66 ditë.
- Në 71 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se mesatarja e trajtimit prej shqyrtimit të dytë deri në mbajtjen e shqyrtimit kryesor është 142 ditë.
- Në 224 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se mesatarja e seancave të mbajtura për secilin rast është 4 seanca.
- Në 51 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se mesatarja e trajtimit prej caktimit të shqyrtimit kryesor deri në shpalljen e aktgjykimit është 266 ditë.

Në vazhdim është analizuar mesatarja e kohës së kaluar në secilën fazë të procedurës penale, për të gjitha rastet e monitoruara për secilën prokurori dhe gjykatë.

⁴¹*Sqarim:* IKD bën të qartë se për secilin indikatorë, për të cilët është nxjerrë mesatarja, është bazuar në rastet në të cilat janë kompletuar të dhënat dhe numri i rasteve për secilin indikatorë ndryshon. Pra, siç mund ta vëreni në tabelë, kalkulimet janë bërë vetëm për numrin e rasteve për të cilat ekzistojnë të gjitha të dhënat.

⁴² *Shënim:* Bazuar në procedurën e re penale, prej kohës së paraqitjes së kallëzimit penal, prokurori ka kohë që brenda 30 ditëve të vendos nëse do të fillojë hetimin apo të hudhë kallëzimin penal. Ky kufizim i afatit kohor nuk ka qenë i përcaktuar në procedurën e vjetër penale dhe kjo ju ka krijuar mundësi të keqpërdorimit prokurorëve, të cilët me dekada nuk kanë ndërmarr asnjë veprim ligjor në trajtimin e kallëzimeve penale. Koha prej fillimit të hetimeve deri në përfundimin e hetimeve mund të marr kohë 24 muaj, eventualisht nëse rasti është i komplikuar hetimi mund të zgjatet nga Gjykata edhe për gjashtë (6) muaj. 2. Prokurori i shtetit menjëherë një kopje të aktvendimit sipas paragrafit 1. të këtij neni ia dërgon policisë.3. Prokurori i shtetit brenda tetë (8) ditësh nga hudhja e kallëzimit njofton të dëmtuarin për hudhjen e kallëzimit dhe arsyet për këtë. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës. 13 dhjetor 2012. Miftaraj E. dhe Musliu B. “Luftimi i korrupsionit në Kosovë, prioritet në letër”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. Faqe 89, 90. Dhjetor 2015.

Prokuroritë që kanë kaluar më së shumti kohë në trajtimin e kallëzimeve penale janë PTh në Prishtinë, PTh në Mitrovicë dhe PTh në Gjakovë. Mesatarja e trajtimit të kallëzimit penal deri në vendimin për fillimin e hetimeve nëpër prokurori ka marrë kohë si në vijim:

- PTh në Prishtinë për 96 raste të monitoruara ka marr kohë 331 ditë.
- PTh në Mitrovicë për 19 raste të monitoruara ka marr kohë 272 ditë.
- PTh në Gjakovë për 9 raste të monitoruara ka marr kohë 130 ditë.
- PTh në Pejë për 15 raste të monitoruara ka marr kohë 121 ditë.
- PTh në Ferizaj për 9 raste të monitoruara ka marr kohë 96 ditë.
- PTh në Gjilan për 27 raste të monitoruara ka marr kohë 38 ditë.
- PTh në Prizren për 20 raste të monitoruara ka marr kohë 26 ditë.

Prokuroritë që kanë kaluar më së shumti kohë në hetimet penale janë PTh në Ferizaj, PTh në Gjakovë dhe PTh në Mitrovicë. Mesatarja e trajtimit prej fillimit të hetimeve deri në përfundimin e hetimeve nëpër prokurori ka marrë kohë si në vijim:

- PTh në Ferizaj për 9 raste të monitoruara ka marr kohë 361 ditë.
- PTh në Gjakovë për 10 raste të monitoruara ka marr kohë 241 ditë.
- PTh në Mitrovicë për 20 raste të monitoruara ka marr kohë 224 ditë.
- PTh në Pejë për 15 raste të monitoruara ka marr kohë 219 ditë.
- PTh në Prishtinë për 99 raste të monitoruara ka marr kohë 218 ditë.
- PTh në Prizren për 20 raste të monitoruara ka marr kohë 154 ditë.
- PTh në Gjilan për 28 raste të monitoruara ka marr kohë 73 ditë.

Prokuroritë që kanë kaluar më së shumti kohë prej fillimit të hetimeve deri në ngritjen e aktakuzave janë PTh në Ferizaj, PTh në Gjakovë dhe PTh në Prishtinë. Mesatarja e trajtimit prej fillimit të hetimeve deri në ngritjen e aktakuzës nëpër prokurori ka marrë kohë si në vijim:

- PTh në Ferizaj për 9 raste të monitoruara ka marr kohë 361 ditë.
- PTh në Gjakovë për 10 raste të monitoruara ka marr kohë 243 ditë.
- PTh në Prishtinë për 101 raste të monitoruara ka marr kohë 226 ditë.
- PTh në Mitrovicë për 20 raste të monitoruara ka marr kohë 225 ditë.
- PTh në Pejë për 15 raste të monitoruara ka marr kohë 221 ditë.
- PTh në Prizren për 20 raste të monitoruara ka marr kohë 155 ditë.
- PTh në Gjilan për 28 raste të monitoruara ka marr kohë 76 ditë.

Prokuroritë që kanë kaluar më së shumti kohë prej përfundimit të hetimeve deri në ngritjen e aktakuzës janë PTh në Prishtinë dhe PTh në Gjilan. Mesatarja e trajtimit prej përfundimit të hetimeve deri në ngritjen e aktakuzës nëpër prokurori ka marrë kohë si në vijim:

- PTh në Prishtinë për 112 raste të monitoruara ka marr kohë 2 ditë.
- PTh në Gjilan për 28 raste të monitoruara ka marr kohë 2 ditë.
- PTh në Mitrovicë për 23 raste të monitoruara ka marr kohë 1 ditë.
- PTh në Prizren për 20 rast të monitoruara ka marr kohë 1 ditë.
- PTh në Pejë për 15 raste të monitoruara ka marr kohë 1 ditë.
- PTh në Gjakovë për 10 raste të monitoruara ka marr kohë 1 ditë.
- PTh në Ferizaj për 10 raste të monitoruara ka marr kohë 1 ditë.

Gjykatat që kanë kaluar më së shumti kohë prej ngritjes së aktakuzës deri në mbajtjen e shqyrtimit fillestar janë GjTh në Mitrovicë, GjTh në Ferizaj dhe GjTh në Prishtinë. Mesatarja e kohës prej ngritjes së aktakuzës deri në mbajtjen e shqyrtimit fillestar nëpër gjykata ka marrë kohë si në vijim:

- GjTh në Mitrovicë për 19 raste të monitoruara ka marr kohë 609 ditë.
- GjTh në Ferizaj për 11 raste të monitoruara ka marr kohë 249 ditë.
- GjTh në Prishtinë për 106 raste të monitoruara ka marr kohë 246 ditë.
- GjTh në Gjiilan për 27 raste të monitoruara ka marr kohë 235 ditë.
- GjTh në Pejë për 14 raste të monitoruara ka marr kohë 163 ditë.
- GjTh në Gjakovë për 9 raste të monitoruara ka marr kohë 96 ditë.
- GjTh në Prizren për 18 raste të monitoruara ka marr kohë 49 ditë.

Gjykatat që kanë kaluar më së shumti kohë prej seancës fillestare deri në mbajtjen e shqyrtimit të dytë janë GjTh në Gjiilan, GjTh në Prishtinë dhe GjTh në Pejë. Mesatarja e kohës prej seancës fillestare deri në mbajtjen e shqyrtimit të dytë nëpër gjykata ka marrë kohë si në vijim:

- GjTh në Gjiilan për 1 rast të monitoruar ka marr kohë 84 ditë.
- GjTh në Prishtinë për 76 raste të monitoruara ka marr kohë 73 ditë.
- GjTh në Pejë për 8 raste të monitoruara ka marr kohë 59 ditë.
- GjTh në Prizren për 16 raste të monitoruara ka marr kohë 51 ditë.
- GjTh në Gjakovë për 5 raste të monitoruara ka marr kohë 31 ditë.
- GjTh në Mitrovicë për 1 rast të monitoruar ka marr kohë 21 ditë.

Gjykatat që kanë kaluar më së shumti kohë prej shqyrtimit të dytë deri në mbajtjen e shqyrtimit kryesor janë GjTh në Mitrovicë, GjTh në Prishtinë dhe GjTh në Gjiilan. Mesatarja e kohës prej shqyrtimit të dytë deri në mbajtjen e shqyrtimit kryesor nëpër gjykata ka marrë kohë si në vijim:


- GjTh në Mitrovicë për 1 rast të monitoruar ka marr kohë 248 ditë.
- GjTh në Prishtinë për 45 raste të monitoruara ka marr kohë 173 ditë.
- GjTh në Gjiilan për 1 rast të monitoruar ka marr kohë 171 ditë.
- GjTh në Pejë për 6 raste të monitoruara ka marr kohë 155 ditë.
- GjTh në Gjakovë për 3 raste të monitoruara ka marr kohë 86 ditë.
- GjTh në Prizren për 15 raste të monitoruara ka marr kohë 44 ditë

Gjykatat që kanë kaluar më së shumti kohë prej caktimit të shqyrtimit kryesor deri në shpalljen e aktgjykimit janë GjTh në Prishtinë, GjTh në Prizren dhe GjTh në Gjakovë. Mesatarja e kohës prej caktimit të shqyrtimit kryesor deri në shpalljen e aktgjykimit nëpër gjykata ka marrë kohë si në vijim:

- GjTh në Prishtinë për 20 raste të monitoruara ka marr kohë 411 ditë.
- GjTh në Pejë për 5 raste të monitoruara ka marr kohë 278 ditë.
- GjTh në Prizren për 8 raste të monitoruara ka marr kohë 277 ditë.
- GjTh në Ferizaj për 1 rast të monitoruar ka marr kohë 153 ditë.
- GjTh në Gjiilan për 6 raste të monitoruara ka marr kohë 146 ditë.
- GjTh në Gjakovë për 3 raste të monitoruara ka marr kohë 69 ditë.
- GjTh në Mitrovicë për 8 raste të monitoruara ka marr kohë 63 ditë.

d) Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore në rastet e korrupsionit deri në shpalljen e aktgjykimit

Gjatë monitorimit të IKD-së në gjashtëmuorin e parë 2017, Gjykatat kanë shpallur 88 aktgjykime për rastet e korrupsionit. Në të gjitha këto raste, në të cilat janë shpallur aktgjykimet, IKD ka analizuar kohëzgjatjen e secilës fazë të procedurës penale dhe respektimin e afateve ligjore të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale. Në tabelat në vijim janë paraqitur dy faza të rëndësishme për të matur kohëzgjatjen e zgjidhjes së rasteve të korrupsionit, prej fillimit të kallëzimit penal dhe prej ngritjes së aktakuzës deri në shpalljen e aktgjykimit në shkallë të parë. Shih tabelat në vazhdim.




Grafika 9 - Kohëzgjatja prej trajtimit të kallëzimit penal deri në shpallje të aktgjykimit në 88⁴³ raste të monitoruara nga IKD gjatë periudhës janar-qershor 2017.

Sipas grafikës më lartë shihet se koha më e shkurtë e trajtimit të rastit të korrupsionit nga koha e paraqitjes së kallëzimit penal deri në shpallje të aktgjykimit është 1 ditë, përderisa rasti që ka marr më së shumti kohë deri në shpallje të aktgjykimit është 3689 ditë apo mbi 10 vjet.

Grafika e më poshtme paraqet kohëzgjatjen prej ngritjes së aktakuzës deri në shpalljen e aktgjykimit. Sipas rasteve të korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se koha më e shkurtë ka qenë përfundimi i rastit brenda ditës, ndërsa rasti që ka marr më së shumti kohë është në 3385 ditë apo mbi 9 vjet.

⁴³ *Shënim:* IKD ka bërë matjet dhe analizat vetëm për aq raste sa ka arritur të kompletoj të dhënat për këtë fazë të procedurës penale të vendosur në indikatorë.



Grafika 10 - Kohëzgjatja prej ngritjes së aktakuzës deri në shpallje të aktgjykimit në 88⁴⁴ raste të monitoruara nga IKD gjatë periudhës janar-qershor 2017


e) Monitorimi i rasteve të korrupsionit të kthyer në rigjykim

Gjatë monitorimit të 255 rasteve të korrupsionit në periudhën gjashtëmujore (*janar-qershor 2017*), monitoruesit e IKD-së kanë identifikuar 29 raste të cilat janë kthyer në rigjykim. Nga këto 29 raste, 7 raste i përkasin GjTh në Pejë, 7 raste GjTh në Gjiilan, 4 raste GjTh në Prizren, 4 raste GjTh në Ferizaj, 4 raste GjTh në Prishtinë, 2 raste GjTh në Mitrovicë dhe 1 rast GjTh në Gjakovë.

IKD edhe në këto raste ka vendosur indikatorët për matjen e kohës së kaluar për trajtimin e rastit në secilën fazë të procedurës penale, mirëpo fokusi kryesor ka qenë në këto tri faza: 1) *kohën e ngritjes së aktakuzës deri në shpalljen e aktgjykimit të parë*; 2) *kohën nga shpallja e aktgjykimit të parë deri në aktvendimin për kthimin e lëndës në gjykatë dhe* 3) *kohën nga aktvendimi për kthimin e lëndës në gjykatë deri në mbajtjen e shqyrtimit kryesor*. Gjetjet e IKD-së tregojnë që gjyqtarëve dhe prokurorëve i’u duhen vite për të filluar apo përfunduar një rast.

⁴⁴ *Shënim:* IKD ka bërë matjet dhe analizat vetëm për aq raste sa ka arritur të kompletoj të dhënat për këtë fazë të procedurës penale të vendosur në indikatorë.

Në grafikën më poshtë, IKD ka paraqitur indikatorët e tre fazave të lartpërmendura me mesataren e kohës së kaluar për secilën fazë.



Grafika 11- Mesatarja e kohëzgjatjes së tre fazave të procedurës penale në 29⁴⁵ rastet e korrupsionit të kthyer në rigjykim

Siç vërehet në grafikë, nga mesatarja e kohëzgjatjes së tre fazave të procedurës penale në 29 rastet e korrupsionit të kthyer në rigjykim, e të cilat janë monitoruar nga IKD, del se duhet të kalojnë së paku gati 5 muaj për të zhvilluar një fazë të procedurës.

- Në 27 raste të kthyer në rigjykim, rezulton se mesatarja e trajtimit prej ngritjes së aktakuzës deri në shpalljen e aktgjykimit të parë është 811 ditë.
- Në 23 raste të kthyer në rigjykim, rezulton se mesatarja e trajtimit prej shpalljes së aktgjykimit të parë deri në aktvendimin për kthimin e lëndës në gjykatë është 219 ditë.
- Në 23 raste të kthyer në rigjykim, rezulton se mesatarja e trajtimit prej aktvendimit për kthimin e lëndës në gjykatë deri në mbajtjen e shqyrtimit kryesor është 143 ditë.

⁴⁵ *Shënim:* Matjet e realizuara për secilin indikatorë në secilën fazë dallojnë për sa i përket numrit të rasteve. IKD ka bërë matjet dhe analizat vetëm për aq raste sa ka arritur të kompletoj të dhënat për secilën fazë të procedurës penale të vendosur në indikatorë..

Gjetjet e IKD-së, nga procesi i monitorimit të rasteve të korrupsionit të kthyer në rigjykim, tregojnë se në 16 raste ndaj 22 personave është shpallur aktgjykim i dytë. Mesatarja e kohës së kaluar nga shqyrtimi kryesor deri në shpalljen e aktgjykimit për 16 raste prej tyre është 179 ditë.

Dënim me burg		Dënim me kusht		Aktgjykim lirues	Aktgjykim refuzues
Persona	Muaj	Persona	Muaj	Persona	Persona
6 ⁴⁶	86	2	18	13	1

Tabela 12 – Aktgjykimet e shpallura në rastet e korrupsionit

Nga 22 personat ndaj të cilëve është marr aktgjykim i dytë, një person⁴⁷ ka marrë dënim me burg efektiv në kohëzgjatje prej 48 muaj, dy persona⁴⁸ kanë marrë dënim me burg efektiv në kohëzgjatje prej 12 muaj secili, dy persona⁴⁹ kanë marrë dënim me burg efektiv në kohëzgjatje prej 5 muaj secili, një person dënim me burg efektiv në kohëzgjatje prej 4 muaj, një person dënim me kusht në kohëzgjatje prej 11 muaj, një person dënim me kusht në kohëzgjatje prej 7 muaj, për trembëdhjetë persona është shpallur aktgjykim lirues, ndërkaq për një person është shpallur aktgjykim refuzues pasi prokurori ka hequr dorë nga ndjekja penale.

Ndërkaq, nga 29 rastet e analizuara, 3 raste janë kthyer për të dytën herë në rigjykim.

⁴⁶ Sqarim: Nga 6 personat e dënuar me burg, 4 prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marr edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 6,100 euro.

⁴⁷ Sqarim: Personi i dënuar me burg në kohëzgjatje prej 48 muaj, është i njëjti i cili ka marr edhe dënim me gjobë në shumën prej 5,000 euro.

⁴⁸ Sqarim: Një nga dy personat e dënuar me burg në kohëzgjatje prej 12 muaj, është i njëjti i cili ka marr edhe dënim me gjobë në shumën prej 300 euro.

⁴⁹ Sqarim: Dy personat e dënuar me burg në kohëzgjatje prej 5 muaj secili, janë të njëjtit të cilët kanë marr edhe dënim me gjobë në shumën prej 400 euro secili.

f) Profili i personave të akuzuar dhe gjykuar në rastet e korrupsionit (01.01.2017-30.06.2017)

Profili i 761 personave të akuzuar në këto 255 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD gjatë kësaj periudhe raportuese (*janar-qershor 2017*) është i kryesisht i ulët dhe i mesëm dhe një numër i kufizuar i personave të akuzuar i takon profilit të lartë.



Grafika 12- Profili i 761⁵⁰ personave të akuzuar për vepra penale të korrupsionit në Gjykata Themelore gjatë periudhës raportuese (*janar-qershor 2017*)

Profili i lartë i personave të akuzuar për vepra penale të korrupsionit në muajt janar-qershor 2017	Prishtinë	Prizren	Pejë	Gjilan	Mitrovicë	Ferizaj	Gjakovë	Total:
Kryetar Gjykate	1	0	0	0	0	0	0	1
Kryetarë Komune	2	1	2	4 ⁵¹	1	0	1	11
Deputetë	3	0	0	0	0	0	0	3
Ministra	5	0	0	0	0	0	0	5
Kryetar i OSHP-së	1 ⁵²	0	0	0	0	0	0	1
Rektor në Universitet	1 ⁵³	0	0	0	0	0	1	2

Tabela 13 – Profili i lartë i personave të akuzuar për vepra penale të korrupsionit në muajt janar-qershor 2017.

⁵⁰ Sqarim: Nëntë persona të akuzuar prej të cilëve gjashtë i takojnë profilit të mesëm dhe tre profilit të lartë, janë të përfshirë në më shumë se 1 rast.

⁵¹ Sqarim: Personi i akuzuar në cilësi të kryetarit të Komunës së Killokotit, është i përfshirë edhe në një rast tjetër.

⁵² Sqarim: Personi i akuzuar në cilësi të kryetarit të OSHP-së, është i përfshirë edhe në një rast tjetër.

⁵³ Sqarim: Personi i akuzuar në cilësi të Rektorit të Universitetit, është i përfshirë edhe në një rast tjetër në cilësi të kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.

Profili i mesëm i personave të akuzuar për vepra penale të korrupsionit në muajt janar-qershor 2017	Prishtinë	Prizren	Pejë	Gjilan	Mitrovicë	Ferizaj	Gjakovë	Total:
Prokurorë	0	0	0	1	0	0	0	1
Gjyqtarë	2	1	0	0	0	0	0	3
Zyrtarë në Ministri	30	1	0	4	1	0	0	36
Zyrtarë në Komunë	49 ⁵⁴	13 ⁵⁵	42	19 ⁵⁶	8	1	10	142
Zyrtarë në zyrë të Kryeministrit	1	0	0	0	0	0	0	1
Zyrtarë në Gjykatë	3	0	0	0	0	0	0	3
Zyrtarë në Polici	15	27	2	1	41	5	0	91
Zyrtarë në FSK	0	0	0	0	0	2	0	2
Zyrtarë në Doganë	5	0	1	0	2	0	0	8
Drejtor në kompani publike	3	0	0	0	0	0	0	3
Drejtor në RTK	1	0	0	0	0	0	0	1
Drejtor në Teatër Kombëtar	1	0	0	0	0	0	0	1
Drejtor në QKUK	1	0	0	0	0	0	0	1
Drejtor në barnatoren qendrore të QKUK	1	0	0	0	0	0	0	1
Drejtor i prokurimit në UP	1	0	0	0	0	0	0	1
Drejtor i Institutit	1	0	0	0	0	0	0	1
Drejtor në Qendrën e Shërbimit Mendor	1	0	0	0	0	0	0	1
Drejtor në OJQ	1	0	0	0	0	0	0	1
Drejtor në KEDS	1	0	0	0	0	0	0	1
Kryetar në Shoqatë	1	0	1	0	0	0	0	2
Zyrtarë në KEK	1	0	0	0	0	1	0	2
Zyrtarë në ATK	1	0	0	1	0	0	0	2
Zyrtarë në KEDS	4	0	0	0	0	0	0	4
Zyrtarë në Agjenci	29	0	1	0	0	0	0	30
Zyrtarë në OSHP	4	0	0	0	0	0	0	4
Zyrtarë në Ambasadë	1	0	0	0	0	0	0	1
Zyrtarë në KQZ	2	0	0	0	0	0	0	2
Zyrtarë në PTK	9	0	0	0	0	0	0	9
Zyrtarë në shkollë publike	0	3	0	3	0	3	0	9
Zyrtarë në Spitale dhe QMF	1	0	0	2	3	1	0	7
Zyrtarë në QKUK	6	0	0	0	0	0	0	6
Zyrtarë në Borde	2	0	0	0	0	0	0	2
Asambleistë	0	0	2	0	0	0	0	2
Avokatë	1	0	0	0	0	1	0	2

Tabela 14 – Profili i mesëm i personave të akuzuar për vepra penale të korrupsionit në muajt janar-qershor 2017.

⁵⁴ Sqarim: Një zyrtarë komunale është e përfshirë edhe në një rast tjetër.

⁵⁵ Sqarim: Një zyrtar komunal është i përfshirë edhe në një rast tjetër.

⁵⁶ Sqarim: Katër zyrtarë komunal janë të përfshirë edhe në nga një rast tjetër.

Profili i ulët i personave të akuzuar për vepra penale të korrupsionit në muajt janar-qershor 2017	Prishtinë	Prizren	Pejë	Gjilan	Mitrovicë	Ferizaj	Gjakovë	Total:
Biznesmen	50	0	18	1	1	0	0	70
Qytetarë	56	21	3	13	14	8	1	116
Drejtor në kompani private	5	1	0	1	2	0	0	9
Drejtor në bankë	3	0	0	1	0	0	0	4
Zyrtarë në bankë	5	0	0	1	1	0	0	7
Zyrtarë në auto shkollë	0	0	0	2	0	0	0	2
Zyrtarë në OJQ	2	0	0	0	0	0	0	2
Zyrtarë në institucione private	1	0	0	0	2	0	0	3
Punëtor në shkollë publike	0	1	0	0	0	0	0	1
Zyrtarë në Universitet	0	1	0	0	0	0	0	1
Zyrtarë në Qendrën për Patentë Shofer	0	0	0	0	1	0	0	1
Zyrtarë në kompani publike	2	0	0	0	0	1	0	3
Zyrtarë në kompani private	12	0	1	0	4	0	0	17
Punëtorë në kompani private	10	0	0	1	2	0	0	13
Punëtorë në kompani publike	0	0	0	0	2	0	0	2
Punëtorë sigurimi	2	0	0	0	0	0	0	2
Punëtorë në PTK	0	0	0	1	1	0	0	2
Punëtorë në Agjenci	5	0	0	0	0	0	0	5
Punëtorë në PK	1	0	0	0	0	0	0	1
Punëtor në park nacional	0	1	0	0	0	0	0	1
Punëtorë në Teatër Kombëtar	1	0	0	0	0	0	0	1
Zyrtarë në Stacion të Autobusëve	2	0	0	0	0	0	0	2
Noter	0	1	0	0	0	0	0	1
Oficer Korrektues	8	0	1	0	0	0	0	9
Doktor	55	0	0	2	0	0	0	57
Farmacist	1	0	0	0	0	0	0	1
Inxhinierë	1	0	0	0	0	0	0	1
Gjeodet	1	0	0	0	0	0	0	1
Inkasantë	0	2	0	0	2	0	1	5
Roje pylli	1	5	4	0	0	0	0	10
Vozitës	0	0	1	2	0	0	0	3
Imam	0	0	1	0	0	0	0	1
Zjarrfikës	0	0	0	1	0	0	0	1

Tabela 15 – Profili i ulët i personave të akuzuar për vepra penale të korrupsionit në muajt janar-qershor 2017.

III. Analizë ligjore e trajtimit të rasteve specifike të profilit të lartë të korrupsionit

Përkundër obligimeve ligjore dhe politikave të përcaktuara nga sistemi gjyqësor për trajtimin me prioritet absolut të rasteve të korrupsionit, zbatimi në praktikë dëshmon për shkelje të vazhdueshme të afateve ligjore. Në tri prej rasteve më të mëdha të profilit të lartë të korrupsionit në rastin “Stenta”, “Ukë Rugova dhe të tjerët” dhe “Naser Osmani dhe të tjerët” gjykatësit kanë dështuar të zbatojnë obligimet ligjore për trajtimin e tyre në kohë. IKD vlerëson se kjo qasje e gjykatësve, dëshmon joseriozitetin në zbatimin e obligimeve ligjore dhe politikave të KGJK-së në trajtimin e këtyre rasteve me prioritet absolut.

Në shtatë rastet e tjera të përfunduara gjatë periudhës së gjashtë mujorit të parë të vitit 2017, ku janë përfshirë shtatë raste të profilit të lartë, rezulton se në gjashtë raste kanë dështuar aktakuzat e prokurorëve, ndërsa vetëm në një rast ka arritur të provohet aktakuza, ndaj Svetislav Ivanović, Kryetar i Novobërdës, në të cilin rast, gjykatësit e kanë dënuar Ivanovićin me 4500 euro gjobë. Kjo dëshmon që lufta kundër korrupsionit është retorikë boshe, e cila nuk prodhon rezultate konkrete në ndjekjen dhe gjykimin e të korruptuarve të profilit të lartë.

a) Analiza ligjore e zvarritjes së tri rasteve karakteristike të profilit të lartë

RASTI STENTA

Më 15 qershor 2016, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit kishte ngritur aktakuzë kundër ish-ministrit të Shëndetësisë, Ferid Agani, Sekretarit të Përgjithshëm të MSh-së, Gani Shabani dhe 62 personave të tjerë, nga të cilët 44 mjekë, për veprat penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “Marrje e ryshfetit”, “Dhënie e ryshfetit”, “Trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor”, “Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore dhe farmaceutike” dhe “Shmangia nga tatimi”.

Rasti është duke u trajtuar nga prokurorë dhe gjykatës vendor.

Karakteristikat e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore:

- a) Kjo aktakuzë është ngritur nga prokurori i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, në kundërshtim me ligjin dhe praktikën gjyqësore në Kosovë.
- b) Ky rast nuk është klasifikuar në rastet e shënjestuara;
- c) Dosja Stenta ka afërsisht 2500 deri 3000 faqe;
- d) Që nga ngritja e aktakuzës janë ndërruar katër prokurorë në lëndën "Stenta". Rasti ishte iniciuar nga Prokurori i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit Besim Kelmendi, për të kaluar te prokurori Admir Shala, pastaj te prokurori Sylë Hoxha dhe në fund të prokurori Florije Shamolli.

- e) Një person është akuzuar në këtë rast gabimisht nga Prokurori Besim Kelmendi. Sipas gjykatëses së rastit, ndaj këtij të akuzuari gabimisht, ka një aktvendim për pushim të hetimeve dhe i njëjti nuk është dashur të jetë pjesë e aktakuzës.
- f) Me 15 qershor 2016, ishte dërguar aktakuza në gjykatë. Nga 15 qershori 2016 deri në fillim të muajit nëntor 2017, në këtë rast janë mbajtur dhjetë seanca gjyqësore lidhur me shqyrtimin e parë.
- g) Me 16 mars 2017, nëntë muaj pas ngritjes së aktakuzës, të pandehurit nuk kanë pranuar dokumentet e përkthyer në gjuhën e tyre amtare. Gjykatësja e rastit kishte nxjerr aktvendim me të cilin e obligon Prokurorinë Speciale, që deri para datës 19 maj, të bëjë përkthimin e CD-ve në gjuhën turke dhe atë maqedonase.

Me 2 nëntor 2017, Gjykata e Apelit ka marr aktvendim në rastin “Stenta” të cilin e ka kthyer në rivendosje. Në aktvendimin e gjykatës thuhet se aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë për këtë rast, është përcjell me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 e lidhur me nenin 245,249 dhe 250 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Gjithashtu, në aktvendimin e Apelit thuhet se shkalla e parë nuk i ka respektuar të drejtat e parapara për mbrojtje profesionale të të pandehurve, ku ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar pa praninë e mbrojtëseve të të akuzuarve, ndërsa, për disa nga të pandehurit tjerë ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar pa vendosur më parë për kërkesat e tyre për caktimin e mbrojtësit me shpenzime publike.

Gjykata e Apelit, ka konstatuar se shkalla e parë në arsyetimin e saj nuk ka dhënë fare arsye të qarta se cilat janë ato prova në bazë të cilave, është ngritur aktakuza e që e mbështesin dyshimin e bazuar se të pandehurit kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen me aktakuzë. Në të, theksohet se gjykata e shkallës së parë, në rivendosje duhet t’i eliminojë shkeljet e lartpërmendura dhe atë së pari t’i respektojë dispozitat procedurale të parapara sipas nenit 245 të Kodit të Procedurës Penale, për praninë e palëve.⁵⁷

RASTI UKË RUGOVA DHE TË TJERËT:

PSRK më 18 nëntor 2013 kishte marr Aktvendim për fillimin e hetimeve në rastin kundër Ukë Rugovës dhe të tjerëve. Më 18 maj 2016, PSRK kishte ngritur aktakuzë ndaj Ukë Rugovës, ish-deputet i Kuvendit të Kosovës dhe Astrit Haraçisë, ish-Ministër, lidhur me dyshimin për kryerjen e veprave penale: “krim i organizuar”; “kontrabandim të migrantëve”; “posedim i paautorizuar i

⁵⁷ Raport nga Instituti i Kosovës për Drejtësi lidhur me monitorimin e rastit Stenta, publikuar me 2 nëntor 2017, në: <http://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-kthen-ne-rivendosje-rastin-stenta/>

armëve”; “ushtrim i ndikimit”; “mashttrim”; “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”. Aktakuza e Prokurorisë Speciale ngarkon Ukë Rugovën se gjatë periudhës maj 2011 deri në shkurt 2014 ka menaxhuar një grupi kriminal, duke furnizuar individë me viza shengen të BE-së, nga Ambasada Italiane në Prishtinë. Të gjitha këto viza dyshohet se janë marrë në mënyrë të paligjshme nëpërmjet shtrembërimit apo korrupsionit.⁵⁸

Rasti është duke u udhëhequr nga prokuror dhe gjykatës ndërkombëtar të Eulex-it.

Karakteristikat e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore:

- a) Të akuzuar një ish deputet, një ish ministër
- b) Sipas aktakuzës, grupi dyshohet se ka siguruar 556 viza, që i bie përafërsisht kanë përfituar në mënyrë të kundërligjshme shumën prej 1.668.000 deri 2,224.000 Euro.
- c) **Sipas** aktakuzës, prokuroria nuk ka paraqit kërkesë për sekuestrim apo konfiskim të pasurisë së fituar me vepër penale.
- d) Aktakuza është ngritur me 18 maj 2016.
- e) Që nga ngritja e aktakuzës, janë caktuar shtatë seanca gjyqësore lidhur me këtë rast, tre pret cilave janë shtyrë për arsye të ndryshme.
- f) As pas 15 muajve nga ngritja e aktakuzës, ky rast ende nuk ka filluar shqyrtimin kryesor.⁵⁹

Me 12 tetor 2017, Gjykata e Apelit e ka refuzuar kërkesën për hüdhe të aktakuzës në rastin e ish-deputetit Ukë Rugova, ish-ministrit Astrit Haraqija dhe të tjerëve, të cilët akuzohen për vepra të ndryshme penale që lidhen me krimin e organizuar. Nëpërmjet një komunikate për media, Gjykata e Apelit, ka njoftuar se e ka refuzuar ankesën e mbrojtjes së Rugovës dhe të akuzuarve të tjerë, që ishte parashtuar kundër aktgjykimit të kryetarit të trupit gjykues të Gjykatës Themelore në Prishtinë.⁶⁰

⁵⁸E. Miftaraj dhe B. Musliu, “Deti” i korrupsionit në Kosovë: “Peshqit e vegjël kapen, të mëdhenjtë lihen të lirë, mars 2017, faqe 30, në: <http://kli-ks.org/ep-content/uploads/2017/04/1.1.-Raporti-i-Korrupsionit-IKD-28.03.2017-Compressed.pdf>

⁵⁹Neni 245 paragrafi 5 i KPPK-së, përcakton se gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtimin e dytë jo më herët se tridhjetë (30) ditë pas shqyrtimit fillestar dhe jo më vonë se dyzet (40) ditë pas shqyrtimit fillestar. Në të kundërtën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë vetëm paraqitjen e propozimeve deri në datën e caktuar, e cila nuk mund të jetë më vonë se tridhjetë (30) ditë nga shqyrtimi fillestar. Rasti Ukë Rugova, Astrit Haraqija dhe të tjerët ende është në fazën e shqyrtimit fillestar, edhe 15 muaj pas ngritjes së aktakuzës, duke u shkelur afatet ligjore të përcaktuara në KPPK.

⁶⁰Raport i publikuar nga Instituti i Kosovës për Drejtësi lidhur me monitorimin e rastit kundër Ukë Rugovës dhe të tjerëve, 12 tetor 2017, në: <http://betimiperdrejtesi.com/gjykata-e-apelit-vendos-qe-uke-rugova-astrit-haraqija-dhe-te-tjeret-te-gjykohen-per-rastin-e-vizave-italiane/>

RASTI NASER OSMANI DHE TË TJERËT

PSRK më 16 shkurt 2016, kishte ngritur aktakuzë në GjTh në Prishtinë kundër deputetit Naser Osmani, Nënkryetar i Bordit të Drejtorëve të AKP-së, Bahri Shabani, Shkëlzen Lluka, Naim Avdiu, Melita Ymeraga, Agron Kamberi, Adrian Kelmendi, Agim Deshishku, të gjithë zyrtarë në AKP. Sipas aktakuzës së ngritur nga ana e PSRK-së, të akuzuarit Naser Osmani, si nënkryetar i Bordit të Drejtorëve të AKP-së, Bahri Shabani si Drejtori i Bordit të AKP-së, Shkelzen Lluka si menaxher i AKP-së, Naim Avdiu si zv/drejtor menaxhues i AKP-së dhe Melita Ymeraga, Ardian Kelmendi, Agron Kamberaj si kryesues të Njësisë së Monitorimit në AKP në bashkëpunim me zyrtarët e tjerë si anëtarë ndërkombëtar të AKP-së: Lisa Brodey, Mohammed Omran dhe Hubert Ęarsmann, i kanë kaluar kompetencat zyrtare me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë për vete ose për personin tjetër, në vlerë prej 5,400,000,00 euro.⁶¹

Rasti është duke u trajtuar nga prokuror dhe gjykatës vendor.

Karakteristikat e rastit dhe shkelja e afateve ligjore:

- a) Naser Osmani është deputet i Kuvendit të Kosovës;
- b) Aktvendimi për fillim të hetimeve është marr me 30 prill 2014.
- c) Aktakuza në këtë rast është ngritur me 16 shkurt 2016.
- d) Shqyrtimi fillestar është mbajtur me 4 prill 2016.
- e) Seancat gjyqësore të caktuara me 20 prill dhe 29 maj 2017, janë shtyrë.
- f) Në këtë rast janë caktuar edhe tre seanca gjyqësore, e datës 12 korrik 2017, që është mbajtur, kurse seancë gjyqësore e caktuar me 11 shtator është shtyrë për shkak të mungesës së avokatit mbrojtës të deputetit Naser Osmani, kurse seanca gjyqësore e caktuar me 16 tetor 2016, është shtyrë për shkak të mungesës së Kryetarit të trupit gjykues, gjykatësit Shashivar Hoti.
- g) Afatet ligjore të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale në këtë rast nuk janë respektuar nga gjykata. Për më shume se një vit, nga data 4 prill 2016 deri me 20 prill 2017, nuk është caktuar asnjë seancë gjyqësore në këtë rast.

⁶¹ E. Miftaraj dhe B. Musliu, “Deti” i korrupsionit në Kosovë: “Peshqit e vegjël kapen, të mëdhënjtë lihen të lirë, mars 2017, faqe 32, në: <http://kli-ks.org/ep-content/uploads/2017/04/1.1.-Raporti-i-Korrupsionit-IKD-28.03.2017-Compressed.pdf>

b) Analiza ligjore e trajtimit të shtatë rasteve të profilit të lartë

1) RASTI HYSNI HOXHA, ETJ.: ISH-KRYETAR I ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT (OSHP)

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.408/16

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Kryetari i Trupit Gjykses: Shashivar Hoti

Prokuror: Paul Flynn

Të pandehur: Emin Tmava, Hanefi Hajdini, Muhamet Selmani, Driton Pruthi, Nijazi Thaçi, Hysni Hoxha dhe Azem Duraku

Më 28 shtator 2011, ishte ngritur kallëzim penal kundër ish-Kryetarit të OSHP-së, Hysni Hoxha, ekspertit të OSHP-së Azem Duraku dhe ndaj zyrtarëve të KEK-ut, Emin Tmava, Hanefi Hajdini, Driton Pruthi, Muhamet Selmani dhe Nijazi Thaçi. Më 16 dhjetor 2012 ishte marrë vendim për fillimin e hetimeve kundër tyre. Më 7 korrik 2016, ishte ngritur aktakuzë në Gjykata Themelore në Prishtinë për veprën penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”. Sipas aktakuzës, në mars të vitit 2011 i akuzuari Emin Tmava, duke qenë kryesues i komisionit për vlerësimin e ofertave në KEK, së bashku me anëtarin e komisionit Hanefi Hajdini, mbikëqyrësin e komisionit Driton Pruthi, ushtruesin e detyrës së drejtorit të zyrës së prokurimit Muhamet Selamani dhe drejtorin ekzekutiv të zyrës së prokurimit Nijazi Thaçi, kishin shpallur fitues të tenderit milionësh kompanitë “Solar & Ortex Uro Group” dhe “Beli Com”. Këtë, ata e kishin bërë edhe pse e kishin ditur se kompanitë e lartcekura, gjatë aplikimit kishin paraqitur dokumente të falsifikuara dhe nuk i kishin plotësuar kriteret e tenderit. Duke vepruar kështu, të akuzuarit e lartcekur, kanë krijuar kushte për dëm të konsiderueshëm ndaj KEK-ut. Ndërsa, të akuzuarit Hysni Hoxha, ish drejtor i OSHP-së, dhe Azem Duraku, ekspert në OSHP, edhe pse kishin qenë në dijeni qe kompanitë “Solar & Ortex Uro Group” dhe “Beli Com”, nuk i kishin plotësuar kriteret për aplikim dhe kishin paraqitur dokumente falso, ku kishin hedhur poshtë ankesat e kompanive “SMH Kosovo”, “Kombinimi” dhe “Teknox Group Kosovo L.L.C. Në këtë mënyrë, të akuzuarit Hoxha dhe Duraku, kishin dështuar të ndërmarrin ndonjë veprim detyrues që të parandalojnë nënshkrimin e kësaj kontrate të dëmshme për KEK-un.

Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Shqyrtimi fillestar lidhur me këtë rast është caktuar të mbahet pas katër muajve, apo 3 muaj në kundërshtim me ligjin, përkatësisht më 7 nëntor 2016⁶², mirëpo i njëjti ishte shtyrë për shkak të

⁶² Raport nga monitorimi i shqyrtimit fillestar në rastin kundër Hysni Hoxhës, etj., 7 nëntor 2016, në: <http://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-seanca-fillestare-ndaj-zyrtareve-te-larte-te-kek-ut-dhe-ish-kryetarit-te-organit-shqyrtues-te-prokurimit/>

mungesës së tre të akuzuarve. Ndërsa më 25 nëntor 2016, ishte mbajtur shqyrtimi fillestar⁶³, ku shtatë të akuzuarit, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i EULEX-it, Tomas Meskauskas, ishin deklaruar të pafajshëm për veprën me të cilën i ngarkonte aktakuza.

Pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, ishte caktuar shqyrtimi i dytë për 29 dhjetor 2016⁶⁴, por i njëjti ishte shtyrë me kërkesë të prokurorit të EULEX-it, Paul Flynn. Karakteristikë e këtij rasti është se menjëherë në shqyrtimin e dytë, të mbajtur më 23 janar 2017⁶⁵, prokurori Paul Flynn heq dorë nga ndjekja penale kundër të akuzuarve Emin Tmava, Hanefi Hajdini, Muhamet Selmani, Driton Pruthi, Nijazi Thaçi, Hysni Hoxha dhe Azem Duraku, me arsyetimin se ka mungesë të provave. Në këtë rast, Gjykata Themelore në Prishtinë shpall aktgjykim refuzues ndaj shtatë të pandehurve.

Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Nuk ka kërkesa.

2) RASTI ENVER HASANI: ISH-KRYETAR I GJYKATËS KUSHTETUESE

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.14/16

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” dhe “falsifikim i dokumentit zyrtar”.

Kryetari i Trupit Gjykses: Shashivar Hoti

Prokuror: Abdurrahim Islami

I pandehur: Enver Hasani

Më 14 prill 2015, ishte ngritur kallëzim penal kundër Enver Hasanit, ish-Kryetar i Gjykatës Kushtetuese. Në të njëjtën ditë më 14 prill 2015, PSRK kishte marr aktvendim për fillimin e hetimeve kundër të njëjtit. Më 13 janar 2016, PSRK ka ngritur aktakuzë në Gjykata Themelore në Prishtinë, kundër Enver Hasanit për veprën penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” dhe “Falsifikim i dokumentit zyrtar”. Enver Hasani akuzohej për vendimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me Dekretin e Presidentes rreth vazhdimin të mandatit të tre gjyqtarëve ndërkombëtarë. Sipas kësaj aktakuze, në kohën kur ishte Kryetar i Gjykatës Kushtetuese, Hasani

⁶³ Raport nga monitorimi i shqyrtimit fillestar në rastin kundër Hysni Hoxhës, etj., 25 nëntor 2016, në: <http://betimiperdrejtesi.com/nis-procesi-gjyqesor-kunder-zyrtareve-te-larte-te-kek-ut-dhe-ish-kryetarit-te-oshp-se-deklarohen-te-pafajshem/>

⁶⁴ Raport nga monitorimi i shqyrtimit të dytë në rastin kundër Hysni Hoxhës, etj., 29 dhjetor 2016, në: <http://betimiperdrejtesi.com/me-kerkese-te-prokurorit-te-eulex-it-paul-flynn-shtyhet-seanca-gjyqesore-kunder-zyrtareve-te-larte-te-kek-ut-dhe-ish-kryetarit-te-oshp-se/>

⁶⁵ Raport nga monitorimi i shqyrtimit të dytë në rastin kundër Hysni Hoxhës, etj., 23 janar 2017, në: <http://betimiperdrejtesi.com/prokurori-i-eulex-it-hoqi-dore-nga-ndjekja-penale-ndaj-zyrtareve-te-larte-te-kek-ut-dhe-ish-kryetarit-te-oshp-se/>

akuzohej se kishte shënuar emrin e gjyqtarit Robert Carolan edhe pse ky i fundit nuk kishte marrë pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje, ngase bëhej fjalë edhe për vazhdimin e mandatit të tij.

Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Karakteristikë e këtij rasti është ndërrimi i shpeshtë i prokurorëve, respektivisht këtë rast nga fillimi deri në fund e kanë trajtuar tre prokurorë nga PSRK, Blerim Isufaj, Drita Hajdari dhe Abdurrahim Islami. Edhe në këtë rast obligimi ligjor për caktimin e shqyrtimit fillestar brenda 30 dite pas ngritjes së aktakuzës është shkelur. Respektivisht, shqyrtimi fillestar në këtë çështje është caktuar më 1 korrik 2016, apo mbi 5 muaj pas ngritjes së aktakuzës. Seanca e caktuar më 1 korrik 2016, është shtyrë për shkak të mungesës së Prokurorit.⁶⁶ Lidhur me këtë rast janë mbajtur edhe dy seanca gjyqësore lidhur me shqyrtimin fillestar më datat 15 korrik dhe 8 shtator 2016. Në seancën e mbajtur më 8 shtator 2016, Enveri Hasani para trupit gjykues ka deklaruar se rasti ndaj tij është “është hakmarrje ordinere e Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi dhe shefave të tij, për shkak se Gjykata Kushtetuese e kishte rrëzuar procesin e zgjedhjes së Kryeprokurorit Lumezi”.⁶⁷

Shqyrtimi i dytë në rastin kundër Enver Hasanit është mbajtur më 11 tetor 2016. Në këtë seancë gjyqësore, mbrojtësi i të akuzuarit, avokati Bajram Tmava gjatë kundërshtimit të aktakuzës kundër klientit të tij ka bërë të ditur se vendimin të cilin e kishte marrë Hasani në kohën kur ishte kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës është vendosur në frymën e Kushtetutës së Kosovës si dhe ligjeve në fuqi.⁶⁸

Më 10 janar 2017, Gjykata e Apelit e Kosovës ka hudhur poshtë aktakuzën e ngritur ndaj ish-kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani veprat penale “keqpërdorim të detyrës zyrtare” dhe “falsifikim të dokumentit zyrtar”. Përfaqësuesi i ish-kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, avokati Bajram Tmava ka thënë se Gjykata e Apelit e ka aprovuar në tërësi ankesën kundër aktvendimit të Gjykata Themelore në Prishtinë dhe se pushimi i procedurës penale ndaj klientit të tij është bërë pasi Gjykata e Apelit ka vlerësuar se të gjitha veprimet e ndërmarra nga Hasani kanë qëndruar në kuadër të autorizimeve të tij si kryetar i Gjykatës Kushtetuese.⁶⁹

Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Nuk ka kërkesa.

⁶⁶ Raport nga monitorimi i shqyrtimit fillestar në rastin kundër Enver Hasanit, 1 korrik 2016, në: <http://betimiperdrejtesi.com/mungon-prokurori-shtyhet-seanca-ndaj-enver-hasanit/>

⁶⁷ Raport nga monitorimi i seancës gjyqësore kundër Enver Hasanit, 8 shtator 2016, në: <http://betimiperdrejtesi.com/enver-hasani-kjo-aktakuze-eshte-hakmarrje-e-kryeprokurorit-aleksander-lumezi/>

⁶⁸ Raport nga monitorimi i shqyrtimit të dytë në rastin kundër Enver Hasanit, 11 tetor 2016, në: <http://betimiperdrejtesi.com/avokati-i-enver-hasanit-ne-asnje-presje-nuk-kam-gjetur-veprim-antiligjor-te-te-mbrojturit-tim/>

⁶⁹ Raport nga monitorimi i rastit kundër Enver Hasanit, 10 janar 2017, në: <http://betimiperdrejtesi.com/hudhet-aktakuza-ndaj-ish-kryetarit-te-gjykates-kushtetuese-enver-hasani/>

3) RASTI RAMË BUJA, ETJ.: ISH-MINISTRI I ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË (MASHT)

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.656/15

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” dhe “Mashtrim”.

Kryetari i Trupit Gjykses: Valon Kurtaj

Prokuror: Ali Rexha

Të pandehur: Ramë Buja, Xhemajl Buzuku, Afrim Demiri dhe Xhavit Dakaj

Avokatët: Petrit Dushi, Florent Latifaj dhe Ramë Dreshaj

Më 24 maj 2013, ishte ngritur kallëzim penal kundër Ramë Buja, ish-Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Xhavit Dakaj, sekretar i përgjithshëm në MASHT, Xhemajl Buzuku, drejtor i prokurimit në MASHT dhe Afrim Demiri, pronar i operatorit ekonomik “Alb – Architect”. Më 1 dhjetor 2014, PSRK kishte marr aktvendim për fillimin e hetimeve kundër të njëjtit. Më 7 nëntor 2016, PSRK ka ngritur aktakuzë në Gjykata Themelore në Prishtinë, kundër Ramës Bujës, Xhavit Dakajt dhe Xhemajl Buzukut për veprën penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, si dhe kundër Afrim Demirit për veprën penale “Mashtrim”. Sipas aktakuzës, Buja si ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Dakaj si sekretar i Përgjithshëm në MASHT pretendohet se kishin lidhur marrëveshje të kundërligjshme me operatorin ekonomik “Alb – Architect”, pronar i të cilës është i akuzuari, Afrim Demiri. Ndërsa, Buzuku duke qenë në cilësinë e drejtorit të prokurimit në MASHT, kishte lejuar lidhjen e kontratës me këtë operator, në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.

Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Aktakuza kundër katër të lartpërmendurve është ngritur më 7 nëntor 2016, ndërsa shqyrtimi i parë ishte caktuar të mbahej më 7 mars 2017, apo tre muaj pas afatit të paraparë ligjor. Në shqyrtimin fillestar, ish-Ministri i Arsimit, Ramë Buja, Xhemajl Buzuku dhe Xhavit Daka, janë deklaruar të pafajshëm për veprën penale me të cilën i ngarkon Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), e që është “keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”. I pafajshëm është deklaruar edhe i akuzuari i katërt në këtë rast, Afrim Demiri, i cili ngarkohet me veprën penale “mashtrimi”.⁷⁰

⁷⁰ Raport nga monitorimi i shqyrtimit fillestar në rastin kundër Ramë Bujës, etj., 7 mars 2017, në: <http://betimiperdrejtesi.com/deklarohen-te-pafajshem-ish-ministri-i-arsimit-rame-buja-dhe-tre-te-akuzuarit-e-tjere/>

Shqyrtimi i dytë në rastin kundër Ramë Bujës dhe të tjerëve është mbajtur më 11 prill 2017. Në këtë seancë gjyqësore, gjithë mbrojtësit e të akuzuarve i kishin parashtruar Gjykatës me shkrim, kundërshtimet lidhur me provat si dhe kërkesat për hudhjen e aktakuzës.⁷¹

Më 28 prill 2017, Gjykata e Themelore e Prishtinës ka hudhur poshtë aktakuzën e ngritur ndaj ish-Ministrit të Arsimit, Ramë Buja dhe ish-sekretarit të kësaj ministrie, Xhavit Dakaj, me arsyetimin se PSRK-ja nuk ka mundur me asnjë provë të vetme të vë në pah faktin e tejkalimit të kompetencave zyrtare apo keqpërdorimit të pozitës, nga të akuzuarit në fjalë. Me këtë vendim nuk ishte njoftuar prokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Ali Rexha. I kontaktuar nga “Betimi për Drejtësi” më 16 maj 2017, prokurori Rexha kishte deklaruar se nuk e di nëse do të parashtrroj ankesë në Gjykatën e Apelit, meqenëse nuk ka pranuar aktvendim për hedhjen e aktakuzës në fjalë⁷². Megjithatë, pas një kohe, kundër vendimit të Gjykatës Themelore, kishte paraqitur ankesë Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, në Gjykatën e Apelit. Kjo e fundit, më 5 qershor 2017 ka vërtetuar vendimin e Gjykatës Themelore për hudhjen e aktakuzës ndaj dy të lartpërmendurve⁷³.

Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Nuk ka kërkesa.

4) RASTI SVETISLLAV IVANOVIQ, ETJ.: KRYETAR I KOMUNËS SË NOVOBËRDËS

Gjykata Themelore në Gjilan

Numri i lëndës: PKR.nr.253/16

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” dhe “Konflikti i interesit”.

Kryetari i Trupit Gjyqësor: Emine Salihu

Prokuror: Rabije Jakupi

Të pandehur: Svetislav Ivanoviq, Xhemajl Novobërdaliu, Sylejman Avdyli dhe Adem Abazi

Më 21 shkurt 2016 Prokuroria Themelore e Gjilanit kishte nisur hetimet ndaj Kryetarit të Komunës së Novobërdës, Svetislav Ivanoviq, për “keqpërdorim të pozitës zyrtare” dhe “konflikt të interesit”, dhe tre zyrtarëve të kësaj komunë, Xhemajl Novobërdaliu, Sylejman Avdyli dhe

⁷¹ Raport nga monitorimi i shqyrtimit të dytë në rastin kundër Ramë Bujës, etj., 11 prill 2017, në: <http://betimiperdrejtesi.com/ish-ministri-i-arsimit-rame-buja-dhe-tre-te-akuzuarit-e-tjere-kerkojne-hudhjen-e-aktakuzes-ndaj-tyre/>

⁷² Raport për hudhjen e aktakuzës kundër Ramë Bujës, etj., 16 maj 2017, në: <http://betimiperdrejtesi.com/prokurori-special-nuk-eshte-ne-dijeni-per-hedhjen-e-aktakuzes-ndaj-ish-ministrit-rame-buja/>

⁷³ Raport vendimin e Gjykatës së Apelit në lidhje me hudhjen e aktakuzës kundër Ramë Bujës, etj., 16 maj 2017, në: <http://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-vendimin-per-hedhjen-e-aktakuzes-ndaj-ish-ministrit-buja/>

Adem Abazi për “keqpërdorim të pozitës zyrtare”. Më 7 tetor 2016, Prokuroria kishte ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore në Gjilan, kundër Svetislav Ivanoviqit, Xhemajl Novobërdaliut, Sylejman Avdyli dhe Adem Abazit. Sipas aktakuzës, Svetislav Ivanoviq, në cilësinë e kryetarit të Komunës së Novobërdës, në bashkëpunim me shefin e personelit Sylejman Avdyli, e kanë punësuar Vesna Ivanoviqin në pozitë të përkohshme të menaxheres për kulturë në Sektorin e Arsimit dhe Kulturës në Komunën e Novobërdës. Një punësim i tillë ishte bërë pa konkurs, me ç’ rast buxheti i Republikës së Kosovës është dëmtuar për shumën prej 5,757,25 euro për vitin 2014, dhe 7,349,46 euro për vitin 2015. “Akt emërimi” për këtë pozitë u nënshkrua nga kryetari Ivanoviq, i cili vendim është vërtetuar me vulë nga Avdyli. Ky i fundit, akuzohet edhe se pas skadimit të “Akt emërimin” për Miodrag Markoviq, Tanja Stankoviq në pozitën e teknikut medicinal, dhe Visar Mehmeti në një pozitë në Drejtorinë e Shëndetësisë në Komunën e Novobërdës, ka vërtetuar me vulë zyrtare dhe i ka vazhduar ato pozita me aktvendim të ri, pa pasur konkurs. Në këtë mënyrë, buxheti i Kosovës, respektivisht ai i Komunës së Novobërdës, pretendohet se është dëmtuar në vlerë prej 12,751,75 euro. Kontratat për tre të lartpërmendurit i kishte nënshkruar dhe lëshuar i pandehuri Xhemajl Novobërdaliu, si drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi në komunën në fjalë. Për pranim të punëtorëve të rinj pa konkurs, akuzohet edhe Adem Abazi, në cilësi të drejtorit të Arsimit dhe Kulturës në Novobërdë.

Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Aktakuza kundër katër të lartpërmendurve është ngritur më 7 tetor 2016, ndërsa shqyrtimi i parë ishte caktuar të mbahej më 17 mars 2017⁷⁴, apo katër muaj pas afatit të paraparë ligjor. Në shqyrtimin fillestar, Gjykata Themelore në Gjilan e ka dënuar me 4,500 euro gjobë Kryetarin e Komunës së Novobërdës, Svetislav Ivanoviq, për “keqpërdorim të pozitës zyrtare” dhe “konflikt të interesit”, Xhemajl Novobërdaliun me 1,000 euro gjobë dhe Sylejman Avdylin me 2,000 euro gjobë për “keqpërdorim të pozitës zyrtare”. Një vendim i tillë u mor, pasi tre të lartpërmendurit kishin arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë me Prokurorinë, menjëherë pasi janë njoftuar nga mbrojtësit e tyre, avokatët Ardit Latifi, Habib Hashani dhe Sherif Sherifi, për të gjitha pasojat dhe përparësitë e saj. Megjithatë, një marrëveshje e tillë nuk u bë edhe nga i akuzuari i katërt, Adem Abazi, për të cilin u veçua procedura.

Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Nuk ka kërkesa.

⁷⁴ Raport nga monitorimi i shqyrtimit fillestar në rastin kundër Svetislav Ivanoviq, etj., 17 mars 2017, në: <http://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-gjobe-kryetari-i-komunes-se-novobardes-svetislava-ivanoviq/>

5) RASTI PAL LEKAJ, ETJ.: ISH-KRYETAR I KOMUNËS SË GJAKOVËS

Gjykata Themelore në Gjakovë

Numri i lëndës: PKR.nr.18/17

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

Kryetari i Trupit Gjykses: Gëzim Pozhegu

Prokuror: Faik Halili

Të pandehur: Pal Lekaj, Qazim Mehmeti dhe Nikollë Lleshi

Më 3 korrik 2014, ishte ngritur kallëzim penal kundër ish-kryetarit të Komunës së Gjakovës Pal Lekaj, ish-drejtorit për Buxhet dhe Financa, Qazim Mehmeti dhe ish-menaxher i prokurimit, Nikollë Lleshi. Më 16 maj 2016, PSRK kishte marr aktvendim për fillimin e hetimeve kundër të njëjtit. Më 10 shkurt 2017, PSRK ka ngritur aktakuzë në Gjykata Themelore në Gjakovë, kundër Pal Lekajt, Qazim Mehmetit dhe Nikollë Lleshit për veprën penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”. Sipas aktakuzës së PSRK-së, Pal Lekaj në kohën sa ishte kryetar në komunën e Gjakovës, në bashkëkryerje me Qazim Mehmetin, ish-drejtor për Buxhet dhe Financa dhe Nikollë Lleshin, ish-menaxher i prokurimit, kanë tejkaluar kompetencat e tyre zyrtare me qëllim të përfitimit për vete apo dikë tjetër çfarë do lloj dobie pasurore, duke i shkakuar dëm komunës së Gjakovës dhe banorëve të saj.

Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Aktakuza kundër tre të lartpërmendurve është ngritur më 10 shkurt 2017, ndërsa shqyrtimi i parë ishte caktuar të mbahej më 14 prill 2017, apo një muaj pas afatit të paraparë ligjor. Në shqyrtimin fillestar, i Pal Lekaj, Qazim Mehmeti dhe Nikollë Lleshi, janë deklaruar të pafajshëm për veprën penale me të cilën i ngarkon Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), e që është “keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

Shqyrtimi i dytë në rastin kundër Pal Lekajt dhe të tjerëve është mbajtur më 15 maj 2017. Në këtë seancë gjyqësore, avokatët mbrojtës Arianit Koci, Ndrecë Dodaj dhe Meshari Selimaj me anë të kundërshtimit të provave, kërkuan lirim nga akuzat të mbrojturit e tyre, Pal Lekaj, Qazim Mehmeti dhe Nikollë Lleshi, të akuzuar për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar. Ndërkaq, prokurori i Prokurorisë Speciale, Faik Halili, deklaroi se i kundërshton në tërësi parashtrimet e avokatëve, pasi sipas tij, akuza është plotësisht e bazuar në prova dhe dëshmi që sipas tij, të akuzuarit kanë kryer veprën penale me të cilën ngarkohen dhe kërkoi që trupi gjykses t'i hedhë poshtë parashtrimet e avokatëve.⁷⁵

⁷⁵ Raport nga monitorimi i shqyrtimit të dytë në rastin kundër Pal Lekajt, etj., 15 maj 2017, në: <http://betimiperdrejtesi.com/mbrojti-kerkon-lirim-nga-akuzat-per-ish-kryetarin-e-gjakoves-pal-lekaj-dhe-dy-te-tjeret/>

Më 19 maj 2017, Gjykata e Themelore e Gjakovës ka hudhur poshtë aktakuzën e ngritur ndaj ish-kryetarit të Komunës së Gjakovës Pal Lekaj, ish-drejtorit për Buxhet dhe Financa, Qazim Mehmeti dhe ish-menaxheri i prokurimit, Nikollë Lleshi, në mungesë të provave⁷⁶. Hudhja e aktakuzës ndaj Pal Lekajt dhe dy të akuzuarve tjerë, u vërtetua edhe nga Gjykata e Apelit.

Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Nuk ka kërkesa.

6) RASTI AGIM BAHTIRI, ETJ.: KRYETAR I KOMUNËS SË MITROVICËS

Gjykata Themelore në Mitrovicë

Numri i lëndës: PKR.nr.20/16

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” dhe “Marrëveshje për kufizimin e konkurrencës përmes ftesave për tender”

Kryetari i Trupit Gjykses: Beqir Halili

Prokuror: Agron Bajrami

I pandehur: Agim Bahtiri, Haxhimet Ferati dhe Fatbardh Makolli

Policia e Kosovës më 18 nëntor 2015, ka parashtruar kallëzim penal kundër Agim Bahtirit, Kryetar i Komunës së Mitrovicës. PSRK më 4 shkurt 2016, kishte marr aktvendim për fillim të hetimeve ndaj të njëjtit. Kurse më 1 mars 2016, PSRK ka ngritur aktakuzë kundër Agim Bahtirit për kryerjen e veprave penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

PSRK akuzon Agim Bahtirin se si Kryetar i Mitrovicës, së bashku me Haxhimet Feratin, shef i zyrës së prokurimit të kësaj Komune, kanë tejkaluar kompetencat me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm. Këtë përfitim pretendohet se e kanë sjellë për operatorin ekonomik "HESALIGHT A/S, ku drejtor për Kosovë është i akuzuari Gazmend Kelmendi. Ata kanë nënshkruar kontratën me titull "Furnizim, montim dhe mirëmbajtje e ndriçimit publik eficiente në të gjitha rrugët e qytetit të Mitrovicës", ofertë kjo e bazuar në marrëveshje të kundërligjshme, qëllimi i të cilës ishte kufizimi i konkurrencës së lirë. Tutje sipas prokurorisë, Komuna e Mitrovicës ka pranuar ofertën e paraqitur nga Kelmendi me çmim prej 767.940.00 euro, dëm ky i shkaktuar Komunës, gjegjësisht buxhetit të Kosovës. Në këtë mënyrë të pandehurit kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore, duke mos e njoftuar KRPP-në. Po ashtu te njëjtit nuk e kanë publikuar njoftimin për dhënie të kontratës me qëllim që të shpërblehet operatori ekonomik në fjalë, përkundër faktit se ka pasur edhe operatorë tjerë lidhur me ofrimin e shërbimeve të njëjta.

⁷⁶ Raport vendimin e Gjykatës së Apelit në lidhje me hudhjen e aktakuzës kundër Pal Lekajt, etj., 22 qershor 2017, në: <http://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-hedhjen-e-aktakuzes-ndaj-ish-kryetarit-te-gjakoves-pal-lekaj/>

Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Aktakuza kundër Agim Bahtirit është ngritur më 1 mars 2016, ndërsa shqyrtimi i parë i caktuar për 22 qershor 2016, ishte shtyrë për 15 korrik 2016. Në seancën e mbajtur më 15 korrik 2016, në Gjykata Themelore në Mitrovicë, të pafajshëm u deklaruan Agim Bahtiri, Haxhimet Ferati, shef i prokurimit në Mitrovicë, dhe Gazmend Kelmendi, drejtor për Kosovë i operatorit ekonomik “Hesalight”. Pasi që prokurori Agron Bajrami lexoi aktakuzën, i pandehuri Bahtiri tha se këtë gjykim e konsideron politik dhe se aktakuza nuk ka të bëjë aspak me të.⁷⁷

Pas pothuajse 8 muaj nga mbajtja e shqyrtimit fillestar, është hedhur⁷⁸ poshtë aktakuza e ngritur ndaj kryetarit të Komunës së Mitrovicës Agim Bahtiri, shefit të Prokurimit në Mitrovicë Haxhimet Ferati, dhe drejtorit të operatorit ekonomik “Hesalight” për Kosovë Gazmend Kelmendit. Pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, mbrojtësi i Kryetarit të Mitrovicës, avokati Mahmut Halimi, kishte parashtruar kundërshtimet e tij lidhur me provat e cekura në aktakuzë. Gjyqtari Beqir Halili kishte hedhur poshtë kundërshtimet e mbrojtjes dhe kishte konfirmuar aktakuzën.

Ndaj këtij aktvendimi, mbrojta kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit. Kjo e fundit i kishte aprovuar ankesat e mbrojtjes, dhe lëndën e kishte rikthyer në rivendosje. Megjithatë, edhe pas rikthimit të lëndës në rivendosje, gjyqtari Halili nuk u kishte dhënë të drejtë mbrojtjes, dhe kishte hedhur poshtë ankesat e tyre, duke konfirmuar edhe një herë tjetër aktakuzën.⁷⁹ Por, Gjykata e Apelit në Prishtinë, në seancën e kolegjit të mbajtur më 27 shkurt 2017, ka aprovuar si të bazuara ankesat e të pandehurve, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, duke e rrëzuar aktakuzën pasi ka konsideruar se nuk ka pasur prova që mbështesin dyshimin e bazuar mirë se të akuzuarit i kanë kryer veprat penale për të cilat ngarkohen.

Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Në rastin kundër Agim Bahtirit, sipas prokurorisë Komuna e Mitrovicës e ka pranuar ofertën e paraqitur nga Gazmend Kelmendi me çmim prej 767.940.00 euro, dëm ky i shkaktuar Komunës, gjegjësisht buxhetit të Kosovës. Edhe përkundër këtij dëmi, aktakuza e paraqitur nga Prokuroria, nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për sekuestrim apo konfiskim të pasurisë së fituar me veprat penale të ngritura në aktakuzë.

⁷⁷ Raport nga monitorimi i seancën gjyqësore në rastin kundër Agim Bahtirit, në: <http://betimiperdrejtesi.com/agim-bahtiri-deklarohet-i-pafajshem-per-keqperdorim-te-pozites-zyrtare/>

⁷⁸ Raport nga monitorimi i seancën gjyqësore në rastin kundër Agim Bahtirit, në: <http://betimiperdrejtesi.com/hudhet-poshte-aktuza-ndaj-kryetarit-te-mitrovices-agim-bahtiri/>

⁷⁹ Raport lidhur me monitorimin e rastit për korrupsion ndaj Agim Bahtirit, Kryetar i Komunës së Mitrovicës, në: <http://betimiperdrejtesi.com/kane-kaluar-afer-8-muaj-nga-shqyrtimi-fillestar-zvarritet-ceshtja-penale-ndaj-kryetarit-te-komunes-se-mitrovices-agim-bahtiri/>

7) RASTI MEHMET KRASNIQI, ETJ.: ISH-KRYETAR I KOMUNËS SË OBILIQIT

Gjykata Themelore në Prishtinë

Numri i lëndës: PKR.nr.271/14

Vepra penale: “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “Mashtrimi” dhe “Mashtrimi në detyrë”

Kryetari i Trupit Gjykses: Afërdita Bytyçi

Prokuror: Agron Bajrami

Të pandehur: Mehmet Krasniqi, Xhavit Krasniqi, Haki Raqi, Emir Sopjani, Sami Kadriu, Nazmi Gashi, Ramadan Hashani, Bajram Paloji, Bujar Alidema, Shpend Kelmendi, Basri Kqiku, Hasie Dushi, Azem Spanca dhe Altin Preniqi.

Policia e Kosovës më 14 prill 2014 kishte ngritur kallëzim penal kundër Nexhat Krasniqit dhe të tjerëve. PSRK më 15 shtator 2014 kishte nxjerr aktvendim për fillim të hetimeve, kurse më 8 maj 2015, kishte ngritur aktakuzë në GjTh në Prishtinë për veprat penale: “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” “Mashtrimi” dhe “Mashtrimi në detyrë”, kundër Mehmet Krasniqit ish-Kryetar i Komunës së Obiliqit, Xhavit Krasniqit Gjeodet, Haki Raqit zyrtar komunal, Emir Sopjanit pronar i kompanisë “Delta-ing”, Sami Kadriut menaxher përgjegjës, Nazmi Gashit anëtar i Komisionit për Pranim Teknik, Ramadan Hashanit inspektor i ndërtimit, Bajram Palojit anëtar i Komisionit për Pranim Teknik, Bujar Alidemës pronar i kompanisë “Bas Com”, Shpend Kelmendit inxhinier, Basri Kqikut pronar i kompanisë “Bejta Commerce”, Hasie Dushit zyrtare komunale, Azem Spancës drejtor komunal në Komunën e Obiliqit, Altin Preniqit menaxher i zyrës së Prokurimit. Veprat penale për të cilat akuzohet Mehmet Krasniqi dhe 12 persona tjerë, janë kryer gjatë periudhës kohore 2012-2013, përkatësisht gjatë realizimit të projektit për asfaltimin e disa rrugëve në këtë Komunën e Obiliqit.

Neglizhenca në trajtimin e rastit dhe shkeljet e afateve ligjore

Shqyrtimi fillestar në këtë rast është mbajtur më 21 tetor dhe 22 nëntor 2015, gjashtë muaj pas afatit ligjor të përcaktuar në KPPRK, ndërsa shqyrtimi i dytë me 14 dhjetor 2015. Nga kjo kohë gjykatës iu janë dashur mbi shtatë muaj për të caktuar shqyrtimin kryesor i cili është caktuar vetëm me 20 korrik 2016. Gjatë vitit 2016, gjykata ka mbajtur edhe një seancë gjyqësore me 18 nëntor 2016⁸⁰, ndërsa seanca gjyqësore e caktuar për 13 janar 2017, është shtyrë⁸¹. Më pas janë mbajtur edhe dy seanca të tjera, më 25 prill 2017⁸² dhe 17 maj 2017⁸³. Ndërkaq, aktgjykimi është

⁸⁰ Raport nga monitorimi i rastit kundër Mehmet Krasniqi dhe të tjerëve, 18 nëntor 2017: <http://betimiperdrejtesi.com/jep-mbrojtjen-e-tij-ish-kryetari-i-obiliqit-i-akuzuar-per-keqperdorim-te-pozites-zyrtare/>

⁸¹ Raport nga monitorimi i rastit kundër Mehmet Krasniqi dhe të tjerëve, 13 janar 2017: <http://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-seanca-gjyqesore-ndaj-ish-kryetarit-te-komunes-se-obiliqit-dhe-zyrtareve-tjere-te-kesaj-komune-shkak-mungesa-e-prokurorit-agron-bajrami/>

⁸² Raport nga monitorimi i rastit kundër Mehmet Krasniqi dhe të tjerëve, 25 prill 2017: <http://betimiperdrejtesi.com/afere-fundit-procesi-gjyqesor-ndaj-ish-kryetarit-te-obiliqit-mehmet-krasniqi/>

shpallur më 19 maj 2017⁸⁴, sipas të cilit Gjykata Themelore në Prishtinë, në mungesë të provave ka liruar nga akuza për keqpërdorim të pozitës zyrtare, ish-kryetarin e Komunës së Obiliqit, Mehmet Krasniqi. Nga akuza për të njëjtën vepër, me aktgjykimin e shpallur të premtën u liruan edhe zyrtarët e komunës në fjalë Xhavit Krasniqi, Haki Raqi, Nazmi Gashi, Ramadan Hashanin, Bajram Palojin, Azem Spancën dhe Altin Preniqin. Ndërsa, Hasnije Dushi u lirua nga akuza për mashtrim në detyrë.

Ndërkaq, ndaj të akuzuarve për mashtrim, Emir Sopjanit dhe Sami Kadriut, gjykata shpalli aktgjykim dënues, duke i'u shqiptuar dënimin me nga 1 vit e 6 muaj burgim me kusht. Bujar Alidema dhe Shpend Kelmendi u dënuan me nga 2 vite burgim me kusht dhe 4,000 euro gjobë. Tutje, Basri Kqiku u dënua me 1 vit burgim me kusht dhe 3,000 euro gjobë.

Sekuestrimi dhe Konfiskimi

Nuk ka kërkesa.

⁸³ Raport nga monitorimi i rastit kundër Mehmet Krasniqi dhe të tjerëve, 17 maj 2017: <http://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-kerkon-denim-per-ish-kryetarin-e-obiliqit-dhe-12-te-tjeret-te-akuzuarit-kerkojne-lirim-prej-akuzave/>

⁸⁴ Raport nga monitorimi i rastit kundër Mehmet Krasniqi dhe të tjerëve, 19 maj 2017: <http://betimiperdrejtesi.com/shpallet-i-pafajshem-ish-kryetari-i-obiliqit-mehmet-krasniqi/>

IV. Politika e dënimeve në rastet e korrupsionit

a) Politika e dënimeve në rastet e korrupsionit (01.01.2017-30.06.2017)

IKD vlerëson se politika e dënimeve në rastet e korrupsionit vazhdon të mbetet e butë. Në 88 aktgjykime të shpallura në shkallë të parë ndaj 184 personave në rastet e korrupsionit të monitoruara nga IKD, rezulton se gjykatësit kryesisht zbatojnë politikë të butë ndëshkimore, ndaj kryesve të veprave penale të korrupsionit. Në vazhdim është paraqitur tabela, e cila pasqyron vendimet e shqiptuara nga ana e gjykatësve në këto 88 aktgjykime për rastet e korrupsionit. Shih tabelën.

Dënim me burg		Dënim me kusht		Dënim me gjobë		Aktgjykim lirues	Aktgjykim refuzues	Hudhje e aktakuzës
Persona	Muaj	Persona	Muaj	Persona	Shuma në euro	Persona	Persona	Persona
17 ⁸⁵	305	45 ⁸⁶	510	29	177,600	52	25 ⁸⁷	16 ⁸⁸

Tabela 16 - Rastet e aktgjykimeve të monitoruara nga IKD.

Gjetjet e IKD-së, nga procesi i monitorimit të rasteve të korrupsionit, tregojnë se në rastet ndaj 184 personave ndaj të cilëve është marr aktgjykim në shkallë të parë, ndaj 17 personave kanë marr aktgjykim me dënim me burg, në total prej treqindpesë (305) muajve apo njëzetepesë (25) vite e pesë (5) muaj për të gjithë personat e dënuar.

Nga 17 personat e dënuar me burg efektiv, një person është dënuar me 5 muaj burg efektiv, tetë persona⁸⁹ janë dënuar me nga 6 muaj burg efektiv, tre persona janë dënuar me nga 12 muaj burg efektiv, dy persona⁹⁰ janë dënuar me nga 36 muaj burg efektiv, një person është dënuar me 38

⁸⁵ Sqarim: Nga 17 personat e dënuar me burg, 4 prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marr edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 4,200 euro.

⁸⁶ Sqarim: Nga 45 personat e dënuar me kusht, 18 prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marr edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 29,565 euro.

⁸⁷ Sqarim: Për 22 persona është shpallur aktgjykim refuzues pasi prokurori ka hequr dore nga ndjekja penale ndaj tyre, për 1 person është shpallur aktgjykim refuzues pasi është përfshirë gabimisht në aktakuzë, ndërsa për 2 persona tjerë është shpallur aktgjykim refuzues pasi prokurori ka hequr dorë për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit.

⁸⁸ Sqarim: Për 1 person është hudhur aktakuza për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit.

⁸⁹ Sqarim: Nga 8 personat e dënuar me burg në kohëzgjatje prej 6 muaj secili, 2 prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marr edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 2,200 euro, ku një prej tyre është dënuar edhe me 2000 euro, dhe një prej tyre edhe me 200 euro.

⁹⁰ Sqarim: Një nga dy personat e dënuar me burg efektiv në kohëzgjatje prej 36 muaj, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 1,000 euro.

muaj burg, një person⁹¹ është dënuar me 48 muaj burg dhe një person është dënuar me 58 muaj burg

Gjykatësit ndaj 45 personave kanë shqiptuar dënime me kusht prej 510 muajve. Prej tyre, një person⁹² është dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 2 muaj, dy persona janë dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 3 muaj secili, dy persona janë dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 5 muaj secili, shtatëmbëdhjetë persona⁹³ janë dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 6 muaj secili, dy persona janë dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 8 muaj secili, tetë persona⁹⁴ janë dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 12 muaj secili, një person është dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 14 muaj, katër persona⁹⁵ janë dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 18 muaj secili, tetë persona⁹⁶ janë dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 24 muaj secili.

Gjykatësit ndaj 29 personave kanë shqiptuar dënime me gjobë në total prej 177,600 eurosh. Prej tyre, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 100 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 200 euro, dy persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 300 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 700 euro, tre persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 1,000 euro, dy persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 1,500 euro, pesë persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 2,000 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 2,400 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 2,500 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 3,000 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 3,600 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 4,000 euro, një person është dënuar me gjobë në vlerë prej 4,500 euro, dy persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 10,000 euro, gjashtë persona janë dënuar me gjobë në vlerë prej nga 20,000 euro.

Gjykatësit ndaj 52 personave kanë shqiptuar aktgjykim lirues, ndërsa ndaj 25 personave kanë shqiptuar aktgjykim refuzues për shkak se për 22 prej tyre, në mungesë të provave, prokurorët kanë dorë nga ndjekja penale ndaj tyre, 1 person është përfshirë gabimisht në aktakuzë, ndërsa

⁹¹ Sqarim: Personi i dënuar me burg efektiv në kohëzgjatje prej 48 muaj, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 1,000 euro.

⁹² Sqarim: Personi i dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 2 muaj, është i njëjti të cilit i është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në vlerë prej 150 euro.

⁹³ Sqarim: Nga 17 personat e dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 6 muaj secili, 7 prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marr edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 6,015 euro, ku 3 prej tyre janë dënuar edhe me nga 500 euro, një prej tyre edhe me 600 euro, një prej tyre edhe me 1000 euro, një prej tyre edhe me 1415 euro dhe një prej tyre edhe me 1500 euro.

⁹⁴ Sqarim: Nga 8 personat e dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 12 muaj secili, 7 prej tyre janë të njëjtit të cilët kanë marr edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 14,400 euro, ku një prej tyre është dënuar edhe me 1000 euro, një prej tyre edhe me 1500 euro, një prej tyre edhe me 2900 euro, një prej tyre edhe me 3000 euro, dy prej tyre edhe me nga 500 euro dhe një prej tyre edhe me 5000 euro.

⁹⁵ Sqarim: Nga 3 personat e dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 18 muaj secili, një prej tyre është i njëjti i cili ka marr edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 1,000 euro.

⁹⁶ Sqarim: 2 personat e dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 24 muaj secili, janë të njëjtit të cilët kanë marr edhe dënim me gjobë, në total në vlerë prej 8,000 euro, ku secili është dënuar edhe me nga 4000 euro.


për 2 persona tjerë prokurori ka hequr dorë për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit. Ndërkaq, gjykatësit ndaj 16 personave kanë hudhur aktakuza, ndaj 1 personi për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit, ndërsa ndaj 15 personave për shkak të mungesës së provave.

Nga 184 persona të akuzuar, Gjykatat rezulton se kanë dënuar me burg efektiv 17 persona apo 9,24 % të personave të akuzuar. Gjithashtu, nga këta 184 persona të akuzuar, gjykatësit ndaj 45 personave kanë shqiptuar dënime me kusht apo ndaj 24,46% të personave të akuzuar, ndaj 29 personave kanë shqiptuar dënime me gjobë apo ndaj 15,76% të personave të akuzuar, ndërsa janë liruar 93 persona apo 50,54% të personave të akuzuar.

Në këto raste të korrupsionit në të cilat ka pasur shpallje të aktgjykimit, janë përfshirë të gjitha profilet e personave të akuzuar. Prej tyre, 90 persona i takojnë profilit të ulët, 87 persona profilit të mesëm dhe 7 persona i takojnë të profilit të lartë.



Grafika 13- Profili i 184 personave të akuzuar për vepra penale të korrupsionit, për të cilët është shpallur aktgjykim në Gjykata Themelore gjatë periudhës raportuese (janar-qershor 2017)



Grafika 14 – Profili i lartë i personave të akuzuar për vepra penale të korrupsionit, për të cilët është shpallur aktgjykim në Gjykata Themelore gjatë periudhës raportuese (janar-qershor 2017)


IKD pa dashur të komentoj meritën e vendimmarrjes në rastet gjyqësore të korrupsionit, shpreh shqetësimin se politika ndëshkimore që zbatohet nga gjykatësit në rastet e korrupsionit, nuk është duke dërguar mesazh të qartë te kryesit potencial të këtyre veprave penale. Praktika e tillë ndëshkimore, duke shqiptuar dënime të buta më burg apo dënime me kusht dhe me gjobë, përçon mesazh negativ tek qytetarët dhe publiku. Po ashtu, këto dënime të buta të shqiptuara nuk mund të arrijnë qëllimin e vet për të cilat është shqiptuar dënimi, qoftë atë të karakterit ndëshkivor ndaj atyre, të cilët janë gjetur fajtor se kanë kryer vepra penale të korrupsionit, apo të karakterit preventiv, i cili ka për qëllim për të dërguar mesazhin e qartë tek personat të cilët mund të jenë subjekt i kryerjes së veprave penale të korrupsionit.

a) Politika e dënimeve në rastet e korrupsionit sipas Mekanizmit Përcjellës


Politika e dënimeve në rastet e korrupsionit vazhdon të mbetet e ulët, e cila mbështetet kryesisht në shqiptimin e dënimeve me kusht dhe me gjobë. IKD vlerëson se këto dënime nuk e arrijnë qëllimin, duke pasur parasysh se dukuria e korrupsionit, vazhdon të cilësohet si kancer i shoqërisë, zhvillimit ekonomik dhe perspektivës evropiane. Në këtë drejtim, gjykatësit duhet të shqiptojnë dënime adekuate me dënimet që krijojnë kryesit e veprave penale të korrupsionit.

a) Analizë krahasuese e dënimeve për gjashtëmujorin e parë 2016 dhe 2017

Politika e dënimeve në një analizë krahasuese të gjashtë mujorit të parë vitit 2016 dhe 2017 rezulton se më e ashpër ka qenë në vitin 2016 sesa në vitin 2017. Për dallim nga viti 2016, në vitin 2017 janë rritur rastet e shqiptuara të dënimeve me gjobë dhe me kusht.



Grafika 15 – Trajtimi i rasteve të korrupsionit nga Gjykatat Themelore gjatë gjashtëmujorit të parë të viteve 2016 dhe 2017.



Grafika 16 – Mënyra e zgjidhjes së rasteve të korrupsionit nga Gjykatat Themelore gjatë gjashtëmuajorit të parë të viteve 2016 dhe 2017.

V. Konfiskimi i pasurive të fituara përmes veprave penale të korrupsionit

IKD gjatë kësaj periudhe ka monitoruar aktivitetet e prokurorëve dhe gjykatësve në zbatimin e dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale të korrupsionit. Nga 255 rastet e korrupsionit të monitoruara në të gjitha Gjykatat Themelore, IKD ka gjetur se prokurorët në raste shumë të rralla zbatojnë në praktikë dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me kërkesat për sekuestrim apo konfiskim ndaj kryesve të veprave penale të korrupsionit.

Kryeprokurori i Shtetit me 14 janar 2014, kishte nxjerr Udhëzim⁹⁷ lidhur me veprimet e prokurorëve në zbatimin e dispozitave ligjore sa i përket sekuestrimit dhe konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale. Monitoruesit e IKD, gjatë procesit të monitorimit të rasteve të korrupsionit kanë gjetur vetëm një numër të kufizuar të rasteve kur prokurorët kanë paraqitur kërkesa për sekuestrim apo konfiskim të aseteve, në aktakuzat e paraqitura para gjykatave për korrupsion, si më poshtë:

➤ GJTh në FERIZAJ:

IKD gjatë kësaj periudhe raportuese ka monitoruar 15 raste të korrupsionit në GjTh në Ferizaj. Në këto 15 raste, monitoruesit e IKD-së kanë identifikuar vetëm **4 raste**, ku prokurori ka paraqitur kërkesë për sekuestrim apo konfiskim. Më poshtë janë paraqitur rastet konkrete:

- **PKR.nr.12/15:** Pasaportë kosovare, pasaportë jugosllave, fletore xhepi, numra të telefonit, kontrata dhe autorizime mes kompanisë “El-Abrar”, etj;
- **PKR.nr.22/17:** Një bankënotë në vlerë 50 euro, dy bankënota në vlerë 20 euro dhe një bankënotë në vlerë 10 euro;
- **PKR.nr.42/17:** Të hollat në vlerë 12,570 euro, 100 dollarë, 100 franga zvicerane, dy pistoletat me nga një karikator të kalibrit 6,35 mm dhe një granat dore;
- **PKR.nr.75/17:** Konfiskimi në mënyrë të përhershme i kartëmonedhës në vlerë 10 euro.

➤ GJTh në GJILAN:

IKD gjatë kësaj periudhe raportuese ka monitoruar 35 raste të korrupsionit në GjTh në Gjiilan. Në këto 35 raste, monitoruesit e IKD-së kanë identifikuar vetëm **4 raste**, ku prokurorët kanë paraqitur kërkesa për sekuestrim apo konfiskim. Më poshtë janë paraqitur rastet konkrete:

⁹⁷ Udhëzim Nr. 26/2014, i datës 14 janar 2014, lidhur me veprimet e prokurorëve në zbatimin e dispozitave ligjore për sekuestrimin dhe konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale. Kryeprokurori i Shtetit. (Shih linkun http://ëëë.psh-ks.net/repository/docs/Nr.26.2014-Udhezim_lidhur_me_veprimet_e_prokuroreve_lidhur_me_sendet_e_sekuestruara.pdf). (qasur për herë të fundit me 09 tetor 2017).

- **PKR.nr.34/17:** Kartëmonedha në vlerë 50 euro;
- **PKR.nr.185/16:** Kartëmonedha në vlerë 20 euro;
- **PKR.nr.157/16:** Kërkesë për sekuestrim të dy veturave;
- **PKR.nr.94/17:** Të hollat në vlerë 500 euro.

➤ **GJTh në MITROVICË:**

IKD gjatë kësaj periudhe raportuese ka monitoruar 26 raste të korrupsionit në GjTh në Mitrovicë. Në këto 26 raste, monitoruesit e IKD-së kanë identifikuar vetëm **3 raste**, ku prokurorët kanë paraqitur kërkesa për sekuestrim apo konfiskim. Më poshtë janë paraqitur rastet konkrete:

- **P.nr.60/16:** Konfiskimi i parave që kapin vlerën 250 euro;
- **P.nr.23/17:** Kartëmonedha në vlerë 100 euro;
- **P.nr 328/13:** Kërkesë për konfiskim: Plumb 17.428 kg./ 9465 pllaka x 37,479 kg.

➤ **GJTh në PRISHTINË:**

IKD gjatë kësaj periudhe raportuese ka monitoruar 122 raste të korrupsionit në GjTh në Prishtinë. Në këto 122 raste, monitoruesit e IKD-së kanë identifikuar vetëm **13 raste**, ku prokurorët kanë paraqitur kërkesa për sekuestrim apo konfiskim. Më poshtë janë paraqitur rastet konkrete:

- **PKR.nr. 341/15:** Kundër të pandehurit I.H PSRK ka propozuar:-KONFISKIMI i automjetit të markës Audi Q7, me targa 01-900FG, prodhuar në vitin 2008 në vlerë prej 37.000,00€, veturën e markës VË Golf me targa 01-326-FP, prodhuar në vitin 2009 në vlerë prej 12.500€ dhe një veturë tjetër e markës VË Golf me targa 01-421-FL, e prodhuar në viti 2009, në vlerë prej 16.800,00€ dhe parat në shumë prej 11.000,00€,si dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprave penale; - Kundër të pandehurit Skender Canolli KONFISKIMI i automjetit e markës VËPassat, me targa 01-714-FL, prodhuar në vitin 2008, në vlerë prej 20.000,00€, parat në shumë prej 10.560,00 Franga zvicerane, 2.600,00\$ amerikan dhe 1.880,00€, si dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprave penale; - Kundër të pandehurit Mërgim Shala KONFISKIMI i banesës në lagjën “Kalbria” Lamela 2, kati II, banesa nr. 07 me sipërfaqe prej 76.3m2, në shumë prej 38.150,00€; si dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprave penale; si dhe ARMËT: nga i pandehuri Ismet Haliti-Pistoleta e markës CZ.99 e kalibrit 9mm me nr.121623 më një karikatorë pa fishek dhe nga i pandehuri Skender Canolli-Pistoletë e markës Broving e kalibrit 9mm, me një karikator me tetë fishekë dhe një Pushkë Karabinë me nr.serik 85269,prodhim Crvena Zastava- Kragujevc, e kalibrit 8x57mm, si dhe njëzet e dy fishek të kësaj pushke.

Sendet e sekuestruara:

Sendet e sekuestruara nga i pandehuri I.H: a. 11,000.00€ (njëmbëdhjetë mijë euro), 22 kartëmonedha 500€; Vetura VË “Golf”, i prodhuar në vitin 2009, me ngjyrë të zezë metalike, me tabela të regjistrimit 01-326-FP, ID nr. ËVËZZZ1KZP453134, i regjistruar në emër të I.H; Vetura VË “Golf”, e prodhuar në vitin 2009, ngjyrë hiri, metalike, me tabela të regjistrimit 01-421-FL, ID nr. ËVËZZZ1KZ9Ë578466, e regjistruar në emër të F.H (i biri i të pandehurit I.H); Vetura Audi Q7, me ngjyrë të zezë, me tabela të regjistrimit 01-900-FG, numri i identifikimit ËAUZZZ4L69D025641, i prodhuar në vitin 2008, i regjistruar në emër A.P, ku hetimi ka zbuluar se pronar faktik i këtij automjeti është i pandehuri I.H.

Sendet e sekuestruara nga i pandehuri S.C – 10,560CHF (dhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë franga zvicerane) – 1,880€ (një mijë e tetëqind e tetëdhjetë euro), – 2,600\$ USD (dy mijë e gjashtëqind dollar amerikan); Vetura VË “Passat”, me ngjyrë të zezë metalike, me numër të regjistrimit 01-714-FL, e prodhuar në vitin 2008, ID nr. ËVËZZZ3CZ9E520573, e regjistruar në emër të L.C (i biri i të pandehurit S.C)

Prona e sekuestruar nga i pandehuri M.Sh. banesa nr. 8 me sipërfaqe prej 76.3m², në lamelën 2, hyrja 1, kati 2 në lagjen Kalabria;

- **PKR.nr. 305/16:** Kompjutera;
- **PKR.nr. 688/15:** Konfiskimi i bidonëve me derivate të naftës;
- **PKR.nr.303/16:** Marrja e përkohshme e: Kontratës VR.nr.5687/1997 e dt.28.01.1990, kontratës së shitblerjes së paluajtshmërisë e dt.20.03.2012;
- **PKR.nr. 27/17:** Sekuestrim të përkohshëm të sendeve;
- **PKR.nr.722/14:** Sekuestrim të përkohshëm të sendeve;
- **PKR.nr.642/15:** Konfiskimi i: banesës në Klinë në sipërfaqe prej 36 m², shtëpisë dy katëshe në sipërfaqe prej 209 m², tokës bujqësore në sipërfaqe prej 1182 m² + toka me dy parcela, lokali afarist në sipërfaqe prej 39.86 m², banesa në sipërfaqe prej 97.30 m², parcelë toke në Ulqin në sipërfaqe prej 308 m², parcelë tjetër në sipërfaqen prej 171 m² në Ulqin, veturës së markës AUDI A6, mjetet financiare në emër të shitjes së dy lokaleve afariste të blera nga Kolë Puka sipas kontratave të deponuara në shkresat e lëndës në vlerë prej 63 mijë euro;
- **PKR.nr.352/16:** Sekuestrim të përkohshëm të sendeve; Konfiskim i automjetit (kamionit);
- **PKR.nr.24/17:** Sekuestrim të përkohshëm të sendeve;
- **PKR.nr.411/16:** Konfiskimi i një revole e tipi “Beretta” së bashku me një karikator dhe 14 fishekë;
- **PKR.nr.201/14:** Konfiskimin e sendeve të cekura në aktakuzën e Prokurorisë Themelore të Prishtinës;
- **PKR.nr. 160/17:** Konfiskimin e aseteve dhe dokumenteve të falsifikuara;
- **PKR.nr.94/17:** Kartëmonedha në vlerë prej 50 euro.

➤ **GJTh në PRIZREN:**

IKD gjatë kësaj periudhe raportuese ka monitoruar 24 raste të korrupsionit në GjTh në Prizren. Në këto 24 raste, monitoruesit e IKD-së kanë identifikuar vetëm **1 rast**, ku prokurori ka paraqitur kërkesë për sekuestrim apo konfiskim. Më poshtë është paraqitur rasti konkret:

- **P.nr.192/16:** Dy kartëmonedha në vlerë nga 50 euro.

➤ **GJTh në GJAKOVË:**

IKD gjatë kësaj periudhe raportuese ka monitoruar 11 raste të korrupsionit në GjTh në Gjakovë. Në këto 11 raste, monitoruesit e IKD-së kanë identifikuar vetëm **1 rast**, ku prokurorët kanë paraqitur kërkesa për sekuestrim apo konfiskim. Më poshtë është paraqitur rasti konkret:

- **P.nr.60/16:** Konfiskimi i diplomës dhe konfiskimi i certifikatës së diplomës;

➤ **GJTh në PEJË:**

IKD gjatë kësaj periudhe raportuese ka monitoruar 22 raste të korrupsionit në GjTh në Pejë. Në këto 22 raste, monitoruesit e IKD-së kanë identifikuar vetëm **1 rast**, ku prokurorët kanë paraqitur kërkesa për sekuestrim apo konfiskim. Më poshtë është paraqitur rasti konkret:

- **P.nr.64/17:** Kartëmonedha në vlerë 100 euro.

VI. PËRZGJEDHJA E SHËNJESTRAVE TË TOP RASTEVE

Në shtator të vitit 2014, sistemi prokurorial i Kosovës kishte prezantuar Planin Strategjik për Bashkëpunim Ndërinstitucional mes Prokurorit të Shtetit dhe agjencive që zbatojnë ligjin në Kosovë në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për përzgjedhjen e Shënjestrave të Krimeve të Rënda.⁹⁸

Objekti i PSV-ve ka qenë parandalimi, zbulimi, hetimi dhe ndjekja e veprave më të rënda, përmes koordinimit dhe harmonizimit të veprimeve të autoriteteve kompetente. Qëllimi i këtij mekanizmi ishte caktimi i 50 rasteve më të rënda në sistemin e drejtësisë në Kosovë, të cilat do të trajtohen me urgjencë nga të gjitha agjencitë që zbatojnë ligjin.

Në shtator 2017 në data-bazë, janë evidentuar 35 raste të shenjësuar⁹⁹, nga të cilat 31 raste janë në gjykata dhe atë 4 (katër) raste janë në procedurë hetimore, ndërsa 27 lëndë janë me aktakuza të paraqitura në gjykata.

Në procedurë hetimore janë katër lëndët e titulluara si: “BURGU”, “QARKU”, “GOLD” dhe “SHKURTI”.

Prej 27 lëndëve me aktakuza të paraqitura në gjykata aktualisht janë në këto faza të procedurës:

- një lëndë është caktuar shqyrtimi fillestar: -“AVOKATI 3”;
- tri lëndë shqyrtimi i kundërshtimeve nga ana e Gjykatës së Apelit:- “APELI”, “INSPEKTORI” dhe “STENTA”
- dy lëndë është refuzuar kërkesa për hudhje të aktakuzës dhe pritët caktimi i shqyrtimit gjyqësor:- “TRANSPORTUESI” dhe “FERONIKELI”
- një lëndë pjesërisht e formës së prerë hudhja e aktakuzës për dy të pandehur, kurse vazhdohet shqyrtimi gjyqësor për dy të pandehur të tjerë- “AUTORITETI/PROJEKTI”;
- trembëdhjetë lëndë janë në fazën e shqyrtimit gjyqësor (“SIGURIA”, “KRISTAL”, “DETYRIMI”, “NDËRTIMI”, “KEDS”, “MSH II”, “OSHP 1”, “UP”, “KLLOKOTI II”, “DEMI”, “QERAJA”, “HIB” dhe “FAN” ;
- dy lëndë janë të përfunduar në shkallën e parë: “KONTRATA” dhe “MATRIX – M”;

⁹⁸ Miftaraj, E dhe Musliu B, Instituti i Kosovës për Drejtësi, tetor 2016, faqe 29, Luftimi i korrupsionit-Retorika në luftimin e korrupsionit, në: <http://kli-ks.org/ep-content/uploads/2016/10/1.-Retorika-ne-luftimin-e-korrupsionit-27.10.2016.pdf>

⁹⁹ Burimi: Agim Maliqi, Koordinator i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për rastet e shenjësuar. Shtator 2017.

- pesë lëndë janë të formës së prerë dhe atë ”PROKURORI”, “AVOKATI 1”, “AVOKATI 2”, “SUHAREKA” dhe “KLLOKOTI 1”.

Dy lëndë janë përfunduar në shkallën e parë dhe është duke u proceduar në Gjykatën e Apelit, kurse janë vendosur si në vijim:

- “**KONTRATA**” (aktgjykim dënues për **dy** persona dënimet njëri me gjashtë muaj burgim kurse **tjetri** me dhjetë muaj burgim, aktgjykim lirues për **një** të akuzuar, aktgjykim refuzues për **dy** të akuzuar.);
- “**MATRIX- M**” (aktgjykim dënues për **dy** persona dënimet njëri me 5 vite burgim dhe 5000€ gjobë, kurse **tjetri** me 3 vite e 6 muaj burgim dhe 2000€ gjobë, aktgjykim lirues për **gjashtë** të akuzuar);

Pesë lëndë janë të formës së prerë:

- “**PROKURORI**”: (aktgjykim dënues për një të akuzuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 vite dhe dënim me gjobë 5000,00 euro, aktgjykim dënues për një të akuzuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 vit e 6 muaj, aktgjykim dënues për një të akuzuar dënim me gjobë 3000,00 euro)
- “**AVOKATI 1**”, “**AVOKATI 2**”: (aktgjykim dënues dënim me gjobë 3000,00 euro, kurse për dy vepra tjera aktgjykim lirues);
- “**SUHAREKA**”: (aktgjykim refuzues për pesë persona pasi që Prokurori i Shtetit është tërhequr nga akuza);
- “**KLLOKOTI 1**” (aktgjykim dënues për **një vepër penale- dënim me kusht 10 muaj e** periudhë të verifikimit për dy vjet, kurse aktgjykim lirues për **dy vepra penale**)

VII. ANEX: Dështimet konkrete të prokurorëve në trajtimin e rasteve të korrupsionit

IKD ka analizuar të gjitha rastet e zgjidhura të siguruara përmes të dhënave të Mekanizmit Përcjellës si dhe akteve juridike prokuroriale të siguruara nga disa prokurori (*për periudhën 01.01.2017 – 30.06.2017*) dhe ka identifikuar shkeljet e prokurorëve sa i përket respektimit të afateve ligjore për trajtimin e kallëzimeve penale. Shkelja e dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, rezulton me shkelje të të drejtave të njeriut, duke i mbajtur qytetarët si subjekte në evidencat penale të prokurorisë në rastet kur ndaj tyre nuk ka asnjë bazë që zhvillohen hetime penale. IKD gjatë analizimit të akteve juridike prokuroriale, ka identifikuar raste të parashkuara dhe shkelje të afateve ligjore për të vendosur në rastet e korrupsionit. IKD për herë të parë pas më shumë se tri vite bashkëpunim me Prokuroritë, ka marrë përgjigje negative nga disa Kryeprokurorët, të cilët nuk kanë bashkëpunuar për të ofruar aktet prokuroriale me qëllim të monitorimit dhe analizimit të respektimit të afateve ligjore nga ana e prokurorëve në rastet e korrupsionit. Përmes kësaj mbyllje të Prokurorive, krerët e tyre kanë dëshmuar mungesën e vullnetit për të rritur transparencën dhe llogaridhënien publike përmes monitorimit nga akterë të jashtëm të shoqërisë civile. Për më tepër, përmes kësaj forme të monitorimit dhe analizimit profesional të gjetjeve nga IKD, ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e llogaridhënies së prokurorëve.¹⁰⁰

RASTET E PARASHKRIMIT TË NDJEKJES PENALE

PROKURORIA THEMELORE NË PEJË

1. Lënda me numër PP.I.nr.18/17, vendosur më 27.03.2017. *Aktvendim për hudhje të kallëzimit penal*, të parashtruar nga Policia e Kosovës. Vepra penale, *shpërdorim i detyrës zyrtare nga neni 339/1, falsifikim i dokumenteve zyrtare 348/1, legalizim i përmbajtjes së pavërtetë 334/1 të KPK-së*.¹⁰¹
2. Lënda me numër 279/2016, vendosur më 27.03.2017, *Aktvendim për hudhje të kallëzimit penal*, të parashtruar nga Policia e Kosovës. Vepra penale, *Deklarim i rrejshëm nga neni 307, par2 lidhur me nenin 23 të KPK-së, Legalizim i përmbajtjes së rremë nga neni 334 par2, lidhur me nenin 23 të KPK-së, Falsifikim i dokumenteve nga neni 332 par.3 të KPK-së*.¹⁰²

¹⁰⁰ IKD intervistë me z. Zef Prendrecaj, Drejtor i Zyrës së Prokurorit Disiplinor.

¹⁰¹ Sipas aktvendimit të dates 27.03.2017, Prokuroria Themelore në Pejë kishte hudhur pjesërisht kallëzimin penal ndaj një (1) të dyshuari për veprën penale falsifikimi i dokumentit zyrtar nga neni 348. par1. i Kodit të përkohshëm Penal të Kosovës, për shkak se kishte arritur parashkrimi relativ i ndjekjes penale.

¹⁰² Sipas aktvendimi të dates, 27.03.2017, Prokuroria Themelore në Pejë kishte hudhur kallëzimin penal ndaj gjashtë (6) të dyshuarve, për veprat penale, Deklarim i rrejshëm nga neni 307, par2 lidhur me nenin 23 të KPK-së, Legalizim i përmbajtjes së rremë nga neni 334 par2, lidhur me nenin 23 të KPK-së, Falsifikim i dokumenteve nga neni 332 par.3 të KPK-së për shkak se ndaj tyre kishte kaluar afati i parashkrimit të ndjekjes penale.

RASTET E SHKELJEVE SË AFATEVE LIGJORE PËR VENDOSJE**PROKURORIA SPECIALE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS****Rastet e vendimeve të Hudhjes së Kallëzimeve Penale – PP:**

1. Rasti me numër 50/15-pps, i parashtruar nga Qytetari, i pranuar në Prokurori me 16 korrik 2015, ku përfshihet një (1) person për veprën penale, **Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 24 janar 2017.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PSRK më 16.07.2015 ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 24.01.2017. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 558 ditë nga data e pranimi të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se Prokuroria ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 558 ditëve, apo 528 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

Rastet e vendimeve të Pushimit të Hetimeve – PP:

1. Rasti me numër 86/15-pps, i parashtruar nga Qytetari, i pranuar në Prokurori me 8 korrik 2015, ku përfshihen katër (4) persona për veprën penale, **Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **pushimin e hetimeve** për dy prej tyre është marrë më 17 janar 2017.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PSRK më 08.07.2015 ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për pushim të hetimeve më 17.01.2017. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 559 ditë nga data e pranimi të njëjtit.

2. Rasti me numër 36/16-pps, i parashtruar nga Agjencia Kundër Korrupsion, i pranuar në Prokurori me 30 shtator 2015, ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare**. Vendimi për **pushimin e hetimeve** është marrë më 11 prill 2017.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PSRK më 30.09.2015 ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për pushim të hetimeve më 11.04.2017. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 559 ditë nga data e pranimi të njëjtit.

3. Rasti me numër 59/16-pps, i parashtruar nga Policia e Kosovës, i pranuar në Prokurori me 9 nëntor 2016, ku përfshihen dy (2) persona për veprën penale, **Keqpërdorim i pozitës**

apo autoritetit zyrtar. Vendimi për **pushim të hetimeve** për njërin person është marrë më 12 prill 2017.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PSRK më 09.11.2016 ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për pushim të hetimeve më 12.04.2017. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 154 ditë nga data e pranimi të njëjtit.

4. Rasti me numër 71/15-pps, e pranuar në kompetencë, i pranuar në Prokurori me 28 shtator 2015, ku përfshihen dy (2) persona për veprën penale, **Keqpërdorim i pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar.** Vendimi për **pushimin e hetimeve** është marrë më 2 maj 2017.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PSRK më 28.09.2015 ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për pushim të hetimeve më 02.05.2017. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 582 ditë nga data e pranimi të njëjtit.

5. Rasti me numër 50/16-pps, i parashtruar nga Policia e Kosovës, i pranuar në Prokurori me 30 shtator 2016, ku përfshihet një (1) person për veprën penale, **Keqpërodim i pozitës apo autoritetit zyrtar.** Vendimi për **pushimin e hetimeve** është marrë më 9 qershor 2017.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PSRK më 30.09.2016 ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për pushim të hetimeve më 09.06.2017. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 344 ditë nga data e pranimi të njëjtit.

Rastet e vendimeve të Hudhjes së Kallëzimeve Penale/Është mbyllur me raport – PPN:

1. Rasti me numër 99/13-ppn, e parashtruar nga Policia e Kosovës, i pranuar në Prokurori më 28 tetor 2013, ku përfshihen tre (3) persona për veprën penale, **Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar.** Vendimi për **hudhjen e kallëzimit** është marrë më 03 shkurt 2017.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PSRK më 28.10.2013 ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 03.02.2017. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 1194 ditë nga data e pranimi të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se Prokuroria ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 1194 ditëve, apo 1164 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

2. Rasti me numër 62/15-ppn, e parashtruar nga Qyetari, i pranuar në Prokurori me 18 maj 2015, ku përfshihet një (1) person për veprën penale, **Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar.** Vendimi për **hudhjen e kallëzimit** është marrë më 23 shkurt 2017.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në PSRK më 18.05.2015 ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 23.02.2017. Koha e

trajtimin të kallëzimit penal ka zgjatur 647 ditë nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se Prokuroria ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 647 ditëve, apo 617 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

3. Rasti me numër 23/17-ppn, e parashtruar nga qytetari, i pranuar në Prokurori më 21 shkurt 2017, ku përfshihen pesë (5) persona për veprën penale, **Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zytar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit** është marrë më 31 maj 2017.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në Prokurori më 21.02.2017 ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 31.05.2017. Koha e trajtimin të kallëzimit penal ka zgjatur 99 ditë nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se Prokuroria ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 99 ditëve, apo 69 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

4. Rasti me numër 182/16-PPN, e pranuar në kompetencë, i pranuar në Prokurori me 4 nëntor 2016, ku përfshihet një (1) person, për veprën penale, **Marrja e ryshfetit**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit** është marrë më 19 qershor 2017.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në Prokurori më 04.11.2016 ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 19.06.2017. Koha e trajtimin të kallëzimit penal ka zgjatur 227 ditë nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se Prokuroria ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 227 ditëve, apo 197 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

PROKURORIA THEMELORE NË PRISHTINË

Rastet e vendimeve të Hudhjes së Kallëzimeve Penale - PP:

1. Rasti me numër 5472/14-IIPR, i parashtruar nga Administrata Tatimore e Kosovës, i pranuar në Prokurori me 23 korrik 2014, ku përfshihet një (1) person për veprën penale

Keqpërdorimi i autorizimeve ekonomike. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 6 janar 2017.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në Prokurori më 23.07.2014 ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 06.01.2017. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 898 ditë nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se Prokuroria ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 898 ditëve, apo 868 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

2. Rasti me numër 1312/13-IPR, i parashtruar nga I dëmtuari, i pranuar në Prokurori me 26 dhjetor 2013, ku përfshihen dy (2) persona për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 24 janar 2017.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në Prokurori më 26.12.2013 ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 24.01.2017. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 1125 ditë nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se Prokuroria ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 1125 ditëve, apo 1095 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

3. Rasti me numër 1210/14-IPR, i parashtruar nga Prokurori me vetiniciativë, i pranuar në Prokurori me 21 nëntor 2014, ku përfshihen dy (2) persona për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 31 janar 2017.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në Prokurori më 21.11.2014 ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 31.01.2017. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 802 ditë nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se Prokuroria ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 802 ditëve, apo 772 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

4. Rasti me numër 214/15-IPR, i parashtruar nga Qytetari, i pranuar në Prokurori me 8 janar 2013, ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 31 janar 2017.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në Prokurori më 08.01.2013 ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 31.01.2017. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 1484 ditë nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se Prokuroria ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 1484 ditëve, apo 1454 ditë pas afatit të lejuar ligjor.

5. Rasti me numër 697/15-IPR, i parashtruar nga Qytetari, i pranuar në Prokurori me 31 gusht 2015, ku përfshihen pesë (5) persona, një (1) person për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar** dhe katër (4) persona për veprën penale **Ushtrimi i ndikimit**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 24 janar 2017.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në Prokurori më 31.08.2015 ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 24.01.2017. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 512 nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se Prokuroria ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 512 ditëve, apo 482 ditë pas afatit të lejuar ligjor

6. Rasti me numër 940/15-IPR, i parashtruar nga Agjencia Kundër Korrupsion, i pranuar në Prokurori me 3 dhjetor 2015, ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 22 shkurt 2017.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në Prokurori më 03.12.2015 ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 22.02.2017. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 447 nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se Prokuroria ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 447 ditëve, apo 417 ditë pas afatit të lejuar ligjor

7. Rasti me numër 102/16-IIPR, i parashtruar nga I dëmtuari, i pranuar në Prokurori me 3 maj 2016, ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 7 shkurt 2017.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në Prokurori më 03.05.2016 ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 07.02.2017. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 280 nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se Prokuroria ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 280 ditëve, apo 250 ditë pas afatit të lejuar ligjor

8. Rasti me numër 263/15-IPR, i parashtruar nga I dëmtuari, i pranuar në Prokurori me 10 prill 2015, ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 23 shkurt 2017.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në Prokurori më 10.04.2015 ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 23.02.2017. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 685 nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se Prokuroria ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 685 ditëve, apo 655 ditë pas afatit të lejuar ligjor

9. Rasti me numër 647/15-IPR, i parashtruar nga Inspektorati Policor i Kosovës, i pranuar në Prokurori me 17 gusht 2015, ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 23 shkurt 2017.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në Prokurori më 17.08.2015 ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 23.02.2017. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 648 nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se Prokuroria ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 648 ditëve, apo 618 ditë pas afatit të lejuar ligjor

10. Rasti me numër 65/13-IPR, E pranuar në kompetencë, i pranuar në Prokurori me 1 mars 2013, ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Marrja e ryshfetit**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 16 shkurt 2017.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në Prokurori më 01.03.2013 ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më

16.02.2017. *Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 1448 nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se Prokuroria ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 1448 ditëve, apo 1418 ditë pas afatit të lejuar ligjor*

11. Rasti me numër 1118/14-IPR, i parashtruar nga Agjencia Kundër Korrupsion, i pranuar në Prokurori me 21 tetor 2014, ku përfshihen gjashtë (6) persona për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 28 mars 2017.

IKD: *Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në Prokurori më 21.10.2014 ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 28.03.2017. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 889 nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se Prokuroria ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 889 ditëve, apo 859 ditë pas afatit të lejuar ligjor*

12. Rasti me numër 1004/15-IPR, i parashtruar nga I dëmtuari, i pranuar në Prokurori me 24 dhjetor 2015, ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 14 mars 2017.

IKD: *Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në Prokurori më 24.12.2015 ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 14.03.2017. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 446 nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se Prokuroria ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 446 ditëve, apo 416 ditë pas afatit të lejuar ligjor*

13. Rasti me numër 601/14-IPR, i parashtruar nga I dëmtuari, i pranuar në Prokurori me 10 qershor 2014, ku përfshihen nëntë (9) persona për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 7 mars 2017.

IKD: *Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në Prokurori më 10.06.2014 ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 07.03.2017. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 1001 nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se Prokuroria ka*

shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 1001 ditëve, apo 971 ditë pas afatit të lejuar ligjor

14. Rasti me numër 789/15-IPR, i parashtruar nga I dëmtuari, i pranuar në Prokurori me 7 tetor 2015, ku përfshihen gjashtë (6) persona për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 27 mars 2017.

***IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në Prokurori më 07.10.2015 ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 27.03.2017. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 1001 nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se Prokuroria ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 1001 ditëve, apo 971 ditë pas afatit të lejuar ligjor*

15. Rasti me numër 853/15-IPR, i parashtruar nga I dëmtuari, i pranuar në Prokurori me 27 tetor 2015, ku përfshihen dy (2) persona për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 21 mars 2017.

***IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në Prokurori më 27.10.2015 ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 21.03.2017. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 511 nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se Prokuroria ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 511 ditëve, apo 481 ditë pas afatit të lejuar ligjor*

16. Rasti me numër 99/15-IPR, i parashtruar nga I dëmtuari, i pranuar në Prokurori me 11 shkurt 2015, ku përfshihen dy (2) persona për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 9 mars 2017.

***IKD:** Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në Prokurori më 11.02.2015 ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 09.03.2017. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 757 nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se Prokuroria ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 757 ditëve, apo 727 ditë pas afatit të lejuar ligjor*

17. Rasti me numër 121/16-IPR, i parashtruar nga Policia e Kosovës, i pranuar në Prokurori me 23 qershor 2016, ku përfshihen dy (2) persona, një (1) person për veprën penale

Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar dhe një (1) person për veprën penale **Konflikti i interesit**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** ndaj njërit është marrë më 28 mars 2017.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në Prokurori më 23.06.2016 ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 28.03.2017. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 278 nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se Prokuroria ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 278 ditëve, apo 248 ditë pas afatit të lejuar ligjor

18. Rasti me numër 1260/13-IPR, i parashtruar nga Policia e Kosovës, i pranuar në Prokurori me 11 dhjetor 2013, ku përfshihen dy (2) persona për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 20 mars 2017.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në Prokurori më 11.12.2013 ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 20.03.2017. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 1195 nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se Prokuroria ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 1195 ditëve, apo 1165 ditë pas afatit të lejuar ligjor

19. Rasti me numër 14/17-IPR-KE, i parashtruar nga Policia e Kosovës, i pranuar në Prokurori me 23 janar 2017, ku përfshihet një (1) person për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 27 mars 2017.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në Prokurori më 23.01.2017 ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 27.03.2017. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 63 nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se Prokuroria ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 63 ditëve, apo 33 ditë pas afatit të lejuar ligjor

20. Rasti me numër 485/02-IPR, i parashtruar nga Policia e Kosovës, i pranuar në Prokurori me 30 maj 2002, ku përfshihen dy (2) persona për veprën penale **Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar**. Vendimi për **hudhjen e kallëzimit penal** është marrë më 27 mars 2017.

IKD: Bazuar në aktvendim vërtetohet se kallëzimi penal ishte pranuar në Prokurori më 30.05.2002 ndërsa Prokuroria kishte marrë aktvendim për hudhje të kallëzimit penal më 27.03.2017. Koha e trajtimit të kallëzimit penal ka zgjatur 5415 nga data e pranimit të njëjtit. Ndërkaq, me hyrje në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale pas 1 janarit 2013, kufizohet afati ligjor prej 30 ditësh për trajtimin e kallëzimit penal (neni 82), që rezulton se Prokuroria ka shkelur këtë afat ligjor meqë hudhjen e kallëzimit penal është dashur ta bëj brenda 30 ditëve, ndërsa kallëzimi penal është hudhur pas 1546 ditëve, apo 1516 ditë pas afatit të lejuar ligjor

